

E DREJTA - PRAVO - LAW

Nr. 1/2013

# E DREJTA PRAVO LAW

Nr. 1/2013



Revistë për Çështje Juridike dhe Shoqërore  
Časopis za pravna i društvena pitanja  
Journal for Juridical and Social Issues



# E DREJTA PRAVO LAW

## BOTIM SPECIAL SPECIJALNO IZDANJE SPECIAL EDITION

Ky botim është mundësuar me përkrahjen e popullit Amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

### **MOHIM PËRGJEGJËSIE**

Qëndrimet e autorëve në këtë publikim nuk i pasqyrojnë domosdo qëndrimet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Ova publikacija je omogućena podrškom američkog naroda putem Agencije Sjedinjenih Država za međunarodni razvoj (USAID).

### **ODRICANJE OD ODGOVORNOSTI**

Stavovi autora izneseni u ovoj publikaciji ne odražavaju nužno stavove Američke agencije za međunarodni razvoj ili Vlade Sjedinjenih Američkih Država.

This publication is made possible by the support of the American people through United States Agency for International Development (USAID).

### **DISCLAIMER**

The authors' views expressed in this publication do not necessarily reflect the views of United States Agency for International Development or the United States Government.



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUËSE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT



## **E Drejta - Pravo - Law**

### **Redaksia - Redakcija - Editorial Staff**

Anëtarë - Članovi - Members

*Dr. sc. Abdulla Aliu, prof. i rreg., Dr. sc. Haki Demolli, prof. asoc.,*

*Dr. sc. Bedri Peci, prof. asoc., Dr. sc. Visar Morina, prof. ass.,*

*Dr. sc. Qerim Qerimi, prof. ass.*

Kryeredaktor - Glavni urednik - Editor-in-chief

*Dr. sc. Qerim Qerimi*

*Sekretar i redaksisë - Sekretar - Secretary*

*Vigan Qorrolli, MA*

## **Zbatimi i drejtëdrejtë në Kosovë i të drejtave të njeriut të pranuar universalisht – Imperativ i ri në praktikën ligjore**

### **Përmbajtja**

#### **1. Parathënie**

Profesor Dr. Enver Hasani, Kryetar, Gjykata Kushtetuese e Kosovës  
Kelly Gavagan, Drejtor, Programi për Sundimin Efektiv të Ligjit i USAID-it  
në Kosovë.....7

#### **2. Kontrolli abstrakt dhe preventive (paraprak) i amandamenteve kushtetuese dhe mbrojtja nga shkarkimi i shefit të shtetit: rasti i Kosoves**

Prof. Dr. Enver Hasani, Kryetar, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ..... 13

#### **3. Ruajtja e të drejtave të njeriut në gjykatat e Shteteve të Bashkuara – Roli i avokatit mbrojtës dhe gjyqtarit**

I nderuari Michael Davis, Kryetar, Gjykata e Rrethit të Shteteve  
te Bashkuara, Rrethi i Minesotës ..... 151

#### **4. Përdorimi i precedentit për të ndërtuar ligjin – Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës – Programi i Sundimit Efektiv të Ligjit**

I nderuari John R. Tunheim, Gjyqtar, Gjykata e Rrethit të Shteteve  
te Bashkuara, Rrethi i Minesotës ..... 187

#### **5. Përvetësimi Kushtetues i të drejtave ndërkombëtare të njeriut në rendin juridik të Kosovës**

Kushtrim Istrefi, PhD kand., LL.M., Hulumtues në “ Institutin për të drejtën  
publike dhe të drejtën ndërkombëtare Max Planck (Heidelberg)” dhe  
Asistent Ligjërues në Departamentin e të Drejtës Ndërkombëtare  
në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës.....233

#### **6. Aktgjykimet dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës – roli i precedentit dhe fushëveprimi i nenit 116.1 të Kushtetutës së Kosovës**

Visar Morina, Asistent Ligjërues, Fakulteti Juridik, Univerziteti i Prishtinës,  
Këshilltar Juridik, Programi për Sundimin Efektiv të Ligjit i USAID-it në Kosovë .....283

#### **7. Mbrojtja ligjore e te Drejtave te Njeriut ne Irlande**

Michael Bourke, Esq. Këshilltar Ligjor Kryesor, Gjykata  
Kushtetuese e Kosoves.....323

## **Direktna primenljivost univerzalno prihvaćenih ljudskih prava na Kosovu – Novi imperativ u praksi zakona.**

### **Sadržaj**

#### **1. Predgovor**

Profesor Doktor Enver Hasani, Predsednik, Ustavni Sud Kosova  
Kelly Gavagan, Direktor, USAID-ov Program Efikasne Vladavine Prava.....9

#### **2. Abstraktna i Preventivna (Preliminarna) Kontrola Ustavnih Amandmana i zaštita šefa države od razrešenja dužnosti – Slučaj Kosova,**

Prof. Dr. Enver Hasani, Predsednik, Ustavni Sud Kosova ..... 61

#### **3. Odbrana ljudskih prava u sudovima u Sjedinjenim Američkih država – Uloga krivičnog branioca i sudije**

Poštovani sudija Michael Davis, Predsednik, Okružni Sud Sjedinjenih  
Američkih Država, Okrug Minesote ..... 163

#### **4. Korišćenje presedana u stvaranju prava**

Poštovani sudija John R. Tunheim, Sudija, Okružni Sud Sjedinjenih  
Američkih Država, Okrug Minesote ..... 203

#### **5. Ustavno udomaćivanje međunarodnih ljudskih prava u pravnom poretku Kosova**

Kushtrimi Istrefi, PhD kand., LL.M, gostujući predavač na Max Planck institutu za  
komparativno pravo i međunarodno pravo i asistent profesor na katedri  
za međunarodno pravo, Pravni fakultet Univerziteta u Prištini. .... 251

#### **6. Presude i Odluke Ustavnog Suda – Uloga presedana i delokrug člana 116 stava 1 Ustava Kosova.**

Visar Morina, Profesor Asistent, Pravni Fakultet, Univerzitet Pristine,  
Pravni Savetnik, USAID-ov Program Efikasne Vladavine Prava ..... 297

#### **7. Odbrana ljudskih prava u Irskoj**

Michael Bourke, Esq., Glavni Pravni Savetnik, Ustavni Sud Kosova ..... 330

## **Direct Applicability of Universally Accepted Human Rights in Kosovo -The New Imperative in the Practice of Law**

### **Table of Contents**

#### **1. Foreword**

Professor Doctor Enver Hasani, President, Constitutional  
Court of Kosovo  
Kelly Gavagan, Chief of Party, USAID Effective Rule of Law Program .....11

#### **2. Preventive Abstract Control of Constitutional Amendments and Protection of the Head of State from Unconstitutional- Dismissal: The Case of Kosovo,**

Prof. Dr. Enver Hasani, President, Constitutional Court of Kosovo .....105

#### **3. Vindication of Human Rights in the Courts of the United States – The Roles of the Criminal Defense Attorney and Judge**

Honorable Michael Davis, Chief Judge, United States District Court,  
District of Minnesota .....175

#### **4. Using Precedent to Build the Law**

Honorable John R. Tunheim, Judge, United States District Court,  
District of Minnesota .....218

#### **5. Constitutional Domestication of International Human Rights in the Kosovo Legal Order**

Kushtrim Istrefi, PhD cand., LL.M, Visiting Scholar at Max Planck Institute  
for Comparative Public Law and International Law and Assistant  
Professor at the International Law Department, Law Faculty of the  
University of Pristina.....267

#### **6. Judgments and Decisions of the Constitutional Court – The Role of Precedent and the Scope of Article 116.1 of the Constitution**

Visar Morina, Professor Assistant, Faculty of Law, University of Pristina,  
Legal Adviser, USAID Effective Rule of Law Program.....309

#### **7. Vindication of Human Rights in Ireland**

Michael Bourke, Esq., Chief Legal Advisor,  
Constitutional Court of Kosovo .....337



## PARATHËNIE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, me mbështetjen e Programit për Sundimin Efektiv të Ligjit në Kosovë, të USAID-it, ka sponsoruar nje konferencë ndërkombëtare që është mbajtur më 29 dhe 30 qershor 2012, në Prishtinë, Kosovë. Konferenca, në të cilën paraqitën prezantimet e tyre profesorë, gjyqtarë dhe avokatë nga Kosova, Bullgaria, Irlanda dhe Shtetet e Bashkuara është titulluar: “Zbatimi i drejtpërdrejtë në Kosovë i të drejtave të njeriut të pranuara universalisht – Imperativ i ri në praktikën ligjore.” Qëllimi i konferencës ishte që të tubonte në një vend gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarët e Kosovës, prokurorët, avokatët, anëtarët e komunitetit ndërkombëtar, në mënyrë që të fillojnë një dialog të rëndësishëm që synon mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të pranuara universalisht, në gjykatat e Kosovës. Keto të drejta dhe liri themelore të njeriut pranohen në të gjitha republikat moderne, si dhe përshkruhen në Kapitullin 2 të Kushtetutës si dhe në disa konventa dhe pakte ndërkombëtare që janë drejtpërdrejtë të aplikueshme në Kosovë, përmes nenit 22 të Kushtetutës. Që të pranohet natyra universale e këtyre të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si në vendet e të drejtës kontinentale po ashtu edhe në ato të të drejtës anglo-saksone, dy gjyqtarë nga gjykatat Federale të Shteteve të Bashkuara dhe një avokat me përvojë nga Irlanda, prezentuan një pasqyrë mbi thirrjen në të drejtat e njeriut në vendet e tyre.

Profesor Doktor Enver Hasani, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese mori përsipër që Titullin e Konferencës ta trajtojë si temë për ekspozene e tij kyçe, e cila u pasua nga prezantimet formale të temave tjera, si në vijim: “Shfrytëzimi i Vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykatës Kushtetuese në praktikë”, e prezantuar nga Profesor Doktor Snezhana Botusharova, Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese dhe ish Gjyqtare e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; “Thirrja në të Drejtat e Njeriut në Gjykatat e Shteteve të Bashkuara – Rolet e Avokatëve Mbrojtës në çështjet penale dhe roli i Gjyqtarit”, prezantuar nga Kryetari i Gjykatës Michael Davis; “Përvetësimi juridik i të drejtave ndërkombëtare të njeriut në rendin juridik të Kosovës”, prezantuar nga Kushtrim Istrefi, Profesor Asistent, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës; “Aktgjykimet dhe Vendimet e Gjykatës Kushtetuese - Roli i precedentit dhe fushëveprimi i nenit 116.1 i Kushtetutës”, prezantuar nga



Visar Morina, Profesor Asistent, Fakulteti Juridik i Unviersitetit të Prishtinës; “Thirrja në të Drejtat e Njeriut në Irlandë”, prezantuar nga Michael Bourke, Esq., “Roli i Vendimeve të Gjykatave tjera Kushtetuese dhe Gjykatave të Larta, në Jurisprudencën e Kosovës”, prezantuar nga Profesor Doktor Enver Hasani, dhe “Shfrytëzimi i precedentit për avancimin e ligjeve”, prezantuar nga Gjyqtari John R. Tunheim.

Konferenca po ashtu kishte dy panele diskutimi që lejuan kohë të mjaftueshme për pyetje përgjegje nga gjyqtarët, prokurorët dhe anëtarët e Odës së Avokatëve të Kosovës që morën pjesë në Konferencë. Avokatët shfrytëzuan këtë mundësi për të komunikuar tek gjyqtarët dhe prokurorët mesazhin e tyre se gjykatat duhet filluar të marrin me seriozitet çështjen e të drejtave të njeriut në rastet penale.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës dhe Programi për Sundimin Efektiv të Ligjit i USAID-it, dëshirojnë të njohin kontributin e rëndësishëm në zbatimin e të drejtave të njeriut në Gjykatat e Kosovës që do të bëhet me shpërndarjen e këtij numri special të revistës “E Drejta”, dhe me këtë i shprehin mirënjohje Dekanit të Fakultetit Juridik, Profesor Doktor Bajram Uka, Prodekanit të Fakultetit Juridik dhe Kryeredaktorit të revistës “E Drejta”, Profesor Doktor Qerim Qerimi, dhe Bordit Redaktues të revistës “E Drejta”, për publikimin e prezantimeve të rëndësishme në këtë konferencë.

Kelly Gavagan, Drejtor  
Programi për Sundimin Efektiv  
të Ligjit në Kosovë i USAID-it

Profesor Doktor Enver Hasani, Kryetar  
Gjykata Kushtetuese e Republikës së  
Kosovës

## PREDGOVOR

Ustavni sud Republike Kosovo, uz podršku USAID-ovog Programa za efektivnu vladavinu prava, je sponzorisao međunarodnu konferenciju, koja je održana 29. i 30. juna 2012. u Prištini, Kosovo. Naslov konferencije, na kojoj su učestvovali profesori prava, sudije i advokati Kosova, Bugarske, Irske i Sjedinjenih Američkih Država, je bio: „Direktna primenjivost univerzalno prihvaćenih ljudskih prava na Kosovu – Novi imperativ u praktikovanju prava“.

Svrha konferencije je bila okupljanje na jednom mestu sudija Ustavnog suda, kosovskih sudija, tužilaca i advokata, kao i pripadnika međunarodne zajednice, u veoma važnom dijalogu usmerenom ka zaštiti univerzalno prihvaćenih ljudskih prava i osnovnih sloboda u kosovskim sudovima. Ova, univerzalno prihvaćena ljudska prava i osnovne slobode su priznata u svim modernim republikama, i propisana su u Poglavlju II Ustava Kosova, kao i nekoliko međunarodnih paktova i konvencija, koje su na Kosovu direktno primenjive dejstvom člana 22. Ustava. Kako bi se naglasila univerzalna priroda ovih ljudskih prava i osnovnih sloboda u građanskom pravu, kao i u zemljama anglo-saksonskog prava, dvoje federalnih sudija iz Sjedinjenih Američkih Država i jedan iskusan advokat iz Irske su predstavili svoje prezentacije o zaštiti ljudskih prava u svojim zemljama.

Profesor doktor Enver Hasani, predsednik Ustavnog suda, je uzeo naslov konferencije za predmet njegovog ključnog izlaganja, a nakon toga su usledile formalne prezentacije sledećih tema: „Korišćenje presuda Evropskog suda za ljudska prava u praksi“, koju je izložila profesor doktor Snezhana Botusharova, sudija Ustavnog suda i bivši sudija Evropskog suda za ljudska prava; „Zaštita ljudskih prava u sudovima Sjedinjenih Američkih Država – Uloga krivičnog branioca i sudije“, koju je izložio glavni sudija, Michael Davis; „Veličanstveni delokrug članova 22. i 53. Ustava“, koju je izložio Kushtrim Istrefi, asistent profesora na Pravnom fakultetu Prištinskog univerziteta; „Presude i odluke Ustavnog suda – Uloga predsedana i delokrug člana 116.1 Ustava“, „Zaštita ljudskih prava u Irskoj“, koje je izložio Michael Bourke, pravnik; „Uloga odluka drugih ustavnih i viših sudova u kosovskom pravosuđu“, koju je izložio profesor doktor Enver Hasani; i „Korišćenje predsedana kako bi se izgradilo pravo“, koju je izložio sudija John R. Tunheim.

Tokom konferencije su takođe održane dve diskusije u panelima koje su bile praćene odgovarajućim vremenom za pitanja i komentare prisutnih sudija, tužilaca i članova Kosovske advokatske komore. Advokati su iskoristili priliku kako bi ukazali sudijama i tužiocima da sudovi moraju početi da shvataju ozbiljnim pitanje ljudskih prava u krivičnim predmetima.

Ustavni sud Kosova i USAID-ov Program za efektivnu vladavinu prava žele da iskoriste ovu priliku i priznaju značajan doprinos u jačanju ljudskih prava u kosovskim sudovima, što će biti postignuto širokom distribucijom posebnog izdanja časopisa *E Drejta*, i izraze svoju zahvalnost profesoru doktoru Bajramu Uki, profesoru doktoru Qerimu Qerimiju, prodekanu Pravnog fakulteta i glavnom i odgovornom uredniku časopisa *E Drejta*, kao i urednom odboru časopisa, na izdavanju važnih prezentacija koje su iznete na konferenciji.

Kelly Gavagan, Direktor  
USAID-ov Program za efektivnu  
vladavinu prava

Profesor Doktor Enver Hasani, Predsednik  
Ustavni sud Republike Kosovo

## FOREWORD

The Constitutional Court of the Republic of Kosovo, with support from the USAID Effective Rule of Law Program, sponsored an international conference on June 29 and 30, 2012, in Pristina, Kosovo. The conference, which featured presentations by law professors, judges, and lawyers from Kosovo, Bulgaria, Ireland, and the United States, was entitled “Direct Applicability of Universally Accepted Human Rights in Kosovo – The New Imperative in the Practice of Law.”

The purpose of the conference was to bring the Judges of the Constitutional Court, Kosovo judges, prosecutors, and advocates, and members of the international community together to begin an important dialogue directed at the vindication of universally accepted human rights and fundamental freedoms in the courts of Kosovo. These human rights and fundamental freedoms are recognized in all modern republics, and are delineated in Chapter II of the Kosovo Constitution and in several international covenants and conventions that are directly applicable in Kosovo by virtue of Article 22 of the Constitution. To emphasize the universal nature of these human rights and fundamental freedoms, in civil law as well as common law countries, two federal court judges from the United States and an experienced advocate from Ireland made presentations on the vindication of human rights in their countries.

Professor Doctor Enver Hasani, President of the Constitutional Court, took the title of the conference as the subject for his important keynote address, which was followed by formal presentations on the following subjects: “Using European Court of Human Rights and Constitutional Court Judgments in Practice,” presented by Professor Doctor Snezhana Botusharova, Judge of the Constitutional Court and former Judge of the European Court of Human Rights, “Vindication of Human Rights in the Courts of the United States – The Roles of the Criminal Defense Attorney and Judge,” presented by Chief Judge Michael Davis, “Magnificent Scope of Articles 22 and 53 of the Constitution,” presented by Kushtrim Istrefi, Assistant Professor, University of Pristina Faculty of Law, “Judgments and Decisions of the Constitutional Court – The Role of Precedent and the Scope of Article 116.1 of the Constitution,” presented by Visar Morina, Professor Assistant, University of Pristina Faculty of Law, “Vindication of Human Rights in Ireland,” presented by Michael

Bourke, Esq., “Role of Decisions of other Constitutional and High Courts in the Jurisprudence of Kosovo,” presented by Professor Doctor Enver Hasani, and “Using Precedent to Build the Law,” presented by Judge John R. Tunheim.

The conference also featured two panel discussions followed by ample time for questions and comments from the judges, prosecutors, and members of the Kosovo Chamber of Advocates in attendance. The advocates took this opportunity to make their case to the judges and prosecutors that the courts must begin to take human rights issues seriously in criminal cases.

The Constitutional Court of Kosovo and the USAID Effective Rule of Law Program wish to acknowledge the important contribution to the enforcement of human rights in the courts of Kosovo that will be made by the wide distribution of this special issue of *E Drejta*, and to express their gratitude to Professor Doctor Bajram Uka, Dean of the Law Faculty, Professor Doctor Qerim Qerimi, Vice Dean of the Law Faculty and Editor-in-Chief of *E Drejta*, and the Editorial Board of *E Drejta* for the publication of the important presentations made at the conference.

Kelly Gavagan, Director  
USAID Effective Rule of Law  
Program

Professor Doctor Enver Hasani, President  
Constitutional Court of the Republic of  
Kosovo

Prof. dr. Enver Hasani

## **KONTROLI ABSTRAKT DHE PREVENTIV (PARAPRAK) I AMENDAMENTEVE KUSHTETUESE DHE MBROJTJA NGA SHKARKIMI I SHEFIT TË SHTETIT: RASTI I KOSOVËS**

### **Abstrakt**

*Ky punim sqaron rolin dhe pozitën e shefit të shtetit nga perspektiva krahasuese, si dhe mbrojtjen e këtij institucioni kushtetues nga shkarkimi jokushtetues përmes amendamenteve kushtetuese. Pika nisëse e punimit është ushtrimi nga ana e Gjykatës Kushtetuese e kontrollit preventiv abstrakt kushtetues të njëmbëdhjetë (11) amendamenteve të propozuara kushtetuese. Gjykata i shpalli jokushtetues mbi gjashtëdhjetë (60) përqind të tyre, përfshirë dhe amendamentin dhjetë (10), i cili është objekt diskutimi parësor në këtë shkrim. Me këtë rast, Gjykata e ka bërë të qartë se ndërprerja e parakohshme e mandatit të shefit të shtetit përmes nxjerrjes së amendamenteve të reja kushtetuese është jokushtetues. Ky shkrim përfundimisht provon në mënyrë shkencore se nuk ekziston një gjykatë serioze e cila do të mund të merrte parasysh argumentet ad hominem në rastet që kanë të bëjnë me kontrollin abstrakt të ligjeve dhe të amendamenteve kushtetuese dhe sërish të quhej gjykatë profesionale.*

**Fjalët çelës:** drejtësia kushtetuese; roli kushtetues i shefit të shtetit; debati Hans Kelsen-Karl Shmit ; Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

### **Hyrje**

Polemika e zhvilluar ndërmjet dy luftërave botërore, në vitet e '30-ta të shekullit të kaluar, ndërmjet dy filozofëve më me ndikim të drejtësisë dhe të politikës, Karl Shmit dhe Hans Kelsen, pa asnjë dyshim se prek themelet teorike e praktike të institucionit kushtetues që quhet shefi i shtetit, të formës dhe përmbajtjes së tij. Kjo vlen si për presidentin e republikës, ashtu dhe për monarkun. Debati në fjalë është aktual dhe i rëndësishëm edhe sot e gjithë ditën, po aq sa ka qenë aktual dhe i rëndësishëm edhe në kohën kur u zhvillua.

Rëndësia e tij në Kosovë vjen e shtohet aktualisht, në një kohë kur synohet me çdo kusht krijimi i një debati politik kontestues ndaj vendimit të fundit të Gjykatës Kushtetuese<sup>1</sup>.

Shmitianët e kelsenianët e kontekstit kosovar nuk ravijëzohen, e aq më pak nuk modelohen, për dallim nga autorët originalë të polemikës në fjalë, sipas kritereve ideologjike, partiako-politike, apo sipas ndonjë doktrine të veçantë kushtetuese. Varfëria ideologjiko-politike dhe teoriko-kushtetuese e debatit kosovar për “çështjen e presidentes Jahjaga” nuk është e vetme: një situatë e tillë, pak a shumë, sundon diskursin publik kosovar edhe kur flitet për

1 Aktgjykimi në rastet KO29/12 dhe KO48/12, i datës 20 korrik 2012 (Nr. ref. AGJ 284/12). Ky aktgjykim, nga kontestuesit e tij, u quajt pa të drejtë “vendimi i Kushtetueses mbi Presidenten e Kosovës, znj. Atifete Jahjaga”. Duhet të theksojmë, megjithatë, se Aktgjykimi ka të bëjë me kontrollin abstrakt dhe preventiv (paraparak) të propozim-amendamenteve kushtetuese në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të cilat, në pajtim me nenin 144 (1) të Kushtetutës, e në lidhje me nenin 113 (9) të saj, u propozuan nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit 120-anëtarësh të Republikës së Kosovës. Kryetari i Kuvendit, sipas dispozitave të sipërcekura kushtetuese, është i vetmi që ka tagër (autorizim) kushtetues për t’i dërguar në Gjykatë Kushtetuese amendamentet e propozuara nga subjektet kushtetuese të nenit 144 (1) të Kushtetutës, me qëllim të kontrollit preventiv (paraparak) të kushtetutshmërisë së tyre. Një grup tjetër, Komisioni për ndryshime kushtetuese, ka synuar tërë kohën t’i prijë kontestimit të fuqisë juridike-kushtetuese të këtij aktgjykimi. Ai kontestim, më 25 shtator 2012, shkoi aq larg sa deshi të vërë në pikëpyetje vetë dispozitat kushtetuese të neneve 113 (9) dhe 144 (3) të Kushtetutës, të cilat e mandatojnë Gjykatën Kushtetuese për të ushtruar kontroll abstrakt dhe preventiv (paraparak) të kushtetutshmërisë së çdo amendamenti kushtetues të propozuar juridikisht në mënyrë të rregullt: Komisioni deklaroi se, amendamentet e shpallura si jokushtetuese nga Gjykata, mund të votohen në Kuvend, përkundër asaj që Gjykata mbi 60 (gjashtëdhjetë) për qind të tyre i ka shpallur si jokushtetuese. (Cf. Besnik Krasniqi, “Bajrami: Amendamenti 10 do të hidhet për votim në Kuvend”, gazeta e përditshme “Koha ditore”, e mërkurë, 26 shtator 2012, fq. 2).

Kontrolli preventiv (paraparak) i kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese bëhet para se ato të votohen në Kuvend. Gjykata vlerëson in abstracto nëse amendamentet që propozohen zvogëlojnë të drejtat dhe liritë nga Kapitulli II i Kushtetutës. Kuvendi i Kosovës nuk guxon të votojë amendamentet, të cilat janë shpallur si jokushtetuese nga Gjykata. Kjo shprehimisht parashihet në nenet 113 (9) dhe 144 (3) të Kushtetutës së Kosovës. Për praktikat komparative të kontrollit kushtetues abstrakt dhe preventiv (paraparak) të amendamenteve kushtetuese do të flitet më shumë në vijim të shkrimit.

Sikundër që do të vërehet në vijim, qëllimi primar i hartuesve të këtyre amendamenteve ka qenë që “ta konstitucionalizojnë” (t’i japin fuqi dhe legjitimitet kushtetues) një marrëveshje politike, të lidhur në prill të vitit 2011, ndërmjet aktorëve kyç të politikës kosovare, marrëveshje e cila në veçanti sanksiononte shkarkimin e shefit të shtetit të Kosovës, presidentes aktuale, znj. Atifete Jahjaga, nëpërmjet amendamenti kushtetues. Përveç kësaj, amendamentet në fjalë, në pjesën dërrmuese, synonin konstitucionalizimin e konjunkturave të interesit momental politik, të cilat lidhen me rolin dhe me pozitën e sistemit të drejtësisë si dhe me pozitën e natyrën e kompetencave të ushtruesit të detyrës së Presidentit të Kosovës. E tërë kjo përpjekje është bërë, duke i pasur parasysh sjelljet e ish-ushtruesit të detyrës së Presidentit, gjatë kohës që i parapriu zgjedhjes së znj. Atifete Jahjaga për president të Kosovës (shtator 2010 – prill 2011).

çështjet e tjera. Diskursi, që konteston aktgjykimin në fjalë të Gjykatës Kushtetuese, bazohet në tërësi në kritere joprofesionale dhe pa fije respekti për rregullat themelore profesionale, të cilat vlejnë kur kontestohet një vendim i një organi jopolitik dhe të pavarur, siç është Gjykata Kushtetuese. Në esencë, siç do të shihet, më shumë bëhet fjalë për një diskurs mohues, që konteston *en generale* punën e Gjykatës dhe që për synim primar ka prodhimin e një debati *pro et contra* vendimit në fjalë në nivelin gjithëkosovar. Megjithatë, ky synim nuk është arritur as për së afërmi, për shkak të fuqisë së dobët të argumenteve mbi të cilat mbështetet. Si protagonist kryesor të vetin, ky diskurs, ka, në njërin anë, zyrtarët e lartë të partisë kryesore opozitare në Kosovë, LDK (Lidhja Demokratike e Kosovës), dhe, në anën tjetër, anëtarët kyç të Komisionit për ndryshime kushtetuese, i cili kryesisht dominohet nga përfaqësues të partisë në pushtet, PDK (Partia Demokratike e Kosovës).<sup>2</sup>

Siç dihet nga historia e teorisë kushtetuese, debati Shmit – Kelsen është bërë për atë se kush është, apo kush duhet të jetë, garant i kushtetutës. Gjatë atij debati fillestar, është hedhur dritë edhe për rolin dhe për rëndësinë e shefit të shtetit (kryesisht) në demokracitë parlamentare me rregullim (kryesisht) republikan. Një pjesë e madhe e atij debati kishte të bënte me shefin e shtetit, si përfaqësues i unitetit të popullit, dhe me mospajtimin konceptual përkitazi me atë nëse ky unitet është sociologjiko-politik, apo nëse ka natyrë ekskluzivisht juridiko-kushtetuese. Të parën pikëpamje e ndërtoi dhe e mbështeti deri në fund Karl Shmit, kurse të dytën – Hans Kelsen. Nuk ka asnjë dyshim se, drita e hedhur nga këta dy autorë, ka shërbyer si një udhërrëfyes për teorinë dhe për praktikën shtetërore bashkëkohore që merret me pozitën dhe me rolin e shefit të shtetit në demokracitë parlamentare kushtetuese. Në diskutimet e tyre për rolin dhe për pozitën kushtetuese të shefit të shtetit, ata kanë trajtuar, në esencë, çështje që paraqesin vetë themelet e demokracisë kushtetuese dhe përbërësit kryesorë të saj, siç janë: ndarja e pushteteve dhe

---

2 Ky komision vetvetiu nuk është kushtetues, meqë palë e autorizuar për të propozuar ndryshime dhe amendamente janë vetëm Qeveria, Presidenti ose një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit (neni 144.1 i Kushtetutës). Vetëm këto subjekte, askush tjetër, mund të propozojnë ndryshime dhe amendamente të Kushtetutës.

Synimi i këtij komisioni për t'u paraqitur palë në procedurë pranë Gjykatës, ka shkaktuar telashe të natyrës procedurale dhe konfuzion. Në dispozitën e nenit 113 (9) të Kushtetutës, ndër të tjera, thuhet: "Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë (në Gjykatën Kushtetuese – vërejtja jonë) amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës". Pra, si palë para Gjykatës, mund të jetë vetëm kryetari i Kuvendit, per constitutionem, kurse, si propozues i ndryshimeve dhe i amendamenteve, sipas nenit 144 (1) mund të jenë vetëm Qeveria, Presidenti ose një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit. Siç u tha, ky komision është formuar ad hoc, nëpërmjet një marrëveshjeje politike të liderëve të tri forcave kryesore politike: PDK (Partia Demokratike e Kosovës), LDK (Lidhja Demokratike e Kosovës) dhe AKR (Aleanca Kosova e Re). Kryetari i këtij komisioni është nga partia në pushtet, PDK, kurse partitë e tjera marrin pjesë sipas fuqisë politike që kanë.



sundimi i ligjit, respekti për drejtat e njeriut dhe të minoriteteve dhe demokracia<sup>3</sup>. Këto aspekte të debatit në fjalë, po ashtu, përvijohen gjatë shtjellimeve tona në këtë temë.

Koncepti i shefit të shtetit, si përfaqësues i unitetit sociologjiko-politik, të Karl Shmit, është mjaft i strukturuar dhe përfundon në personin e Fyhrerit, i cili gjendet në krye të piramidës shtetërore si mishërim i unitetit të tillë. Te Hans Kelsen, po ashtu, koncepti është mjaft i strukturuar, por, në një mënyrë e në një kahe tjetër, krejt të kundërt, me atë të K. Shmitit. Shefi i shtetit, të H. Kelsen, del si mishërim i unitetit juridiko-kushtetues të popullit, kurse, në krye të piramidës shtetërore, gjendet norma bazë ("*grundnorm*"), të cilën shefi i shtetit duhet ta vërë në jetë krahas me institucionet e tjera kushtetuese. Derisa teoria e parë është në esencë diktatoriale, e dyta paraqet të kundërtën e saj.

Me kalimin e kohës, teoria e dytë u bë vetë thelbi i asaj që tashmë njihet si teoria dhe praktika për demokracinë kushtetuese. Thënë më saktë, teoria e dytë, për dallim nga e para, e cila vuri themelet e arsyesimit irracional të diktaturës naziste, shërbeu si substrat i teorisë dhe i praktikës së konstitucionalizmit modern që mori hov pas Luftës së Dytë Botërore.

Siç u tha, në rastin e Kosovës, në esencë, kemi të bëjmë me pamundësinë e ushqimit dhe të vënies në lëvizje të një debati publik serioz dhe të argumentuar me terma shkencorë e intelektualë. Në vend të kësaj, pas vendimit në fjalë të Gjykatës, u nis një diskurs kontestues, në shikim të parë sporadik, ku protagonistë kryesorë u shfaqën zyrtarët e lartë të LDK-së, si parti më e madhe opozitare, dhe anëtarët e Komisionit kushtetues. Në anën tjetër, në mënyrë të sforcuar dhe me çdo kusht, u synua që Gjykata Kushtetuese të paraqitet si pjesë e këtij diskursi. Gjykata, u mor vesh, nuk mund të pranojë një "ftesë" të tillë, edhe për faktin se, në Aktgjykimin e saj me mbi dyzet faqe, ka shkrirë tërë arsenalin profesional teoriko-kushtetues dhe praktik, me qëllim të mbrojtjes së vlerave e të parimeve të konstitucionalizmit perëndimor, të cilat janë të mishëruara në çdo dispozitë të Kushtetutës së Kosovës.

Çështja, që diskutohet në këtë shkrim, u nis në vijim të kontrollit abstrakt dhe preventiv (paraprak) të kushtetutshmërisë së 11 (njëmbëdhjetë) amendamenteve të propozuara nga një grup deputetësh të Kuvendit të Kosovës. Gjykata e ushtron *per constitutionem* këtë juridiksion, çdo herë kur ka propozime për ndryshim apo për amendamentim të Kushtetutës, sipas nenit 144 të Kushtetutës. Ky proces amendamentimi ka qenë pjesë e një marrëveshjeje të mëhershme politike të forcave kryesore politike. Nevoja

3 Për një trajtim të thellë të pikave kyç të debatit kushtetues K. Shmit – H. Kelsen, cf. Michael Stollies, *A History of Public Law in Germany: 1914-1945* (Oxford University Press: Oxford, 2004), në veçanti kapitulli 3 ("*Revolution, Weimar Constitution, and Versailles*") dhe kapitulli 5 ("*Quarrel Over Methods and the Crisis of the State*").

për amendamentim, ndërkaq, u pa atëherë kur, brenda një kohe të shkurtër (shtator 2010 – prill 2011), Gjykata “rrëzoi” dy presidentët e Kosovës, në vijim të mbrojtjes së parimeve, të vlerave dhe të normave kushtetuese që kanë të bëjnë më rolin, me pozitën dhe me natyrën e institucionit të Presidentit të Republikës.<sup>4</sup> Kjo do të thotë se, pa u kuptuar sfondi i ngjarjeve dhe i rrethanave që lidhen me dy aktgjykimet për dy ish-presidentët e Kosovës, nuk mund të kuptohet esenca e vendimit që diskutohet këtu dhe që ka të bëjë me kontrollin abstrakt dhe preventiv (paraprak) të 11 (njëmbëdhjetë) propozim-amendamenteve kushtetuese në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Një pjesë e këtyre amendamenteve të propozuara kishte të bënte me mënyrën dhe me kohën e zgjedhjes së presidentit të ardhshëm të Kosovës. Pikërisht kjo pjesë, përkatësisht propozimi i amendamentit 10 (dhjetë), i cili kishte të bënte me shpalljen e zgjedhjeve të para presidenciale kosovare, u dramatizua në publik, duke i lënë nën hije aspektet e tjera tepër të rëndësishme të Aktgjykimit. U krijua një diskurs, në shikim të parë krejt spontan por në thelb krejt i planifikuar dhe malicioz, i cili mbështetet hapur në legjitimitetin e teorisë dhe të praktikës kushtetuese për unitetin sociologjiko-politik të popullit dhe për dominimin e shumicës ndaj të tjerëve. Si i tillë, ky diskurs kontestues, përshkon të gjitha aspektet e demokracisë kushtetuese dhe nuk kufizohet vetëm në rëndësinë, në rolin dhe në pozitën e shefit të shtetit të Kosovës.

Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, që shpall jokushtetuese mbi 60 (gjashtëdhjetë) për qind të 11 (njëmbëdhjetë) amendamenteve të propozuara, është objekt shqyrtimi në pjesën e parë të këtij shkrimi. Kjo pjesë pasohet nga e dyta, e cila ka titullin në gjuhën frënge, sepse ashtu është përdorur për herë të parë nga Benjamin Konstan dhe nga autorët e tjerë të shekullit XIX. Ky koncept, pra “*il regne et ne gouverne pas*” (“Shefi i shtetit mbretëron, por nuk qeveris”), ka dashur të sqarojë se të ashtuquajturat *pouvoir neutre et intermediaires* (“Autorizimet neutrale dhe të ndërmjetme”) të shefit të shtetit në demokracitë kushtetuese parlamentare, shikuar historikisht, nuk ekzistojnë, për të krijuar një pushtet tjetër krahas atij ekzekutiv, legjislativ e gjyqësor. Ato autorizime, përkundrazi, shërbejnë për t’i mundësuar një të treti, i cili quhet shef i shtetit, që të balancojë pushtetet e tjera, duke garantuar funksionimin e qetë e normal të institucioneve kushtetuese.<sup>5</sup> Këto autorizime përcaktojnë

4 Cf. fusnotat 6 dhe 9 dhe tekstin që i shoqëron.

5 Ky rol i shefit të shtetit ekziston dhe sanksionohet në të gjitha vendet evropiane, me përjashtim të Francës, e cila ka sistem gjysmëpresidencial, ku shefi i shtetit ka pjesëmarrje të madhe në ekzekutivin e vendit. Kosova nuk bënë përjashtim në këtë drejtim. Dispozitat e neneve 4 (para. 3) dhe 83 e bëjnë të qartë një gjë të tillë:

Neni 4, paragrafi 3 (Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit): “Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë”.

përmbajtjen e sintagmës në gjuhën frënge “*il regne et ne gouverne pas*”. Ato, në thelb, pasqyrojnë vetë esencën e pozitës, të rolit dhe të rëndësisë që ka shefi i shtetit në një sistem të qeverisjes që quhet demokraci kushtetuese.

Pjesa e tretë vjen natyrshëm dhe prek thelbin e diskursit aktual që konteston Aktgjykimin e Gjykatës për 11 (njëmbëdhjetë) propozim-amendamentet kushtetuese. Në trajtimin tonë këtu, njëjtë siç ka bërë Gjykata, nuk merremi dhe nuk flasim *ad hominem* për shefin aktual të shtetit të Kosovës. Trajtimi mëton që deri në fund të jetë akademik e profesional dhe ka për qëllim primar mbrojtjen e institucionit të shefit të shtetit, në kontekstin e sotëm kosovar dhe në dritën e debatit gjithnjë aktual dhe shkencor Shmit – Kelsen. Kjo mbrojtje, këtu, vlen për të gjitha situatat e për të gjitha kohët, në të cilat mund gjendet një shef shteti, i rrezikuar nga shkarkimi ekstrakushtetues nëpërmjet amendamentimit të tekstit ekzistues të kushtetutës.

Misioni i përbashkët i drejtësisë dhe i teorisë kushtetuese konsiston në mbrojtjen e parimeve dhe të vlerave të ideologjisë së konstitucionalizmit modern perëndimor. Çdo argumentim *ad hominem* i një institucioni kushtetues është i huaj për konstitucionalizmin modern dhe për teorinë kushtetuese, siç do të shihet në shtjellimin tonë në pjesën e katërt dhe të fundit të këtij punimi.

Përfundimet tona ndjekin frymën e shtjellimit përgjatë këtij teksti dhe rrjedhshëm reflektojnë përfundimet e secilës prej katër pjesëve të shkrimit.

## I. Historiku i një vendimi, forma dhe përmbajtja e tij

Vendimi i sipërcekur, që është objekt analize këtu, ka formën e aktgjykimit. Atij i ka paraprirë një proces politik, i cili u zhvillua pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, të datës 30 mars 2011, me të cilin qe shpallur jokushtetuese zgjedhja e z. Behgjet Pacolli president i Kosovës nga Kuvendi i Republikës.<sup>6</sup> Gjykata nuk i dha fuqi retroaktive vendimit për “rastin Pacolli”, duke i njohur kështu si të vlefshme të gjitha veprimet dhe punët e kryera nga z. Pacolli si ish-president i Kosovës. Më këtë qasje, Gjykata konfirmoi teorinë e praktikën dominante kushtetuese bashkëkohore, e cila ia njeh shefit të shtetit të drejtën e identifikimit juridiko-kushtetues me shtetin, si brenda ashtu dhe jashtë tij. Nuk ka rëndësi fare kush e ushtron atë funksion *ad hominem*: një shtet serioz nuk guxon për asnjë moment të ndërpresë jetën e vet institucionale, jetë kjo që mishërohet dhe që personifikohet, *inter alia*, nga personaliteti i shefit

---

Neni 83 (Statusi i Presidentit): “Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës”.

6 Rasti KO29/11. Sabri Hamiti dhe deputetët e tjerë: Vlerësimi kushtetues i vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, i 22 shkurtit 2011, përkitazi me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës; Aktgjykimi i 30 marsit 2011.

të shtetit.<sup>7</sup> Kjo do të thotë se shefi i shtetit i mbijeton ndryshimet sociologjiko-politike, të cilat ndodhin në shtet, sepse paraqet mishërim të vetë thelbit të kontinuitetit shtetëroro-juridik.

Teoria e mbijetimit të ndryshimeve nga shefi i shtetit është njohur dhe është zhvilluar nga Benjamin Konstan, në shtjellimet e tij dhe të autorëve të tjerë të shekullit XIX, në kontekstin e monarkive kushtetuese të kohës. Ato shtjellime kishin të bënin me sqarimin e rolit dhe të rëndësisë së monarkut, si shef shteti në monarkitë evropiane gjatë kohës së Napoleonit dhe pas kohës së Napoleonit.<sup>8</sup> Këtë aspekt, të reflektimit të shefit të shtetit në kontinuitetin shtetëror e juridik, e ka sanksionuar dhe e ka shtjelluar Gjykata në Aktgjykimin për rastin e ish-presidentit Behgjet Pacolli, duke e njohur si të vlefshëm dhe me fuqi e me kompetencë kushtetuese çdo akt dhe çdo veprim të ndërmarrë nga ai. Me të njëjtin aktgjykim, Gjykata e riktheu kryetarin e Kuvendit në vendin e tij të ushtruesit të detyrës së shefit të shtetit kosovar, duke mos lënë kështu, për asnjë moment, asnjë vakuum juridiko-kushtetues në funksionimin e institucionit të Presidentit të Kosovës.<sup>9</sup> Pas aktgjykimit në fjalë për “rastin Pacolli”, u hapën rrugët drejt zgjedhjes së shefit të ri të shtetit, gjithnjë duke pasur parasysh respektimin deri në fund të dispozitave kushtetuese për zgjedhjen e të parit të institucionit në fjalë.

---

7 Te Hans Kelsen, ky personifikim lidhet me kategorinë e atribuimit (mvshjes). Sipas tij, çdo akt që mund t'i atribuohet (mvshet) shefit të shtetit është akt i shtetit. E njëjta gjë vlen edhe për aktet e bartësve të tjerë të autorizimeve publike kushtetuese. Kjo teori është shtjellim i nisur nga juristi i njohur gjerman Georg Jellenik, gjë të cilën e pohon edhe vetë Hans Kelsen. Georg Jellenik ka folur i pari për kontinuitetin juridik të shtetit, i cili realizohet nëpërmjet veprimit të organeve të tij. Para kohës së Napoleonit, përkatësisht në kohën nga Paqja e Vestfalisë (1648) deri te Revolucioni Francez i vitit 1878, debatet për subjektivitetin shtetëror kanë qenë të fokusuar në subjektivitetin juridiko-ndërkombëtar të shtetit. Vetëm pas Revolucionit Francez e tutje, u hap debati për subjektivitetin juridiko-kushtetues të shtetit dhe për pasojat e tij për rendin e brendshëm kushtetues. Cf. Clemens Jabloner, Hans Kelsen: Introduction. Në Arthur J. Jacobson and Bernhard Schlink (eds.), *Wiemar. A Jurisprudence of Crisis* (University of California Press: Berkeley and Los Angeles, 2000) fq. 67-76; Hans Kelsen, “Legal Formalism and the Pure Theory of Law”. Në Arthur J. Jacobson and Bernhard Schlink (eds.), *Wiemar. A Jurisprudence of Crisis*, fq. 77-84; Hans Kelsen, *General Theory of Law and State* (The Lawbook Exchange, LTD.: Clark, New Jersey, 2009), fq. 181-207; Janne Elisabeth Nijman, *The Concept of International Legal Personality: An Inquiry Into the History and Theory of International Law* (T.M.C. Asser Press: The Hague, 2004), në veçanti kapitulli 2 (“Historical Introduction: Leibniz and the Emergence of the Concept of ILP”) dhe kapitulli 3 (“Demystifying the ILP: Briery, Kelsen and Scelle”).

8 Cf. Biancamaria Fontana (ed), Benjamin Constant: *Political Writings* (Cambridge University Press: Cambridge, 2010) fq. 171-328.

9 Behgjet Pacolli është zgjedhur president i Kosovës më 22 shkurt 2001 dhe ka ushtruar këtë funksion deri më 30 mars 2011, kur Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se ka pasur shkelje të Kushtetutës me rastin e zgjedhjes së tij dhe, për pasojë, ka anuluar me efekt jo-prapaveprues vendimin e Kuvendit, Nr. 04-V-04, të 22 shkurtit 2011, përkitazi me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës.

Konstatimi i Gjykatës, me të cilin shpall jokushtetues vendimin e Kuvendit për zgjedhjen e z. Pacolli president të Kosovës, ka pasur tri lloj pasojash kushtetuese: e para, ai ka qenë president, kurse veprimet e aktet e tij të kryera përgjatë më shumë se një muaji i atribuohen (i mvishen) atij dhe vetëm atij; e dyta, zgjedhja e tij ka qenë jokushtetuese dhe, për pasojë, me rastin e zgjedhjes së shefit tjetër të shtetit kosovar duhet respektuar Kushtetuta deri në fund; dhe, e treta, me rikthimin e kryetarit të Kuvendit në pozitën e ushtruesit të detyrës së shefit të shtetit kosovar është bërë e qartë se Kosova nuk ka jetuar për asnjë moment pa kreun e vet të shtetit.

Pak ditë pas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, që mohonte kushtetutshmërinë e vendimit të Kuvendit për zgjedhjen e z. Behgjet Pacolli president të Kosovës, forcat kryesore politike në vend arritën një marrëveshje politike, e cila kishte për qëllim primar tejkalimin e krizës së krijuar politike. Kjo marrëveshje u arrit më 6 prill 2011 dhe u nënshkrua nga kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi, në emër të PDK-së; nga prof. Isa Mustafa, në emër të LDK-së, partisë më të madhe opozitare; dhe nga ish-presidenti i Kosovës, z. Behgjet Pacolli, në emër të AKR-së, si parti e koalicionit qeverisës. Me këtë marrëveshje, palët nënshkruese, në emër të përkushtimit të tyre për t'i vënë interesat e vendit mbi interesin e tyre, u dakorduan për sa vijon:

- që të nominojnë zonjën Atifete Jahjaga si kandidate të përbashkët për presidente të Republikës së Kosovës;
- që të fillohet me amendamentimet e Kushtetutës dhe të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ashtu që ato të reflektojnë konceptin e ri të zgjedhjeve të drejtpërdrejta për president republike, me të gjitha ndryshimet në pozitën dhe në rolin e presidentit të Republikës, që mund të burojnë nga ndryshimi i mënyrës së zgjedhjes së shefit të shtetit;
- që zgjedhjet e para për president të Republikës të mbahen jo më vonë se gjashtë muaj nga data në të cilën hyjnë në fuqi ndryshimet e nevojshme kushtetuese e ligjore; dhe, së fundi,
- që zgjedhjet e përgjithshme, sipas Ligjit të reformuar për zgjedhjet e përgjithshme dhe me amendamentet përkatëse, të mbahen jo më vonë se 18 muaj nga hyrja në fuqi e këtyre amendamenteve ligjore e kushtetuese.

Ditën e nesërme, më 7 prill 2011, Kuvendi i Kosovës nxori një rezolutë me të cilën mbështeti marrëveshjen e arritur.<sup>10</sup> Kjo rezolutë e Kuvendit mbështete në tërësi marrëveshjen politike. Për më tepër, këtë e bënte duke e parafrazuar tekstin e saj në tërësi. Duhet thënë, megjithatë, se ka një dallim

<sup>10</sup> Rezoluta Nr. 04-R-02, e datës 7 prill 2011, e Kuvendit të Kosovës, me të cilën mbështetet arritja e marrëveshjes politike të 6 prillit 2011. Rezoluta u miratua me 75 vota për, me 2 abstenime dhe me 1 votë kundër.

substancial ndërmjet tyre. Ai ndryshim konsiston në faktin se, në paragrafin e fundit, Rezoluta thotë se mbështetjen e marrëveshjes politike e bën duke u bazuar në tërësi në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ky ka qenë sfondi i ngjarjeve dhe vetë konteksti politik kur Kuvendi votoi zonjën Atifete Jahjaga presidente të Kosovës, më 7 prill 2011. Ajo u zgjodh në raundin e parë.<sup>11</sup> Jo shumë pas kësaj, Kuvendi formoi dy komisione, të cilat ishin paraparë me marrëveshjen politike, dhe atë: Komisionin për ndryshime kushtetuese dhe Komisionin për ndryshimet përkatëse të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë.<sup>12</sup> Kryetari i Kuvendit, dr. Jakup Krasniqi, të njëjtën ditë, ka tërhequr vërejtjen për jokushtetutshmërinë e komisioneve, duke vënë në pah se ato kishin ekskluzivisht natyrë politike. Dr. Jakup Krasniqi shkoi një hap më tutje, kur tha se, me formimin e tyre, në fakt, po shkelej Kushtetuta e Kosovës. Ky reagim i tij, megjithatë, nuk u miratua nga deputetët kosovarë, të cilët votuan themelimin e dy komisioneve të përmendura.<sup>13</sup>

Komisioni për reformën zgjedhore nuk arriti ndonjë rezultat konkret deri në kohën e shkrimit të këtij punimi (nëntor 2012): ai ndërpreu punën si pasojë e mospajtimeve politike ndërmjet pozitës dhe opozitës.<sup>14</sup> Komisioni tjetër, Komisioni për amendamentimet kushtetuese, arriti të dorëzojë, në mars të këtij viti, një draft të vetin të kryetari i Kuvendit të Kosovës. Siç u cek më herët, sipas nenit 113 (9) të Kushtetutës, kryetari i Kuvendit ka detyrim kushtetues që çdo amendamentim të Kushtetutës t'ia referojë Gjykatës për kontroll kushtetues abstrakt dhe preventiv (paraprak). U mor vesh, kryetari i Kuvendit, si palë e autorizuar pranë Gjykatës, i referon amendamentimet vetëm nëse ato janë bërë sipas nenit 144 (1) të Kushtetutës. Në rastin konkret, kjo nënkupton se ato propozim-amendamente do të duhej të kishin nënshkrimet e më së paku 30 deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

---

11 Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-11, i datës 7 prill 2011, për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës.

12 Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-12, i datës 22 prill 2011, për formimin e Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-13, i datës 22 prill 2011, për formimin e Komisionit për amendamentimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

13 Dr. Jakup Krasniqi, "Për mandatin e presidentes të flasin Thaçi, Mustafa e Pacolli, gazeta e përditshme "Epoka e re", e hënë, 9 korrik 2012, fq. 4-5 (intervistë).

14 Komisioni për reformën zgjedhore, siç u njoh në publik, u kryesua nga dr. Haki Demolli i LDK-së. Puna e tij u ndërpre në fund të gushtit 2012, "sepse nuk ekzistoi vullneti në anën e nënshkruesve të marrëveshjes politike për implementimin e saj dhe të Rezolutës së Kuvendit me të cilën u përkrah marrëveshja politike për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme presidenciale, siç parashihej me dy këto dokumente". Deklaratë e dr. Haki Demollit, kryetar i Komisionit, dhënë autorit të këtyre rreshtave, më 24 nëntor 2012.

Kontrolli që ushtron Gjykata, është kontroll kushtetues abstrakt dhe preventiv (paraprak). Ai konsiston në vlerësimin nëse ndonjë amendament i propozuar zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës. Dispozita e nenit 113 (9) të Kushtetutës paraqet versionin kosovar të asaj që, në teorinë dhe në praktikën kushtetuese komparative, identifikohet me emra të ndryshëm, siç janë: “klauzola e përjetësisë” (“eternity clause”), “dispozitat kushtetuese që nuk mund të ndryshohen” (“unamendable constitutional provisions”), “amendamentet kushtetuese jokushtetuese” (“unconstitutional constitutional amendments”), “dispozitat e rrënjosura në mënyrë absolute” (“absolutely entrenched provisions”), etj. Këto çështje do të diskutohen sërish më vonë, në pjesën e fundit të këtij punimi. Këtu mjafton të thuhet se, si të tilla, këto dispozita e parime kushtetuese gjenden në mjaft kushtetuta të botës, kurse origjinën e kanë në teorinë e në praktikën gjermane. Vetë koncepti i tyre ka dalë nga mendja e Karl Shmitit, në një analizë të tij për legalitetin dhe për legjitimitetin e Kushtetutës së Vajmarit. Teoria e praktika gjermane, pas Luftës së Dytë Botërore, sërish me sugjerimin e tij, pranoi futjen e këtij koncepti në Ligjin Themelor të Gjermanisë (1949).<sup>15</sup>

Po të mos ekzistonte kjo dispozitë e nenit 113.9 në Kushtetutën e Kosovës, e cila mundëson kontrollin abstrakt dhe preventiv (paraprak) të çdo amendamenti kushtetues para se të shkojë për miratim në Kuvend, diçka që nuk njihet në shume vende të botës,<sup>16</sup> sigurisht që nuk do të ekzistonte as diskursi

15 Këtu bëhet fjalë për nenin 79.3 të Ligjit Themelor të Republikës Federale të Gjermanisë. Kjo dispozitë e Ligjit Themelor të Republikës Federale të Gjermanisë parasheh si vijon: “(Amendamenti i Ligjit Themelor): (1) Ky Ligj Themelor mund të amendamentohet vetëm me një ligj i cili në mënyrë shprehimore amendamenton ose plotëson tekstin e tij. Në rastet e traktatit ndërkombëtar mbi paqen, përgatitjen e paqes, përfundimin gradual të një regjimi okupues, apo kur skicohet promovim i mbrojtjes së Republikës Federale të Gjermanisë, do të jetë e mjaftueshme nëse thuhet se dispozitat e këtij Ligji Themelor nuk përjashtojnë lidhjen dhe hyrjen në fuqi të një traktati të tillë ndërkombëtar dhe nëse ky sqarim futet në tekstin e ligjit të ri që amendamenton këtë Ligj Themelor; (2) Çdo ligj i tillë miratohet me dy të tretat e anëtarëve të Bundestagut dhe dy të tretat e votave të Bundesratit; (3) Nuk lejohen amendamentet e Ligjit Themelor që prekin ndarjen e Federatës në lande, pjesëmarrjen e landeve në procesin legjislativ, si dhe ato që kanë të bëjnë me parimet e cekura në nenet 1 dhe 20”.

Përveç Gjermanisë, dispozita të tilla ka gjithandej në Evropë (Norvegjia, Italia, Franca, Turqia), në Afrikë (Afrika e Jugut, Maroku), në Azi (India), në Amerikë Latine (Kili), etj.

16 Kontrolli preventiv, si në rastin e Kosovës, është i rrallë dhe ekziston vetëm në disa vende, siç janë Azerbajxhani, Kirgizia, Moldavia, Turqia dhe Ukraina. Cf. analizën komparative të Komisionit të Venedikut: Report on Constitutional Amendment, Adopted by The Venice Commission at Its Plenary Session (Venice, 11-12 December 2009). Në internet mund të gjendet në: [www.venice.coe.int](http://www.venice.coe.int), me këtë shenjë: CDL-AD (2010) 001 Study No. 469/2008, Starsbourg, 19 January 2010. Për aspektet teorike të kontrollit preventiv të amendamenteve kushtetuese, Cf. Kemal Gözler, *Judicial review of Constitutional Amendments. A Comparative Study* (EKIN PRESS: Bursa, 2008); Gary Jeffrey Jacobsohn, “An unconstitutional constitution? A comparative perspective”. *Int’l J Con Law*, Vol. 4 no. 3 (Jul 2006).

aktual kosovar që synon të mohojë vlerën dhe fuqinë juridiko-kushtetuese të vendimit të sipërcekur të Gjykatës Kushtetuese. Ky vendim, siç u tha, gabimisht cilësohet si “vendimi i Kushtetueses mbi Presidenten”, apo “vendimi që i dha presidentes Atifete Jahjaga mandatin e plotë pesëvjeçar”.<sup>17</sup> Në pjesën e fundit të shkrimit, do t'i bëjmë një analizë të plotë këtij diskursi të mbyllur dhe joprofesional deri në fund, kundrejt gjendjes aktuale të teorisë dhe të praktikës kushtetuese në vendet e përparuara të botës perëndimore. Tani mjafton të tregojmë, në vija të trasha, se cila është forma dhe përmbajtja e tij.

Vendimi në fjalë është vendim meritore dhe, për pasojë, ka formën e aktgjykimit. Si i tillë, ai paraqet përgjigjen meritorë të Gjykatës, në kuadër të juridiksionit të bazuar në nenin 113.9 dhe në nenin 114.3 të Kushtetutës. Ky juridiksion, në rastin konkret që shtjellohet këtu dhe që ka qenë objekt i Aktgjykimit, ka të bëjë me kontrollin kushtetues abstrakt dhe preventiv (paraprak) të 11 (njëmbëdhjetë) propozim-amendamenteve në Kushtetutën e Kosovës. Ato mbajnë autorësinë e një të katërtës (1/4) së deputetëve të Kuvendit, por në të njëjtën kohë reflektojnë synimin e sforcuar për autorësi të njëjtë të Komisionit për ndryshime kushtetuese.<sup>18</sup> Sipas nenit 144 (1) të Kushtetutës, siç u cek më herët, për propozim të amendamentimit kushtetues kërkohet së paku një e katërta (1/4) e numrit të deputetëve, së paku 30 sish. Komisioni kushtetues nuk paraqet palë të autorizuar kushtetuese për propozimin e amendamenteve në Kushtetutën e Kosovës.<sup>19</sup>

Aktgjykimi ka mbi dyzet faqe, me 276 paragrafë, pa llogaritur këtu pjesën e tij operative (dispozitivin). Ky i fundit ka pesë paragrafë përmbajtjesorë. Përkundër këtij vëllimi, në diskursin publik të sforcuar njëanshëm nga LDK-ja, si parti opozitare, dhe nga një pjesë e anëtarëve të Komisionit kushtetues, është goditur dhe është përfolur vetëm dispozita e paragrafit 255 të tij.<sup>20</sup>

17 “Zgjedhjet e parakohshme presidenciale varen nga Jahjaga”, gazeta e përditshme “Koha ditore”, 7 korrik 2012, e shtunë, fq. 1 dhe 3; “Jahjaga: Mirupafshim në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016”, gazeta e përditshme “Bota sot”, 7 korrik 2012, e shtunë, fq. 1 dhe 4-5; “Foli Kushtetuesja: Presidentja ka mandat pesëvjeçar”, gazeta e përditshme “Epoka e re”, 7 korrik 2012, e shtunë, fq. 1 dhe 4-5; “Presidente e plotë”, gazeta e përditshme “Express”, 7 korrik 2012, e shtunë, fq. 1 dhe 4-5; “Jahjaga edhe katër vjet presidente”, gazeta e përditshme “Zëri”, 7 korrik 2012, e shtunë, fq. 1-2.

18 Neni 144. 3 i Kushtetutës (Amendamentimi): “Ndryshimet në këtë Kushtetutë mund të miratohen nga Kuvendi vetëm pasi të ketë adresuar Kryetari i Kuvendit të Kosovës amendamentin e propozuar në Gjykatën Kushtetuese për ta vlerësuar paraprakisht nëse ndryshimi i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës”.

19 Neni 144.1 i Kushtetutës (Amendamentimi): “Qeveria, Presidenti ose një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit, sipas Rregullores së punës të Kuvendit, mund të propozojnë ndryshime dhe amendamente të kësaj Kushtetute”.

20 Paragrafi 255: “Në rastin e Presidentes aktuale të Republikës, kjo do të thotë që i gjithë populli i Kosovës pret që ajo të jetë Presidentja e tyre gjatë pesë (5) vjetëve të ardhme.



Gjykata vuri në pah, në këtë paragraf, se pritet e qytetarëve të Kosovës nuk janë ato që buronin nga marrëveshja politike me të cilën, *inter alia*, kërkoheshin zgjedhjet e parakohshme, por ato që buronin nga vendimi i Kuvendit për zgjedhjen e presidentes Jahjaga (për pesë vjetët e ardhshme). Gjykata i dha përparësi absolute pritjeve të qytetarëve që burojnë nga një vendim i një trupi kushtetues, Kuvendi i Kosovës, i cili zgjodhi znj. Atifete Jahjaga presidente të Kosovës.<sup>21</sup> Pritjet e tilla të qytetarëve të Kosovës janë transcendentë dhe mbijetojnë konjunkturën momentale politike, të cilat i ka pasur parasysh marrëveshja politike. Pritjet, të cilat i njeh Aktgjykimi, lidhen me rolin dhe me pozitën e presidentit të Kosovës si përfaqësues legjitim i vendit, brenda e jashtë, dhe si garantues i funksionimit demokratik të institucioneve kushtetuese të Kosovës. Kjo është fryma e letra e Kushtetutës. Kontestimi i fuqisë së Aktgjykimit, në këtë pjesë, u bë në mënyrë krejt të thjeshtëzuar, me fjalë e me argumente që aspak nuk kanë të bëjnë me teorinë dhe me praktikën kushtetuese të vendeve perëndimore, të atyre vendeve që Kosova dhe kushtetuta e saj i synojnë pa asnjë dyshim.

Paragrafët 247-271 të Aktgjykimit, që kanë të bëjnë me Presidentin e Republikës, sikundër dhe pjesët e tjera, kanë një arsyetim të gjatë e profesional. Aty shtjellohet roli, pozita dhe rëndësia e shefit të shtetit, si garantues dhe si personifikim i unitetit juridiko-kushtetues dhe shtetëror i tërë shoqërisë kosovare (e kuptuar si shtet sovran dhe i pavarur). Esenca e diskursit kontestues, krejtësisht politik, mëtonte t'i tregonte publikut kosovar se, ndër të tjera, "presidentja Atifete Jahjaga nuk përfaqëson popullin e Kosovës dhe, për pasojë, Gjykata nuk ka mundur ta dijë se kush është përfaqësues politik i popullit të Kosovës".<sup>22</sup> Përveç ndaj këtij paragrafi, në asnjë moment nuk ka

---

Kështu që, shkurtimi i mandatit të saj, siç propozohet me amendamentin dhjetë (10), e privon popullin e Kosovës nga përfaqësuesi i tyre legjitim dhe garantuesi në një kohë më të hershme se që besonin dhe shpresonin".

21 Më 2 tetor 2012, në emisionin "Rubikon" të KTV-së, shefi i LDK-së, z. Isa Mustafa, deklaroi se "të gjithë e kemi ditur kur kemi lidhur marrëveshjen politike se dispozitat e saj janë antikushtetuese, sepse mandati i Presidentit të Kosovës është pesë (5) vjet". Z. Mustafa tha se nuk sheh asgjë të keqe në Aktgjykimin e Gjykatës në këtë drejtim. Ajo që kontestoi z. Mustafa, në këtë paraqitje publike, kishte të bënte me faktin se "Gjykata duhet ta dijë se krejt Kosova e ka pasur të qartë se me marrëveshje politike ne jemi dakorduar që znj. Jahjaga të ketë mandat të përkohshëm dhe jo mandat pesëvjeçar", emisioni "Rubikon", me Adriatik Kelmendin, në programin televiziv të KTV-së (Koha Vizion), 2 tetor 2012 (ora 20:00).

22 Debati në fillim u nis me fjalët e thjeshta e pa asnjë përmbajtje, se "vendimi i Gjykatës nuk është profesional". Ky lloj "diskutimi" ka vazhduar me një intensitet mjaft të madh që nga dita e nxjerrjes së vendimit dhe akoma aty-këtu synon të mbahet "gjallë" nga Komisioni kushtetues. Në publik, dhe në qarqet akademike, nuk ka pasur asnjë debat në përkrahje të një qasjeje të tillë të thjeshtëzuar ndaj vendimit në fjalë. Ndonjë përkrahje aty-këtu ka qenë nga laikët dhe nga publicistika kosovare, pa asnjë vlerë shkencore. Cf. "Kryetari i Komisionit kushtetues, Arsim Bajrami, konteston vendimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me amendamentet për zgjedhjen e presidentit", gazeta e përditshme "Koha ditore", 7 korrik 2012, e shtunë, fq. 1 dhe

pasur kritikë ndaj pjesëve të tjera të Aktgjykimit. Gjykata nuk ka thënë, në asnjë paragraf, e aq më pak në paragrafin 255, se presidentja Jahjaga përfaqëson unitetin politik të popullit. Ky nuk është ndonjë zbulim, meqë dihet botërisht se zonja presidente Atifete Jahjaga asnjëherë nuk ka përfaqësuar ndonjë forcë politike. Edhe po të ishte se ajo përfaqëson një forcë të caktuar politike, nuk është punë e Gjykatës të merret me aspektet e përfaqësimit të unitetit sociologjik dhe politik të popullit nga shefi i shtetit. Kjo do të përbënte një absurd *par excellence* për sistemin presidencial të tipit të SHBA-së, ku shefi i shtetit ka forcë ekzekutive dhe përfaqëson maksimalisht mesataren e qytetarëve amerikanë, e lëre më për demokracinë kushtetuese parlamentare të tipit të Kosovës.

Debati Shmit – Kelsen koncentrohet pikërisht në atë se kush përfaqëson unitetin e popullit, qoftë ai sociologjiko-politik apo juridiko-kushtetues. Ky debat ka qenë i rëndësishëm në kohën ku është prodhuar, po qsa është sot, në Kosovë dhe kudo që mund të bëhet. Derisa Karl Shmit ka parë në shefin e shtetit personifikimin e unitetit sociologjiko-politik të popullit, Hans Kelsen dhe autorët e tjerë të proveniencës, e cila cilësohet si demokraci kushtetuese, nuk kanë pasur asnjë dyshim se nuk mund të ketë institucion të vetëm që të personifikojë një unitet të tillë sociologjiko-politik. Kjo vlen si për praktikën e diktaturave më të ashpra të tipit stalinist apo hitlerian, ashtu dhe për demokracitë më të përparuar me sistem kushtetues presidencial të tipit të SHBA-së.

Shtrohet pyetja tani: pse lindi ky diksurs kontestues ndaj vendimit në fjalë të Gjykatës, i mbyllur në dy-tre vetë, kaq politik e kaq brutal dhe pa fije argumenti profesional?

Sikundër që mund të jetë vërejtur nga shtjellimet e mësipërme, gjeneza e këtij diskursi të vetëmbyllur buron nga dinamikat e brendshme politike në Kosovë, të cilat u krijuan dhe u zhvilluan pas arritjes së marrëveshjes politike të datës 6 prill 2011, si dhe nga vetë kushtet e parapara aty. Mbi bazën e

---

3; “Kuvendi me Rezolutë antikushtetuese”, gazeta e përditshme “Koha ditore”, 8 korrik 2012, e diel, fq. 1 dhe 3; Riza Smaka, “Vendimi ka qenë korrekt”, gazeta e përditshme “Epoka e re”, 9 korrik 2012, e hënë, fq. 7; “LDK ndihet e tradhtuar nga Thaçi, AKR shpreson në vullnetin e presidentes”, gazeta e përditshme “Koha ditore”, 10 korrik 2012, e martë, fq. 2; “Kushtetuesja: I gjithë populli shpreson ta ketë Jahjagën 5 vjet në krye”, gazeta e përditshme “Koha ditore”, 21 korrik 2012, e shtunë, fq. 3; Halil Matoshi, “Popullizmi kushtetues dhe Zarifja”, gazeta e përditshme “Koha ditore”, 25 korrik 2012, e mërkurë, fq. 10; Sokol Bylykbashi, “Kushtetuesja politike”, gazeta e përditshme “Tribuna shqiptare”, 19 gusht 2012, e mërkurë, fq. 13; “Gjykata Kushtetuese dhe Komisioni për ndryshime kushtetuese përplasen për amendamentet që i referohen presidentit”, gazeta e përditshme “Koha ditore”, 29 gusht 2012, e mërkurë, fq. 1 dhe 3; “E godasin Gjykatën”, gazeta e përditshme “Express”, 29 gusht 2012, e mërkurë, fq. 6; “Kuvendi në hall me amendamentet jokushtetuese”, gazeta e përditshme “Koha ditore”, 11 gusht 2012, e shtunë, fq. 1 dhe 3.

atyre kushteve, nuk ka asnjë dyshim, u përpiluan 11 (njëmbëdhjetë) amendamentet e propozuara në Kushtetutën e Kosovës. Këto amendamente kanë qenë objekt i vlerësimit abstrakt dhe preventiv (paraprak) nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Se amendamentet e propozuara mishëronin frymën dhe germën e marrëveshjes politike, vërehet jo vetëm nga mënyra e formulimit të amendamentit, me të cilin synohej shkurtimi i mandatit pesëvjeçar të shefit aktual të shtetit kosovar,<sup>23</sup> por edhe nga formulimi i amendamentit tjetër, që synonte kufizime drastike dhe irracionale të kompetencave të ushtruesit të detyrës së Presidentit, në rastet kur kjo pozitë do të ushtrohej nga kryetari i Kuvendit. Edhe këto amendamente, Gjykata i vlerësoi me të drejtë si jokushtetuese, sepse zvogëlonin të drejtat dhe liritë e parapara me Kapitullin II të Kushtetutës.<sup>24</sup>

Në nenin 90.5 (2,3,6) të Kushtetutës, u propozua amendamenti 7 (shtatë), i cili thoshte se ushtruesi i detyrës së Presidentit duhet të jetë i kufizuar në ushtrimin e të gjitha kompetencave dhe të funksioneve të Presidentit, në veçanti ato që kanë të bëjnë me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, me emërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, si dhe me kompetencën për dhënien e faljeve individuale. Arsye e këtyre kufizimeve të çuditshme, të cilat fare nuk mund të futen në kornizën e teorisë edhe të praktikës së konstitucionalizmit perëndimor, duhet kërkuar, siç e thamë më lart, në dinamikat politike që i kanë pararendur arritjes së marrëveshjes politike. Hartuesit e këtij amendamenti i kanë pasur parasysh faktorët *ad hominem*, përkatësisht vlerësimin të cilin aktorët kryesorë politikë ia kanë bërë punës dhe sjelljes së ushtruesit (dy herë me radhë) të detyrës së presidentit të Kosovës, dr.

23 Ka pasur dy versione të amendamenteve të propozuara: versioni A dhe versioni B. Këtë cilësim të këtyre propozimeve e ka bërë vetë Gjykata, për qëllimet e lehtësimit të punës së saj. Për qëllimet e dhënies së drejtësisë kushtetuese, ndërkaq, këto dy propozime fare nuk kanë rëndësi. Kjo, nga shkakut se Aneksi A flet për “brenda gjashtë muajsh”, kurse versioni B për “pas gjashtë muajsh”, kohë kur amendamenti që shkurtonte mandatin e presidentes aktuale duhej të hynte në fuqi dhe, për pasojë, të organizoheshin zgjedhjet e reja. Versioni i parë përsërit ad litteram urdhrin politik të marrëveshjes së sipërcekur politike. Kjo marrëveshje parashikonte mbajtjen e zgjedhjeve “jo më vonë se gjashtë muaj nga dita e hyrjes në fuqi të ndryshimeve të nevojshme kushtetuese dhe ligjore”. Versioni B, po ashtu, përçonte një urdhrë politik të qartë, i cili ishte kristalizuar ndërkohë nga liderët politikë kosovarë, nënshkruar të marrëveshjes së sipërcekur politike. Tash, me këtë version, sikur tregohet një lloj “mëshire” për mandatin kushtetues (pesëvjeçar) të presidentes kosovare, sepse parashihte zgjedhjet e drejtpërdrejta pas “gjashtë muajsh” nga dita e hyrjes në fuqi të amendamenteve kushtetuese. Esenca e Aktgjykimit qëndron në atë se ai pastroi dilemat e atyre që besonin se mund të përdomin Gjykatën Kushtetuese të Kosovës për “konstitucionalizimin” e një marrëveshjeje politike të krijuar në mënyrë jashtëkushtetuese. Gjykata tha, për të qenë më i qartë, se presidentja aktuale nuk mund të shkarkohet nëpërmjet amendamenteve kushtetuese në asnjë kohë para mbushjes 4 (katër) vjet e 365 (treqindgjashtëdhjetëpesëdhjetë) ditë. Nuk ka rëndësi nëse fjala është “brenda” apo “pas gjashtë muajsh”.

24 Paragrafi operativ III (pikat 3 deri 5) të Aktgjykimit.

Jakup Krasniqi. Ky vlerësim i referohet kohës prej shtatorit të vitit 2010 e deri në prill të vitit 2011, kur z. Krasniqi pat ushtruar detyrën e presidentit të Kosovës. Në këtë kohë, ai pat refuzuar emërimin e një numri të caktuar të gjyqtarëve e të prokurorëve, pat dhënë një numër të madh të faljeve individuale, pat ndarë medalje, mirënjohje e çmime, të cilat qenë kritikuar publikisht mjaft ashpër nga segmente të caktuara të shoqërisë kosovare.<sup>25</sup> E, megjithatë, vlen të thuhet se këto kritika kanë qenë kryekëput politike, sepse nuk ka pasur një procedurë apo një vlerësim ligjor të kryer me kompetencë, ku do të kontestoheshin ligjshmëria apo kushtetutshmëria e punës dhe e sjelljes së ish-ushtruesit të detyrës së Presidentit të Kosovës për këtë periudhë. Gjykata Kushtetuese nuk ka guxuar t'i marrë për bazë argumentet *ad hominem* në procedurën e kontrollit abstrakt dhe preventiv (paraprak) të normës kushtetuese të përmbajtur në propozim-amendamentin 7 (shtatë). Në fakt, Gjykata nuk guxon ta bëjë një gjë të tillë në asnjë procedurë që zhvillohet para saj.

Cilësia themelore e kontrollit abstrakt të normës juridiko-kushtetuese konsiston në atë se aty bëhet vlerësimi i efektit të përgjithshëm dhe hipotetik të normës kundrejt çdo situatë apo rrethane në të cilën dikush mund të ndodhet në të ardhmen. Gjykata, pra, për dallim nga politika, abstrahon se kush ka qenë, kush është, apo kush mund të jetë ushtrues i detyrës së Presidentit të Republikës, dje, sot, dhe në të ardhmen. Ai sërish mund të jetë dr. Jakup Krasniqi. Kjo nuk ndryshon asgjë. Në rastet e kontrollit abstrakt dhe preventiv (paraprak) të normës kushtetuese, kjo bie më shumë në sy. Ky kontroll, siç u theksua, bëhet në raport me Kapitullin II të Kushtetutës, përkatësisht ka për qëllim vlerësimin nëse amendamenti i propozuar zvogëlon të drejtat dhe liritë nga Kapitulli II i Kushtetutës. Edhe Kapitulli II i Kushtetutës, i cili shërben si pikë themelore e referimit me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara, vlerësohet në mënyrë abstrakte. Kjo do të thotë se Gjykata ka vlerësuar *in abstracto* që çdo kufizim i sotshëm i kompetencave të ushtruesit të detyrës së Presidentit, siç është synuar nga hartuesit e propozim-amendamentit në fjalë, cenon çdo herë dhe ndaj çdokujt të drejtat dhe liritë nga Kapitulli II i Kushtetutës, dhe atë, për sa vijon:

---

25 Cf. Kuvendi i Republikës së Kosovës. Lajmet e fundit: Reagim i Kabinetit të Kryetarit të Kuvendit, 20 shkurt 2012, e hënë, ueb-faqja e Kuvendit të Kosovës: <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,128,4462> (shikuar më 24 nëntor 2012); "Eliminuan nga lista Driton Muharremin", gazeta e përditshme "Kosova sot", 27 janar 2012, e premte, version elektronik vetëm (<http://www.kosova-sot.info/politike/kosove/eliminuan-nga-lista-driton-muharremin>). Këtu, në këtë shkrim, analizohet raporti kritik i Misionit të OSBE-së në Kosovë, i cili flet për parregullsitë në emërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve të Kosovës nga u.d. i Presidentit, dr. Jakup Krasniqi).

- në rastin e gjendjes së jashtëzakonshme, potencialisht paralizon shtetin dhe krijon krizë kushtetuese, pra krijohet një ambient ku vihen në rrezik të drejtat dhe liritë e njeriut;<sup>26</sup>
- kur bëhet fjalë për emërimet e për shkarkimet e gjyqtarëve, një kufizim i tillë pengon administrimin e drejtësisë dhe, për pasojë, pakëson të drejtat e liritë e njeriut nga Kapitulli II i Kushtetutës në sensin që qytetarët dhe subjektet e tjera të së drejtës nuk kanë mundësi t'i realizojnë me rrugë gjyqësore të drejtat dhe liritë e tyre;<sup>27</sup>
- për sa i takon faljeve individuale, pengimi i ushtruesit të detyrës së Presidentit për të bërë shpalljen e faljeve individuale të atyre që janë të privuar nga liria, paraqet cenim absolut të të drejtave dhe të lirive njerëzore, sepse qytetarët që kanë të drejtë për një falje të tillë privohen nga ushtrimi dhe nga gëzimi i fryteve të faljes deri sa vendi të zgjedhë presidentin e ri.

Sikundër vërehet nga kjo paraqitje e përciptë, Gjykata nuk ka marrë parasysh asgjë tjetër, përveç analizimit *in abstracto* të normës kushtetuese të propozuar me amendament kundrejt Kapitullit II të Kushtetutës. Në këtë lloj të kontrollit kushtetues shpërfillen në tërësi ngjarjet dhe personat që ndërliken *in concreto* me ushtruesin e detyrës së Presidentit. Kush ka qenë, kush është dhe kush mund të jetë ushtrues detyre i Presidentit, si dhe kush mund të përfitojë, apo të dëmtohet, nga veprimet apo nga aktet e ushtruesit të detyrës së Presidentit, nuk çon peshë fare dhe nuk merret parasysh me rastin e ushtrimit të këtij lloji të juridiksionit kushtetues nga Gjykata. Po ashtu, fuqishëm duhet të vihet në dukje fakti se, me rastin e kontrollit abstrakt dhe preventiv (paraprak) të normës kushtetuese, Gjykata nuk guxon të marrë parasysh *travaux preparatoires* (punimet përgatitore), të cilat kanë çuar në hartimin e propozim-amendamenteve, të cilat janë objekt i kontrollit abstrakt dhe preventiv (paraprak) kushtetues. Si punime përgatitore, në rastin që diskutojmë këtu, kanë qenë bisedimet politike, kryesisht diskrete, ndërmjet liderëve politikë dhe të cilat kanë rezultuar me arritjen e marrëveshjes politike të datës 6 prill 2011. Nuk ka asnjë dyshim se, nga analiza e tekstit të amendamenteve të propozuara dhe nga krahasimi i tyre me tekstin e marrëveshjes, del që hartuesit e amendamenteve kanë synuar “të konstitucionalizojnë”, përkatësisht të kontrabandojnë, një vullnet momental politik të nënshkruesve të marrëveshjes dhe ta shkrijnë atë vullnet në tekstin e ri të Kushtetutës së Kosovës. Kjo formë e ushtrimit të pushtetit konstitutiv, pra e vullnetit të popullit si sovran, nuk ka mund të pranohet nga Gjykata, sepse është tërësisht në kundërshtim me parimet bazë të konstitucionalizmit modern. Në kuadrin e këtyre parimeve bazë, karta për të drejtat dhe për liritë

26 Cf. Paragrafët 158-161 të Aktgjykimit.

27 Cf. Paragrafët 162-167 të Aktgjykimit.

kushtetuese të subjekteve të së drejtës, Kapitulli II i Kushtetutës, paraqet një shtyllë tejet të rëndësishme, e cila mbështet dhe legjitimon ushtrimin e këtij vullneti konstitutiv të popullit, i kuptuar si sovran.<sup>28</sup> Do të ishte lëshim serioz dhe skandal profesional i llojit të vet, sikur Gjykata t'i kishte marrë parasysh *travaux preparatoires*, të cilat kanë rezultuar me arritjen e marrëveshjes politike, pra sikur të kishte "konstitucionalizuar" dispozitat e saj *post festum*. Kjo është kështu, në veçanti, nëse kihet parasysh se, në Kosovë, për dallim nga shumë vende të tjera, nuk ka dallim ndërmjet Kuvendit, si organ ligjvënës, dhe Kuvendit, si organ kushtetutëbërës<sup>29</sup>. Me një fjalë, amendamenti kryhet nga i njëjti kuvend, me dy të tretat e anëtarëve të tij. Në një situatë të tillë, kushtetutëbërësit origjinalë kosovarë kanë vendosur t'i japin Kapitullit II rolin e pikës së referimit për ta matur shkallën dhe formën e konstitucionalizmit kosovar në rastet kur dikush synon të bëjë ndryshimin e tekstit origjinal të Kushtetutës. Në kushtet e globalizimit aktual, me të drejtë është vërejtur në doktrinë se, e drejta ndërkombëtare, në veçanti pjesa e saj që ka të bëjë me të drejtat e njeriut, luan një rol të veçantë në vlerësimin kushtetues të amendamenteve kushtetuese.<sup>30</sup> Kjo është kështu, në veçanti në Evropë,

28 Në disa kushtetuta, ushtrimi i pushtetit konstitutiv ka një formë e procedurë krejt të strukturuar dhe është i ndarë nga procedura e amendamentimit të zakonshëm. Në disa raste kërkohet konvokimi i një asambleje të veçantë kushtetuese për këtë qëllim (Bullgaria), në disa të tjera kërkohet që të bëhet propozim-amendamenti dhe të shpërndahet organi përfaqësues e të krijohet një tjetër, i cili pas leximit tjetër vendos për miratimin ose jo të tyre (vendet skandinave), duke i lënë hapësirë të mjaftueshme debatit publik për amendamentet e propozuara. Përveç këtyre, në praktikë, ka raste kur parashikohen intervale të gjata kohore ndërmjet propozimit të amendamenteve dhe miratimit të tyre në organin përfaqësues (Estonia, Lituania, Mali i Zi, etj.). Cf. Report on Constitutional Amendment, Adopted by the Venice Commission at Its Plenary Session (Venice, 11-12 December 2009); për aspektet teorike të të gjitha modaliteteve të amendamentimit kushtetues, Cf. Carlo Fusaro, "Changing Constitutions", në Dawn Oliver and Carlo Fusaro (eds), *How Constitutions Change. A Comparative Study* (HART PUBLISHING LTD: Oxford and Portland, 2011) fq. 3-6; Dawn Oliver and Carlo Fusaro, "Changing Constitutions: Comparative Analysis". Në Dawn Oliver and Carlo Fusaro (eds), *How Constitutions Change. A Comparative Study*, fq. 381-403; Carlo Fusaro and Dawn Oliver, "Towards a Theory of Constitutional Change". Në Dawn Oliver and Carlo Fusaro (eds), *How Constitutions Change. A Comparative Study*, fq. 404-433.

29 Izraeli është një tjetër vend ku nuk bëhet dallimi në mes të asamblesë konstitutive dhe asaj legjislative. Megjithatë, ekziston një dallim në mes të Kosovës dhe Izraelit në sensin që në Izrael Kneset-i (parlamenti izraelit) e ka të njohur nga tjerët rolin e kujdestarit të vullnetit origjinal të popullit hebre, në vecanti kur është fjala për ruajtjen e demokracisë hebreje. Edhe atje, sidoqoftë, Kneset-i ka fuqi të kufizuar për sa i përket ushtrimit të pushtetit konstitutiv në emër të krejt hebrejëve dhe ndryshimit të vetë natyrës së demokracisë hebreje. Cf. më shumë për këtë tek: Ahron Barak, "Unconstitutional Constitutional Amendments". Në ISRAEL LAË REVIEË Vol. 44 No. 3 (2012); Sharon Èeintal, "The Challenge of Reconciling Constitutional Eternity Clauses Ëith Popular Sovereignty: Toëard Three-Track Democracy in Israel as a Universal Holisitit Constitutional System and Theory". Në ISRAEL LAË REVIEË Vol. 44 No. 3 (2012).

30 Cf. Lech Garlicki and Zofia A. Garlicki, "External Review of Constitutional Amend-

pjesë e së cilës është Kosova, e cila, në nenin 53 të Kushtetutës së saj, pra brenda Kapitullit II, i jep fuqi dhe vend të veçantë Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.<sup>31</sup>

Amendamentet kushtetuese, derisa nuk janë votuar, i nënshtrohen kontrollit kushtetues për të parë nëse bien ndesh me tekstin origjinal të Kushtetutës. Në momentin e miratimit të tyre, ato bëhen pjesë e barabartë me pjesët origjinale (fillestare) të tekstit kushtetues. Për këtë arsye, në teorinë dhe në praktikën kushtetuese parashihen kufizime të theksuara procedurale dhe materiale (substanciale) në ushtrimin e fuqisë (pushtetit) konstitutive (krijuese) të popullit, i kuptuar si sovran. Amendamentimi paraqet një ndër këto fuqi (pushtete) krijuese. Kjo çështje sërisht trajtohet në fund të këtij shkrimi. Këtu mjafton të thuhet se Gjykata, me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së amendamentit 10 (dhjetë), deri në fund ka pasur parasysh kriteret profesionale të drejtësisë kushtetuese dhe të konstitucionalizmit modern perëndimor. E njëjta vlen edhe për propozim-amendamentin 7 (shtatë). Kjo do të thotë se Gjykata, në asnjë rast, nuk ka çarë kokën për kriteret dhe për kushtet e parapara në tekstin e marrëveshjes politike. Në paragrafët 247-271 të Aktgjykimit, në mënyrë shumë abstrakte flitet për çdo situatë apo për çdo gjendje në të cilën mund të gjendet secili person në cilësinë e Presidentit të Kosovës, sot dhe në të ardhmen, përkatësisht se ai/ajo mund të mënjanohet nga detyra vetëm nëpërmjet mënyrës së paraparë kushtetuese. Gjykata ka treguar, njësoj sikur Gjykata Supreme e Indisë, se “e drejta për amendamentim nuk nënkupton të drejtën për rrënim”.<sup>32</sup> Ky është standardi matës i çdo demokracie kushtetuese. Çdo rrugë tjetër, si kjo që synohej nëpërmjet amendamentit 10 (dhjetë) (neni i ri i propozuar ka qenë neni 162.1), cenon vetë esencën, rolin dhe pozitën e shefit të shtetit në një republikë demokratike parlamentare, pra të një institucioni që personifikon unitetin juridiko-kushtetues të popullit dhe garantuesin e funksionimit demokratik të institucioneve kushtetuese shtetërore.<sup>33</sup> E, shikuar nga këndvështrimi i Kapitullit II,

---

ments? International Law as a Norm of Reference”. Në *Israel Law Review*, Vol. 44, No. 3 (2012).

31 Neni 53 (“Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut”): “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara më këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

32 *Minerva Mills Ltd. V. Union of India* (A.I.R. 1980, S.C. 1789) fq. 1798. Për komentet e këtij pozicioni, Cf. Gary Jeffrey Jacobson, “An unconstitutional constitution. A comparative perspective?” *Intl'l J Const Law*, Vol. 4, No 3 (Jul 2006) fq. 472-476; Lech Garlicki and Zofia A. Gralicka, “Review of Constitutionality of Constitutional Amendments (An Imperfect Response to Imperfections)”. Në *Jornal of Constitutional Law/Revue De Droit Constitutionnel*, Vo. I, Issue 1 (Istanbul, Turkey: Year 2012) fq. 216-219; Dr. J. N. Pandey, *The Constitutional Law of India*. 47th Edition (CLA: ALLAHABAD, India, 2010) fq. 366-367; 420-421; 770-772.

33 Paragrafi 259 i Aktgjykimit: “Pasi të zgjidhet, Presidenti mban mandatin deri në pesë vjet. Presidentja aktuale mban mandatin në mënyrë legjitime dhe është, në bazë të zgjedhjes

sërisht *in abstracto*, pra pa marrë parasysh se kush është dhe pse është sot shef i shtetit kosovar, kjo mënyrë e synuar për mënjanimin e kreut të shtetit cenon të drejtat zgjedhore (aktive dhe pasive),<sup>34</sup> ndarjen e pushteteve,<sup>35</sup> të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave,<sup>36</sup> barazinë para ligjit,<sup>37</sup> e kështu me radhë. Gjykata, në asnjë rast, nuk ka marrë parasysh kriteret jokushtetuese, njësoj siç është vepruar edhe me rastin e ish-presidentit kosovar, z. Fatmir Sejdiu.<sup>38</sup>

## II. “*Il regne et ne gouverne pas*”

Drejtësia kushtetuese, në kuptimin e gjerë të fjalës, nuk kryhet vetëm nëpërmjet mekanizmit të gjykatës kushtetuese, por edhe me ndihmën e punës së përditshme të institucioneve të tjera kushtetuese. Në kuptimin e ngushtë, ndërkaq, ajo identifikohet me punën e me veprimtarinë profesionale të gjykatës kushtetuese, e cila ka monopolin e mbrojtjes dhe të interpretimit të kushtetutës.<sup>39</sup> Se cili segment i drejtësisë kushtetuese do të dalë në syprinë,

---

së saj Presidente, garantuese e funksionimit demokratik të institucioneve në shtet. Mandati i Presidentit të Kosovës është përzierje e legjitimitetit të zgjedhjes së tij/saj, kohëzgjatjes së mandatit (pesë vjet) dhe kompetencave që i jepen Presidentit me Kushtetutë, jo vetëm kompetencat e dhëna sipas nenit 84 (Kompetencat e Presidentit)”.

34 Paragrafët 260-261.

35 Paragrafët 267-268.

36 Paragrafët 262-264.

37 Paragrafi 265.

38 Presidenti i Kosovës, z. Fatmir Sejdiu, pat dhënë dorëheqje më 27 shtator 2010. Që atëherë, ai ka folur publikisht për ekzistimin e një marrëveshjeje politike ndërmjet tij dhe faktorëve ndërkombëtarë në mbështetje të “ngjirjes” së pozitës së tij si kryetar i partisë. Ai ka pohuar se, përveç kësaj, kjo marrëveshje e pohuar ka shërbyer si bazë për travaux preparatoires, pra si shtyllë për draftimin dhe formën aktuale të nenit 84 të Kushtetutës. Cf. Enver Robelli, “Doli prej zarfit, tash nuk del prej zyrës!”, gazeta e përditshme “Koha ditore”, 10 korrik 2012, e martë, fq. 10. Në këtë artikull, autori përmend bindjen e fortë të ish-presidentit Fatmir Sejdiu për ekzistimin e marrëveshjes së lartcekur “gojore” ndërmjet tij dhe faktorëve kryesorë ndërkombëtarë.

39 Në teori nganjëherë bëhet dallim ndërmjet mbrojtjes dhe interpretimit të kushtetutës. Cf. Luis Lopez Guerra, “The Role and Competences of the Constitutional Court”. Në The European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), The role of the constitutional court in the consolidation of the rule of law. UniDem Seminar, Bucharest on 8-10 June 1994 (Council of Europe Press: Strasbourg, 1994) fq. 20-23.

Edhe Kushtetuta e Kosovës e bën dallimin ndërmjet mbrojtjes dhe interpretimit të kushtetutës. Për mbrojtjen flitet në kontekstin e formës së regjimit kosovar, kurse për interpretimin në kuadër të dispozitave për Gjykatën Kushtetuese dhe për juridiksionin primar të saj. Kështu, në nenin 4. 6 (Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit) thuhet: “Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës”, kurse në nenin 112.1 (Gjykata Kushtetuese – Parimet e Përgjithshme): “Gjykata



varet nga një sërë faktorësh, siç janë kultura kushtetuese e politike, por edhe nga rrethanat e tjera objektive socio-ekonomike e politike. Ajo që njihet si konstitucionalizëm, ideologji kjo moderne e kushtetutës, në esencë i referohet konceptit të gjerë të drejtësisë kushtetuese dhe është cilësi themelore e demokracive kushtetuese me traditë të gjatë e stabile.<sup>40</sup> Edhe vendet e tjera, kryesisht vendet në transicion, ku hyn Kosova dhe vendet e tjera ish-komuniste, synojnë këtë identifikim të drejtësisë kushtetuese në kuptim të gjerë, me tërë gamën e gjerë të infrastrukturës institucionale e formalo-juridike, e cila mbështet punën e gjykatës kushtetuese si institucion i specializuar për dhënien e drejtësisë kushtetuese në kuptim të ngushtë.

Një identifikim i tillë gjithëpërfshirës nuk ka qenë gjithherë i mundur: vendet ish-komuniste, përfshirë Kosovën, është dashur të mbështeten për një kohë të gjatë ekskluzivisht në gardianin dhe interpretuesin e vetëm të kushtetutës – në gjykatën kushtetuese. Infrastruktura tjetër dhe strukturat e tjera kushtetuese e shtetërore kosovare, njëjtë si në ish-botën komuniste, mbeten mjaft të dobëta për t'u mbështetur kryesisht vetëm në to.<sup>41</sup>

Drejtësia kushtetuese kosovare, e kuptuar kësajsoj, jo vetëm që e ndikon pu-

---

Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën".

40 Cf. Carlo Fusaro and Dawn Oliver, "Changing Constitutions". Në Dawn Oliver and Carlo Fusaro (eds), *How Constitutions Changes. A Comparative Study*, fq.3-5; Dawn Oliver and Carlo Fusaro, "Changing Constitutions: Comparative Analysis". Në *How Constitutions Changes. A Comparative Study*, fq. 381-403; Carlo Fusaro and Dawn Oliver, "Towards a Theory of Constitutional Change". Në *How Constitutions Changes. A Comparative Study*, fq. 405-433.

41 Për një analizë të shkëlqyer të përvojave të të gjitha vendeve ish-komuniste, si dhe për rolin dhe për pozitën e gjykatave kushtetuese gjatë transicionit, përfshirë këtu krashimin e tyre me vendet e përparuara perëndimore, shih më shumë në: Herman Schwartz, *The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe* (The University of Chicago Press: Chicago, 2000) fq. 1-21 dhe 226-248; Levent Gonenc, *Prospects for Constitutionalism in Post-Communist Countries* (Kluwer Law International: The Hague, 2002), në veçanti kapitulli 1 ("Conceptual Framework") dhe kapitulli 3 ("Constitution-Making"), fq. 3-25 dhe 103-208; Jean – Pierre Massias, *Droit constitutionnel des Etats d'Europe de l' Est* (2e edition) (Presses Universitaire de France: Paris, 2008), fq. 13-63.

Ka pasur autorë, megjithatë, të cilët kanë qenë kundër kësaj mbështetje ekskluzivisht vetëm në gjykatën kushtetuese. Sipas tyre, një mbështetje e tillë ekskluzivisht në gjykatën kushtetuese i paralizon organet tjera, i delegjtimon dhe i defaktorizon të njëjtat dhe e rëndon dukshëm punën e funksionimit të tërë sistemit kushtetues. Cf. Wojciech Sadurski, "Postcommunist Constitutional Courts in Search of Political Legitimacy". Në *WORKING PAPER OF THE LAW DEPARTMENT OF THE EUROPEAN UNIVERSITY INSTITUTE* (Series/Report No. 11/2001, EUI LAW); Wojciech Sadurski, "Constitutional Review After Communism: Legitimacy and Reasons". Në Wojciech Sadurski (ed), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe I a Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2012).

nën aktuale të Kushtetutës, si një kuadër për qeverisje dhe si një kartë e të drejtave e lirive njerëzore, por edhe e inspiron atë. Nga kjo prizëm vërehet qartë ndërveprimi ndërmjet drejtësisë kushtetuese dhe kontekstit institucional, kulturor e politik në të cilin vihet në jetë drejtësia kushtetuese. Drejtësia kushtetuese kosovare, njëjtë si ajo e vendeve ish-komuniste gjatë tranzicionit, pa dyshim se është konceptuar si një garantuese e demokracisë kushtetuese, e vlerave, e parimeve dhe e normave të saj. Njohja dhe pranimi i epërsisë së qartë të demokracisë kushtetuese, karshi formave të tjera, paraqet një *condictio sine qua non* të drejtësisë kushtetuese. Kjo demokraci legjitimohet dhe arsyetohet vetëm nëpërmjet termave e koncepteve të asaj që njihet si ideologji e konstitucionalizmit modern perëndimor (antimazhoranca, balansi dhe ndarja e pushteteve, të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit dhe të ngjashme). Vetëm në këtë kuadër të gjerë konceptual mund të kuptohet dhe të shpjegohet drejtësia kushtetuese, si një prej teknikave specifike për dhënie të drejtësisë. Misioni i saj primar konsiston në ngritjen e sundimit të ligjit në një shkallë më të lartë, si dhe në përsosjen dhe në zhvillimin permanent të pikëpamjeve e të praktikave të shekullit XIX për sundimin e ligjit dhe pajtimin e tyre me konstitucionalizmin modern perëndimor. Në këtë drejtim, Kosova nuk dallon aspak nga vendet ish-komuniste: Kushtetuta e Kosovës, dispozitat dhe fryma e saj, në tërësi modelohet sipas mësimave e përvojave të vendeve më të përparuara të botës perëndimore.

Në kohën pas rrënimit të monarkive absolute, të shkaktuara nga Revolucioni Borgjez Francez i vitit 1789, e deri me sot, konstitucionalizmi dhe drejtësia kushtetuese, si komponentë e tij, kanë konsistuar në menaxhimin nëpërmjet rrugëve institucionale e formalo-kushtetuese të formave të ushtrimit të vullnetit të pakontrolluar të popullit, si sovran i ri në skenën politike evropiane të kohës. Dihet mirëfilli se i tërë shekulli XIX ka qenë në shenjë të kontrollit institucional dhe kushtetues të monarkive evropiane dhe synimit për të garantuar stabilitetin e tyre institucional e politik. Teoria për të ashtuquajturat kushtetuta të ngurta, i ka shërbyer këtyre qëllimeve e synimeve për stabilitet institucional e politik. Për t'i shërbyer qëllimeve e synimeve të tilla, ajo u formulua sa pari nga *Lord Bryce*.<sup>42</sup> Si praktikë, megjithatë, ajo është më e hershme dhe daton që nga shekulli XVIII. Koncepti për kushtetutat rigjide nuk është vetëm një çështje *ex cathedra* e diskurseve demagogjike dhe shterpe. Ky koncept nuk është vetëm punë procedure në sensin e ekzistimit të disa pengesave, të cilat pamundësojnë ndryshimin e lehtë dhe të shpejtë të tekstit kushtetues. Disiplina e njohur si amendamentimi kushtetues, sado e një rëndësie tepër të madhe, megjithatë nuk mund ta zbulojë tërë thelbin e ndodhive dhe mënyrën e formimit të sistemit politik fillestar sipas kushtetutës në fuqi, e cila cilësohet si rigjide. Për të kuptuar thelbin e këtyre ndodhive dhe thelbin e mënyrës së

42 James Bryce, *Studies in History and Jurisprudence*. (The Clarendon Press: Oxford, 1901), në veçanti "Essay III: Flexible and Rigid Constitutions", fq. 145-254.

formimit të sistemit politik origjinal (fillestar) në të kaluarën, asnjëherë nuk duhet harruar vlerat substanciale (materiale), pra jo vlerat procedurale, të cilat garantojnë rigjeditetin e kushtetutës së caktuar. Kjo vlen për Kosovën, po aq sa vlen edhe për pjesën dërrmuese të demokracive kushtetuese bashkëkohore. Këto vlera substanciale gjenden nëpër dispozitat materiale kushtetuese dhe njihen, siç u pa më herët, me lloj-lloj emrash e shprehjesh. Këto vlera nuk është e thënë të gjenden shprehimisht nëpër tekstin kushtetues ekzistues. Ka raste kur ato janë krijuar nga praktika e gjatë e ushtrimit të drejtësisë kushtetuese.<sup>43</sup> Në hulumtimet shkencore të këtij lëmi, ka rezultuar se vetë epërsia e kushtetutës, kundrejt çdo norme tjetër, nënkupton ekzistimin e kontrollit gjyqësor, sikundër që vetë të qenurit rigjid të një kushtetute fuqizon tej mase kontrollin kushtetues. Pra, ka një korrelacion pozitiv ndërmjet ekzistimit të një teksti të shkruar kushtetues dhe rigjeditetit të saj të theksuar dhe të një kontrolli të fuqishëm gjyqësor të kushtetutshmërisë.<sup>44</sup>

Në tekstet kushtetuese, apo të krijuara nga praktika e gjyqeve kushtetuese, esenca e vlerave substanciale si më sipër konsiston në atë se vetëm nëpërmjet analizës dhe studimit të tyre mund të kuptohet përfundimisht historiku dhe zhvillimi i sistemit politik origjinal (fillestar), i ndërtuar sipas procedurave të kushtetutës rigjide. Këto dispozita kushtetuese materiale, të cilat ngërthenjë këto vlera dhe parime të (pa) ndryshueshme, paraqesin një lloj “kodi gjenetik” të secilës kushtetute.<sup>45</sup> Kosova, në këtë drejtim, nuk bën përjashtim: Kapitulli II i Kushtetutës për të drejtat dhe liritë e njeriut është “kodi gjenetik” i saj, vija e kuqe, ndryshimi eventual i të cilit do ta shkatërronte formën dhe përmbajtjen e sistemit aktual politik kosovar, të formësuar këtyre viteve mbi bazën e tekstit (rigjid) origjinal (fillestar) kushtetues, të datës 15 qershor 2008.<sup>46</sup> Kjo do të thotë se amendamenti i Kushtetutës së Kosovës

43 Të tilla janë rastet e Indisë, të Gjermanisë, të Kanadasë, etj. Cf. Dr. sc. Jasna Omejec, “Kontrola ustavnosti ustavnih normi (ustavnih amandmanai ustavnih zakona)”. (Control of Constitutionality of Constitutional Norms (Constitutional Amendments and Constitutional Laws)). Godišnjak Akademije pravni znanosti Hrvatske, Vol. 1, No. 1, Prosinac 2010, fq. 1-28.

44 Arend Lijphart, *Patterns of Democracy. Government forms and Performance in Thirty-Six Countries* (Yale University Press: New Haven and London, 1999) fq. 217-230.

45 Kjo shprehje për herë të parë është përdorur nga Carlo Fusaro dhe Dawn Oliver në “Towards a Theory of Constitutional Change”, fq. 428.

46 Kosova ka shpallur Deklaratën e Pavarësisë më 17 shkurt 2008. Më pas, Kuvendi i Kosovës, bazuar në këtë deklaratë, më 9 prill 2008 ka miratuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi më 15 qershor të të njëjtit vit. Këto akte janë ndërmarrë nga përfaqësuesit e popullit të Kosovës, jo nga strukturat e pushtetit të krijuara në Kosovë pas qershorit të vitit 1999, mbi bazën e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të datës 10 qershor 1999.

Nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND), kjo shpallje është vlerësuar si akt i ushtrimit të pushtetit konstitutiv (“pouvoir constiuant”), jo atij legjislativ (“pouvoir constitue”), i cili

has në vështirësi, të cilat nuk lidhen vetëm me procedurën e vështirë për amendamentimin e saj<sup>47</sup>, por, mbi të gjitha dhe kryesisht, me vështirësitë që i referohen parimeve dhe vlerave substanciale kushtetuese të Kapitullit II të Kushtetutës dhe të dispozitave të tjera materiale.<sup>48</sup>

T'i kthehemi sërish çështjes së origjinës së praktikës së implementimit të

---

ka funksionuar në Kosovë mbi bazën e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të datës 10 qershor 1999. Cf. Paragrafët 102-109, 118 dhe 121 të Vendimit Konsultativ të GJND-së, të datës 22 korrik 2008. International Court of Justice (ICJ). Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in respect of Kosovo. Advisory Opinion. 22 July 2010.

Për komentet e këtij vendimi, në literaturë, Cf. James Summers (ed.), *Kosovo: A Precedent? The Declaration of Independence, the Advisory Opinion and Implications for Statehood, Self-Determination and Minority Rights* (Martinus Nijhoff Publishers: The Hague, 2011); Michael Bothe, "Kosovo – So What? The Holding of the International Court of Justice Is Not the Last Word on Kosovo's Independence". *German Law Journal*, Vol. 11, No. (2010); Robert Howse & Ruti Teitel, "Delphic Dictum: How Has the ICJ Contributed to the Global Rule of Law by its Ruling on Kosovo?" *German Law Journal*, Vol. 11, No. 08 (2010); Björn Arp, "The ICJ Advisory Opinion on the Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo and the International Protection of Minorities". *German Law Journal*, Vol. 11, No. 08 (2010); Robert Muharremi, "A Note on the ICJ Advisory Opinion on Kosovo". *German Law Journal*, Vol. 11, No. 08 (2010); Thomas Burri, "The Kosovo Opinion and Secession: The Sounds of Silence and Missing Links". *German Law Journal*, Vol. 11, No. 08 (2010); James E. Moliterno, "What the ICJ's Decision Means for Kosovars". *German Law Journal*, Vol. 11, No. 08 (2010); Elena Cirkovic, "An Analysis of the ICJ Advisory Opinion on Kosovo's Unilateral Declaration of Independence". *German Law Journal*, Vol. 11, No. 08 (2010); Hanna Jamar & Mary Katherine Vigness, "Applying Kosovo: Looking to Russia, China, Spain and Beyond After the International Court of Justice Opinion on Unilateral Declarations of Independence". *German Law Journal*, Vol. 11, No. 08 (2010); Toma Galli, "Kratka analiza Savjetodavnog misljenja Medjunarodnog suda o proglasenju neovisnosti Kosova s medunarodnim pravom". *Zbornik Pravnog Fakulteta u Zagrebu*, Vol. 61, No. 6 (prosinac 2011).

47 Neni 144, paragrafi 2 (Amendamenti): "Çdo ndryshim do të kërkojë miratimin e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës".

48 Në Aktgjykimin për Presidenten, siç po quhet në praktikë, Gjykata ka bërë me dije shumë qartë se Kapitulli II i Kushtetutës nuk mund të shikohet në mënyrë të izoluar nga Kapitulli III në vijim, i cili mbron të drejtat dhe liritë e bashkësive joshumicë në Kosovë. Për më tepër, Gjykata ka vënë në dukje se nuk janë vetëm këta dy kapituj që merren parasysh nga ajo me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese, por edhe parimet e vlerat e tjera të sanksionuara me Kushtetutë. Cf. Paragrafët 61-68 të Aktgjykimit.

Kjo qasje e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës është në vijë të njëjtë me teorinë dhe me praktikën e Gjykatës Gjermane, e cila e sheh Ligjin Themelor të RF të Gjermanisë si një tërësi organike, një unitet strukturor të vlerave dhe të parimeve kushtetuese. Për komentet, Cf. Donald P. Kommers, "German Constitutionalism: A Prolegomenon". *Emory Law Journal*, Vol. 40, Issue 1 (Summer, 1991); Donald P. Kommers, *The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany*. Second Edition (Duke University Press: Durham and London, 1997) fq. 3-60.

kushtetutave rigjide, si dhe vetë arsyeve për një praktikë të tillë, rolit dhe rëndësisë së drejtësisë kushtetuese në kuptim të gjerë, si dhe lindjes së drejtësisë kushtetuese në kuptim të ngushtë.

Siç e thamë më parë, praktika e kushtetutës rigjide u nis në fund të shekullit XVIII. Pas revolucioneve të mëdha të fundit të atij shekulli, në dy anët e Atlantikut, lindi një pikëpamje e re për konstitucionalizmin. Demokracia radikale ose absolute, si një prodhim i dogmës revolucionare të revolucioneve amerikane (1776) dhe franceze (1789), u zëvendësua nga demokracia kushtetuese: koncepti i një kushtetute rigjide, e cila mund të ndryshohej me një vështirësi të jashtëzakonshme, u fut në përdorim nga njerëzit e mençur të kohës. Ndërkohë që miratimi i dy teksteve kushtetuese në dy anët e Atlantikut u bë nëpërmjet shumicës së thjeshtë në konventën kushtetuese (SHBA), përkatësisht në asamblenë kushtetuese (Franca), ndryshimit të tyre në të ardhmen iu vunë pengesa të paimagjinueshme deri atëherë. Kjo rezultoi në atë që literatura me të drejtë e quajti “paradoksi i konstitucionalizmit”, në sensin që shumica e thjeshtë e një brezi ia lidh duart shumicës absolute të së ardhmes.<sup>49</sup> Për herë të parë u bë zgjedhja ndërmjet demokracisë radikale dhe asaj kushtetuese. Nga kjo kohë e tutje, asnjë kushtetutë nuk mund t’i shmangej këtij opsioni. Vlerat kushtetuese, të cilat një brez i sanksionoi më një shumicë të thjeshtë, bëhen transcendentë në kuptim të mbijetimit të brezave. Ky mbijetim bëhet nëpërmjet futjes nga “brezi i shumicës së thjeshtë” të dispozitave për “shumicën e kualifikuar në mënyrë specifike”, me të vetmin qëllim: pengimin e ndryshimeve kushtetuese që cenojnë (prekin) vlera sublime transcendentë të krijuara nga “brezi i parë i shumicës së thjeshtë”.<sup>50</sup> Në thelb, kjo qasje ka mbetur cilësia dalluese e demokracisë kushtetuese, e demokracisë

49 Për analizë të gjatë e të detajuar të këtij paradoksi dhe për praktikatat moderne në përgjigje të këtij paradoksi, Cf. Martin Loughlin and Neil Walker (eds.), *The Paradox of Constitutionalism: Constituent Power and Constitutional Form* (Oxford University Press: Oxford, 2007).

Kjo temë ka nxitur kureshtjen edhe të filozofëve dhe të studiuesve nga lëmenjtë e tjerë. Për elaborimet dhe për arsyetimet teorike-filozofike të këtij paradoksi, Cf. debatet ndërmjet filozofëve dhe studiuesve në Norman Dorsen, Michel Rosenfeld, Andras Sajo dhe Susanne Baer (eds.), *Comparative Constitutionalism. Cases and Materials* (West Group: USA, 2003) fq. 66-98.

50 Cf. Andras Sajo, *Limiting Government. An Introduction to Constitutionalism* (CEU Press: Budapest, 1999) fq. 17-24 dhe 136-40. Për kritikë të ashpër të këtij koncepti të konstitucionalizmit modern nga K. Shmit, Cf. Carl Schmitt, *Legality and Legitimacy* (Duke University Press: Durham and London, 2004) fq. 39-58. Në këtë shtjellim të gjatë, K. Shmit e quan kapitullin e dytë të Kushtetutës së Vajmarit, e cila sanksiononte të drejtat e njeriut dhe ndryshimin e tyre me shumicë të kualifikuar, si “një kushtetutë të dytë brenda kushtetutës ekzistuese vajmariane”. Ai, në fakt, kapitullin vajmarijan që përmbante dispozitat materiale për të drejtat e njeriut, e cilësonte si një antikushtetutë, sepse shumica e kualifikuar e dy të tretave kërkohej për ndryshimin e tyre. Sipas tij, kjo shumicë e kualifikuar kësisoj, në esencë paraqiste mohim të parimit themelor të demokracisë, e kuptuar sipas tij si sundim i shumicës.

jordikale dhe jopopuliste, në të cilën procedurat përkatëse sanksionojnë një përmbajtje liberale që respekton dinjitetin, të drejtat dhe liritë e secilit, pa marrë parasysh numrin dhe karakteristikat e tjera të subjektit të së drejtës.<sup>51</sup> Demokracia kushtetuese mbron shoqërinë nga ajo që John Stjuart Mill e ka cilësuar si “tiranja e shumicës”, përkatësisht nga rreziqet e “sundimit demokratik” (Ronald Dworkin).<sup>52</sup>

Demokracia radikale/populiste, ndërkaq, është ajo formë e sistemit politik ku sovraniteti qëndron në popull, i cili supozohet se flet dhe vepron nëpërmjet një asambleje të gjithëpushtetshme. Ekzekutivi dhe organet e tjera politike sillen si satelitë të këtij trupi përfaqësues. Ky trup ka monopol për tërë aktivitetin vendimmarrës. Këto praktika radikale, siç na mëson historia, kanë degjeneruar në forma kaotike të *gouvernement d' assemblée* (rasti i Francës, pas vitit 1789),<sup>53</sup> apo në hegjemoninë e një force politike, e cila ka sunduar prapa perdeve të skenës parlamentare. Rasti i dytë ishte karakteristikë e vendeve diktatoriale dhe jodemokratike, ku është ruajtur forma “parlamentare” e qeverisjes sa për sy e faqe. Çdo gjë ka filluar me Leninin dhe me doktrinën e tij për “parlamentin, si një trup punues”<sup>54</sup>. Më vonë, degjenerimet e tilla kanë qenë gati rutinë në shumicën e vendeve nga e ashtuquajtura Bota e Tretë (Amerika Latine, Azia Juglindore dhe Lindja e Mesme) gjatë kohës së Luftës së Ftohtë.<sup>55</sup>

---

51 Për demokracisë liberale, të kuptuar si procedurë që ngërthen dhe garanton vlerat substanciale njerëzore, Cf. F. A. Hayek, *The Constitution of Liberty. The Definitive Edition* (The University of Chicago Press: Chicago, 1960, 2011).

52 Jeffrie G. Murphy, “Rationality and Constraints on Democratic Rule”, in J. Ronald Pennock and John W. Chapman (eds.), *Justification. Nomos XXVIII* (New York University Press: New York, 1986) fq. 141-143.

53 M. Perry, M. Chase, J. R. Jacob, M. C. Jacob and Th. H. von Laue (eds.), *Western Civilisation: Ideas, Politics, and Society. 10th Edition* (Wadsworth, Cengage Learning, 2013, 2009) kapitulli 19 (“The French Revolution: the Affirmation of Liberty and Equality”); Louis Favoreu, *Droit constitutionnel. 12e edition* (Daloz: Paris, 2009) fq. 8-12; Lucien Jaume, “Constituent Power in France”. Në Martin Loughlin and Neil Walker (eds.), *The Paradox of Constitutionalism: Constituent Power and Constitutional Form*, fq. 67-85; R. C. van Caenegem, *An Historical Introduction to Western Constitutional Law* (Cambridge University Press: Cambridge, 1995) fq. 174-193.

54 V. I. Lenin, *The State and Revolution* (Penguin Books: London, 1992) fq. 42. Për komente dhe shtjellime teorike të evolimit të idesë dhe praktikës së parlamentarizmit, Cf. Andras Sajo, *Limiting Government. An Introduction to Constitutionalism*, fq. 103-171.

55 Për Amerikën Latine dhe parlamentet e tyre sa për sy dhe faqe ose lilipt, si dhe për kultivimin e sistemeve hiperpresidenciale, Cf. më shumë në Paul W. Darke, *Between Tyranny and Anarchy: A History of Democracy in Latin America, 1800-2006* (Stanford University Press: Sanford, 2009) fq. 34-39; Për një analizë të shkëlqyer komparative të Evropës ish-komuniste dhe të Amerikës Latine, si dhe të rëndësisë së madhe që ka sistemi presidencial në Amerikën Latine, krahasuar me Evropën ish-komuniste, Cf. Valerie Bunce, “Comparing East and South”. Në Larry Diamond and Marc F. Plattner (eds.) *Democracy After Communism* (

Drejtësia kushtetuese, në kuptim të ngushtë, pra jo si pjesë e projektit madhor dhe kompleks të demokracisë kushtetuese dhe veprimt të përditshëm të institucioneve të saj, nuk arriti të dalë në sipërfaqe në Evropë deri me krijimin e republikave demokratike. Ndërkohë që, në SHBA, më 1803, Gjykata Supreme sanksionoi rolin parësor të kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë së akteve e të veprimeve të organeve të tjera të pushtetit, në Evropë, monarkia kushtetuese nuk linte hapësirë për drejtësi kushtetuese në kuptim të ngushtë: vetë sovrani kishte pushtet ekskluziv dhe kompetencë kushtetuese për moslejimin e kalimit të një akti legjislativ. Ideja e një gjykate kushtetuese nuk eci përpara, derisa monarkia kushtetuese nuk u zëvendësua me republikën. Idesë në fjalë i parapriu një elaborim teorik, i cili theksonte nevojën e ekzistimit të një institucioni të tretë që do të kujdesej për vënien në jetë të parimeve themelore të demokracisë kushtetuese, përkatësisht të drejtësisë kushtetuese në kuptim të gjerë të fjalës. Këtu e kemi fjalën, në rend të parë, për debatin shtjellues teorik Shmit – Kelsen. Siç mund të vërehet, ai debat, por edhe i tërë konteksti i drejtësisë kushtetuese në dy kuptimet e saj, të gjerë dhe të ngushtë, ka të bëjë, në pikat kyç, me themelet e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, që kontestohet sot. Jemi deri në fund të bindur se relevanca e këtij shkrimi nuk mund të kufizohet në rastin konkret kosovar. Relevanca në fjalë shtrihet më gjerë, ashtu siç ka qenë vetë debati Shmit – Kelsen, i cili ka shërbyer si udhërrëfyes permanent i formës dhe i përmbajtjes së këtij shkrimi. Ka dhe një arsye tjetër që rreshtat e këtij shkrimi i bën relevant jashtë Kosovës: dilema për rolin dhe pozitën e Presidentit të Republikës së Kosovës është aktualizuar në kuadër të kontrollit abstrakt (jo konkret) dhe preventiv të normës kushtetuese.<sup>56</sup> U mor vesh, Hans Kelsen asnjëherë nuk e ka pasur parasysh “rolin e ligjvënësit negativ” të gjykatës kushtetuese në raport me amendamentet kushtetuese. Ky segment, pra i kontrollit kushtetues të amendamenteve kushtetuese, ka lindur pas Luftës së Dytë Botërore dhe lidhet, siç do të diskutohet më vonë, me teorinë dhe me praktikën gjermane, të bazuar në interpretimet e nenit 79.3 të Ligjit Themelor të Republikës Federale të Gjermanisë.

Preokupim themelor i Hans Kelsenit ka qenë qartësimi i iluzioneve nga e kaluara, të cilat thoshin se shefi i shtetit mund të jetë gardian i kushtetutës. Kelsen u angazhua, përkundrazi, për një garanci gjyqësore dhe më efektive të dispozitave, të parimeve dhe të vetë frymës së kushtetutës. Kjo nuk

---

The John Hopkins University Press: Baltimore and London: 2002) fq. 18-32. Ky autor, në faqet 28-29 të këtij shkrimi, mendon se debati aktual, që ekziston përkitazi me atë se cili sistem i qeverisjes duhet të ketë përparësi në Evropën postkomuniste, duhet të zgjidhet në favor të sistemit presidencial, sepse, sipas tij, ai sistem ofron më shumë efektivitet dhe mundësi praktike për zgjidhjen e problemeve të ish-vendeve komuniste.

56 Ky kontroll abstrakt (jo konkret) dhe preventiv i normës kushtetuese, njihet në publik si “procesi i amendamentimit të Kushtetutës”, i cili ka filluar, siç u tha më herët, si pasojë e vënies në jetë të marrëveshjes politike të 6 prillit 2011.

nënkupton, në asnjë mënyrë, se ai nuk ka qenë për një drejtësi kushtetuese në kuptim të gjerë. Krahas veprimit të përditshëm të institucioneve dhe të organeve të tjera kushtetuese, H. Kelsen i ka dhënë rëndësi edhe formës institucionale të garantimit dhe të mbrojtjes së rendit demokratik kushtetues. Kundërshtari kryesor i kësaj qasjeje, Karl Shmit, besonte se gardiani i kushtetutës duhej kërkuar në vetë dispozitat e Kushtetutës së Vajmarit, që flisnin për presidentin e republikës, për zgjedhjen e tij nga populli dhe për kompetencat ligjvënëse nga neni 48 i Kushtetutës, përkatësisht në riinterpretimin e tyre pozitivist dhe pragmatik. Karl Shmit kishte ardhur deri te ky pozicion nëpërmjet një interpretimi tepër kritik pozitivist të këtyre dispozitave, të cilat, sipas tij, sanksiononin dhe ushqenin një sistem parlamentar jofunksional. Teorinë e tij për gardianin e kushtetutës, pas ardhjes së Hitlerit në pushtet, Shmit e bazon në interpretime të formës konkrete kushtetuese, pra jashtë dispozitave të Kushtetutës së Vajmarit.<sup>57</sup> Kjo, nga shkaku se, sipas tij, teoria në fjalë përgjithësisht nuk mund të zbulohet nga analizimi i normave juridiko-kushtetuese, por vetëm duke u bazuar në vendimin dhe në formën konkrete të një momenti.<sup>58</sup>

Duke kritikuar joefikasitetin e parlamentarizmit gjerman të kohës, Karl Shmit gjeti në shefin e shtetit të vetmin institucion që mund të garantonte unitetin sociologjiko-politik të popullit gjerman. Meqenëse i vetmi ishte presidenti që zgjidhej nga populli, si i tillë, mendonte Shmit, vetëm ai personifikonte vullnetin unik dhe homogjen të tërë popullit gjerman. Këtë nuk mund ta bënte, sipas tij, parlamenti plural, i ndarë dhe i copëzuar nga interesat partiako-politike të aktorëve të ndryshëm të shoqërisë vajmariene. Ai e shihte Kushtetutën e Vajmarit dhe formimin e Gjermanisë vajmariene si rezultat të një vendimi politik, të vetëm dhe unik, të shprehur nga i tërë kombi (populli) gjerman. Vullneti i tillë nuk mund të kishte natyrë plurale, përkatësisht nuk mund të realizohej nëpërmjet institucionit të parlamentit, të ndarë dhe të copëzuar nga interesat

---

57 K. Shmit, me një entuziazëm të pashoq, flet kundër ndarjes së pushteteve, sigurisë juridike, parashikueshmërisë së zbatimit të ligjit, si dhe prodhimeve të tjera të liberalizmit pozitivist, siç i quan ai vetë. Në vend të tyre, K. Shmit angazhohet për udhëheqësin (Fyhrerin), si mishërimi i tri gjërave në të njëjtën kohë: i shtetit, i kombit dhe i lëvizjes. Shteti, sipas këtij mishërimi, nuk është asgjë tjetër veçse një instrument në duart e udhëheqësit (Fyhrerit). Cf. Karl Smit, *Tri vrste pravnonaucnog misljenja* (Biblioteka Parerga: Beograd, 2003) fq. 34-42; 46-54. Titulli në origjinal: Carl Schmitt, *Über die drei Arten des rechtswissenschaftlichen Denkens* (Hamburg, Hanseatische Verlagsanstalt, 1934).

K. Shmit, me të drejtë është vërejtur në literaturë, tërë diskursin dhe angazhimin e tij e ka drejtuar kundër "rreziqeve të abstraksionit liberalist, formalizmit legal, potestats indirecta dhe shumë shprishjeve të tjera të koncepteve të shkaktuara nga liberalizmi (siç janë, ta zëmë, koncepti i depolitizimit, i largimit të interpretimeve teleologjike dhe historike nga politika, etj.)". Cf. William Hooker, *Carl Schmitt's International Thought. Oder and Orientation* (Cambridge University Press: Cambridge, 2009) fq. 126.

58 Cf. Karl Smit, *Tri vrste pravnonaucnog misljenja*, fq. 16-17.



partiako-politike dhe nga interesat e tjera të aktorëve politikë. Me një parlament të tillë, sipas tij, nuk mbetet askush tjetër përveç presidentit të Rajhut që mund të përfaqësonte vendimin unik dhe të vetëm të tërë kombit (popullit) gjerman. Të shohim tani teknologjinë Shmitiane, sipas së cilës shefi i shtetit bëhet gardian i vetëm i Kushtetutës vajmariane.

Pika nisëse e tij, në këtë qasje për shefin e shtetit si gardian i vetëm i kushtetutës, bazohet në teorinë e Benjamin Konstanit për të ashtuquajturin *pouvoir neutre et intermediaire*. Në shkrimin e tij, “Gardiani i Kushtetutës” (1929), Karl Shmit kritikon ashpër teorinë e kohës që modelohej sipas sistemit amerikan, ku gjykatat e larta ishin mekanizmat primarë për mbrojtjen e kushtetutës. Në fakt, gjysma e parë e këtij shkrimi kritik, të gjatë mbi 50 faqe, i dedikohet kritikës së sistemit gjyqësor si mekanizëm për garantimin e kushtetutës.<sup>59</sup> Në pjesën tjetër, Shmit shpjegon se gardian i kushtetutës mund të jetë vetëm ai organ apo ai institucion që është i furnizuar me kompetenca të veçanta, të cilat ia bëjnë të mundur që të jetë neutral, pra jashtë sistemit të vendosur vajmariant të tri pushteteve të ndara. Këtë pushtet të tretë dhe neutral, ai e sheh te shefi i shtetit, duke u bazuar në teorinë e shekullit XIX të Benjamin Konstanit dhe në mësimet e tij për “*pouvoir neuter et intermediaire*”. Këto autorizime të veçanta dhe neutrale i japin shefit të shtetit mundësinë e ndërmjetësimit në konfliktet e brendshme kushtetuese. Këtu flitet për autorizimet dhe për mundësitë që kanë të bëjnë me pozitën e privilegjuar të shefit të shtetit dhe me pacenueshmërinë e saj, me shpalljen e ligjeve, me të drejtën e faljes, me të drejtën e emërimit të ministrave dhe të zyrtarëve të tjerë shtetëror, si dhe me shpërndarjen e dhomave të zgjedhura të parlamentit. Në “*pouvoir neuter e intermediaire*” futej edhe rrethana se shefi i shtetit shihej si përfaqësues i kontinuitetit permanent të unitetit shtetëror dhe si garantues i vetëm i funksionimit unik të shtetit. Kjo rrethanë e dytë dilte, në fakt, si pasojë e autorizimeve dhe e privilegjeve presidenciale, të cilat e bënin të mundur kontinuitetin juridiko-shtetëror dhe funksionimin e pandërprerë të institucioneve të sistemit. Këto dualizma, sipas Shmitit, mundësonin që shefi i shtetit të udhëheqë (“*regne*”) dhe jo të qeverisë (“*gouverne*”). Kjo e dyta i takonte vetëm qeverisë. Këtu konsiston sintagma që thotë se “*il regne et ne gouverne pas*”.<sup>60</sup>

59 Karl Smit, “Cuvar Ustava”. Në Slobodan Samardzic (ed.), Norma i Odluka. Karl Smit i njegovi kritičari (“Filip Visnjic”: Beograd, 2001) fq. 211-253, në fq. 211-238. Titulli i originalit: Carl Schmitt, “Der huter der verfassung”. Archiv des öffentlichen rechts. Neue Folge 16 Band J.C.B. Mohr (Paul Siebeck), Tübingen 1929.

Kritikën e tij për sistemin gjyqësor dhe pamundësinë totale të këtij sistemi për të qenë gardian i kushtetutës, K. Shmit e kishte shtjelluar shumë më herët në librin e tij monumental, me titull “Teoria kushtetuese”. Cf. Carl Schmitt, Constitutional Theory (Duke University Press: Durham and London, 2008) fq. 147-164. Titulli i origjinalit: Carl Schmit, Verfassungslehre (Duncker und Humblot: Munich and Leipzig, 1928).

60 Karl Smit, “Cuvar Ustava”, fq. 241-253.

Në shkrimin e tij polemizues, me titull “Kush duhet të jetë gardian i kushtetutës?” (1931), botuar si reagim ndaj shkrimit të mësipërm, Hans Kelsen sqaron se koncepti i Benjamin Konstanit për “*pouvoir neutre et intermédiaire*” i referohet monarkisë dhe asnjëherë republikës parlamentare të tipit vajmari. Sipas Benjamin Konstanit, sqaron Kelsen, monarku ishte pjesë e ekzekutivit. Në fakt, vazhdon ai më tej, kur Benjamin Konstan ka konstatuar se “monarku është bartës i një pushteti neutral, atëherë ai këtë thënie e ka mbështetur në faktin se ekzekutivi ndahet në dy pushtete të ndryshme: njëri pushteti aktiv, kurse tjetri pushteti pasiv. Vetëm ky i dyti i takon monarkut, sepse vetëm ky është pushtet neutral dhe assesi ana e tij aktive”.<sup>61</sup> Sipas Hans Kelsenit, ky nuk ka qenë dhe nuk mund të ishte rasti me shefin e shtetit në Gjermaninë e Vajmarit, sepse ai ka qenë pjesë aktive e ekzekutivit, si pasojë e kompetencave të mëdha që ka pasur sipas nenit 48 të Kushtetutës.<sup>62</sup> Këto kompetenca, në mënyrë të kulluar, i jepnin atij mundësinë dhe të drejtën për të qeverisur (“*gouverner*”), pra jo për të udhëhequr (“*regener*”) në sensin e elaboruar nga Benjamin Konstani. Kështu, thotë Kelsen, një krahasim i tillë nga Shmiti është i pavend: sikur shefi i shtetit të caktohej për gardian të kushtetutës, atëherë ai do të shndërrohej në një diktator absolut, marrë parasysh kompetencat e njohura nga neni 48 i Kushtetutës (në veçanti kompetencat për ligjvënje në vend të Rajhstagut).<sup>63</sup> Hans Kelsen e quajti manipulim, keqkuptim dhe interpretim për qëllime ditore politike, që mëton të quhet shkencë juridike, interpretimin e dispozitës së nenit 48 të Kushtetutës së Vajmari të bërë nga Karl Shmit.<sup>64</sup>

Vetëm kalimi i kohës e zgjodhi këtë mosmarrëveshje teorike me pasoja të mëdha praktike për drejtësinë dhe për gjyqësinë kushtetuese. Kjo, megjithatë,

---

61 Hans Kelsen, “Ko treba da bude cuvar Ustava”. Në Slobodan Samardzic (ed.), *Norma i Olduka*, fq. 256-297, në fq. 265. Titulli në original: Hans Kelsen, *Wer soll der huter der verfassung sein?* (Dr. Walther Rothschild, Berlin-Grunewald, 1931).

62 Vlen të theksohet këtu se, në literaturë, me të drejtë është vërejtur që, në esencë, identiteti i K. Shmitit si konstitucionalist bazohet në avokimin e tij pa rezervë në favor të përdorimit të pushteteve (autorizimeve) nga neni 48 i Kushtetutës së Vajmarit nga Fyhreri. Këtë evokim, K. Shmit e pat filluar qysh me veprën e tij monumentale, “Teoria kushtetuese” (“*Verfassungslehre*”), (1928). Cf. William Hooker, *Carl Schmitt's International Thought. Order and Orientation*, fq. 129.

63 Hans Kelsen, “Ko treba da bude cuvar Ustava”, fq. 262.

64 *Ibid.*, fq. 297. Krahasimi i shefit të shtetit të një republike parlamentare moderne me doktrinën e shekullit XIX të Benjamin Konstanit, është e pavend. Në shekullin XIX, kjo doktrinë ka pasur për qëllim kufizimin e forcës ekzekutive të monarkut dhe ndarjen e asaj force me përfaqësuesit e popullit (me parlamentin), pra jo me qëllim të ruajtjes së kushtetutës. Doktrina për monarkinë, e cila përmblihet në shprehjen “*il regne et ne gouverne pas*”, ka pasur për qëllim kontrollin kushtetues të monarkut, pasivizimin dhe neutralizimin e anës aktive të pushtetit të vjetër ekzekutiv të monarkut absolut të kohës së para Revolucionit Borgjez Francez të vitit 1789.

ndodhi vetëm pas një katastrofe të madhe njerëzore që solli Lufta e Dytë Botërore. Gjërat shkuan ashtu siç kishte parashikuar Hans Kelsen. Shefi i shtetit, në shumicën e vendeve të botës së sotme, luan një rol të çmuar në mbrojtjen e kushtetutës nëpërmjet ushtrimit të autorizimeve të anës pasive të pushtetit. Kjo nuk ndodh në të gjitha demokracitë kushtetuese, por vetëm në rastet kur ekziston një sistem parlamentar kushtetues. Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se monopoli i ruajtjes së kushtetutës mbetet te shefi i shtetit, përkatësisht te drejtësia kushtetuese në kuptimin e gjerë të fjalës. Ai monopol i takon një institucioni tjetër, të ndarë nga pushtetet e tjera, i cili zakonisht nuk është pjesë e sistemit gjyqësor. Fjala është për gjykatën kushtetuese.

Assesi nuk do të thotë se, në terrenin politik, debati Shmit – Kelsen për natyrën dhe për funksionin e pjesës pasive të pushtetit ka humbur nga vlera e vet fillestare. Kjo vërehet në faktin se teza e Shmitit për shefin e shtetit si pushtet neutral dhe ndërmjetësues (“*pouvoir neutre et intermediaire*”) nuk është aktualisht krejt e pavlerë dhe pa një rëndësi praktike.<sup>65</sup> Në të njëjtën kohë, kjo, në asnjë mënyrë nuk nënkupton se Karl Shmit ka pasur të drejtë sa i përket substancës (përmbajtjes) së konceptit për shefin e shtetit si “*pouvoir neutre et intermediaire*”. Trajtimi i substancës (përmbajtjes) së kësaj doktrine është objekt diskutimi i pjesës në vijim të këtij punimi. Kjo substancë (përmbajtje) e bën të qartë gjendjen dhe pozitën kushtetuese të shefit të shtetit sot, në Evropë dhe më gjerë, në sistemet e demokracive parlamentare kushtetuese.

### III. Uniteti juridiko-kushtetues i popullit dhe dallimi i tij nga uniteti sociologjiko-politik

Cila, pra, është substanca (përmbajtja) e teorisë për “*pouvoir neutre et intermediaire*”, e cila e bën atë të dallueshme nga origjina e vet shmitiane? Mbi të gjitha, cila është relevanca praktike e kësaj teorie? Të kuptuarit e kësaj çështje mund të jetë komplet vetëm nëse kihen parasysh dy gjëra: e para ka të bëjë me esencën e debatit për gjyqësinë kushtetuese vajmariane, kurse, e dyta i referohet natyrës së pushtetit krijues apo konstitutiv (“*pouvoir constituant*”) në rendin kushtetues vajmarian.

Në teoritë kushtetuese angleze e franceze, për vite të tëra, u krijuan koncepte e parime për të arsyetuar dhe për të shtjelluar konceptet bazë të së drejtës

65 Në Evropë, me përjashtim të Francës, bëhet një ndarje e qartë ndërmjet shefit të shtetit dhe shefit të ekzekutivit. Këto dy role luhen nga dy individë të ndryshëm. Në Evropë, me përjashtim të Francës, shefi i shtetit është ose monark ose president i zgjedhur dhe ka në mënyrë ekskluzive vetëm funksione përfaqësuese në sensin që “il regne et ne gouverne pas”. Cf. Jurg Steiner and Markus M.L. Crepaz, *European Democracies* (Pearson Education: USA, 2007), fq. 105-110.

kushtetuese.<sup>66</sup> Për dallim nga këto, në Gjermaninë paravajmariene nuk ka pasur ndonjë debat teorik të veçantë dhe të stërholluar të tipit anglez apo francez: pushteti krijues, konstitutiv, gjendej në duart e princërve gjermanë, të cilët atë pushtet e ushtronin mbi bazën e një marrëveshjeje paraprake. Krahas kaiserit (mbretit) gjerman, mbretit të princërve, ekzistonte edhe Rajhstagu, parlamenti gjerman, i cili u krijua si përgjigje ndaj lëvizjeve populiste të fundit të shekullit XIX. Rajhstagu, megjithatë, nuk qeveriste sepse kishte një rol të kufizuar, kurse vetë qeveria nuk kishte asnjë përgjegjësi para këtij organi përfaqësues. Rajhstagu shërbente vetëm për të bërë presion publik mbi qeverinë, asgjë më shumë. Kjo zgjidhje kushtetuese paravajmariene, e cila në rendin kushtetues të kohës modelonte ndryshe pushtetin krijues (konstitutiv) monarkik nga pushteti krijues (konstitutiv) demokratik (popullor), dallonte shumë nga modeli anglez dhe francez. Kjo nuk do të thotë se ka munguar interesimi teorik gjerman për problemin e marrëdhënies ndërmjet formës kushtetuese dhe legjitimitetit politik.<sup>67</sup> Ky interesim, megjithatë, mori trajtim adekuat teorik e politik vetëm pas vitit 1919. Forma kushtetuese, e sanksionuar me Kushtetutën e Vajmarit, ka qenë ajo e një parlamentarizmi kushtetues, i cili, në të njëjtën kohë, nuk ka përjashtuar format e tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë të vullnetit politik, si dhe formimin e organit kryesor shtetëror, presidentit të Rajhut, nëpërmjet zgjedhjeve të drejtpërdrejta. Koncepti vajmarien i demokracisë kushtetuese është bazuar në kultivimin e drejtësisë kushtetuese në kuptimin e gjerë, pra në ndarjen e pushteteve (ku gjyqësia e rregullt, me në krye Gjykatën e Rajhut, ka gëzuar një pozitë të privilegjuar) dhe në njohjen e një korpusi të të drejtave e të lirive njerëzore (Kapitulli II i Kushtetutës së Kosovës). Sipas çdo standardi, Kushtetuta e Vajmarit ka qenë një kushtetutë mjaft liberale. Debatu teorik për formën kushtetuese vajmariene, ndërkaq, ka qenë pragmatik dhe është koncentruar kryesisht në rrënimin e saj. Kjo është kështu sepse një pjesë e madhe e doktrinës dhe e popullit gjerman e ka parë Kushtetutën e Vajmarit si “një rrobë false të shtetit të ri gjerman”.<sup>68</sup> I kësaj proveniencë rrënuese të rendit

66 Për të drejtën angleze, Cf. Scott Gordon, *Controlling the State. Constitutionalism From Ancient Athens to Today* (Harvard University Press: Harvard, 1999), në veçanti kapitulli 7 (“The Development of Constitutional Government and Countervailing Theory in Seventeenth – Century England”) dhe kapitulli 9 (“Modern Britain”). Për të drejtën franceze, Cf. Lucien Jaume, “Constituent Power in France”, fq. 67-85; R. C. van Caenegem, *An Historical Introduction to Western Constitutional Law*, fq. 174-193.

67 Cf. më shumë për këtë kapitullin e parë “Prologue. The Shattering of Methods in Late Wilhelmine Germany”, botuar në Arthur J. Jacobson and Benrhard Schlink (eds.), *Weimar . A Jurisprudence of Crisis* (University of California Press: Berkley, 2000 ) fq. 41-65; Michael Stolleis, *Public Law in Germany, 1800-1914* (Berghahn Books: New York and Oxford: 2001), në veçanti kapitulli 8 (“General German Constitutional Law – The Doctrine of the Imperial State”).

68 Cf. Martin Loughlin and Neil Walker (eds.), *The Paradox of Constitutionalism: Constituent Power and Constitutional Form*, fq. 91.

kushtetues vajmari, ka qenë edhe tërë diskursi shmitian.<sup>69</sup>

Në shikim të parë, debati Shmit – Kelsen duket sikur ka të bëjë vetëm me rolin dhe me rëndësinë e krijimit të një gjyqi kushtetues sipas modelit çekoslllovak-austriak, të vitit 1920. Ai debat, megjithatë, prek vetë themelet e rendit kushtetues vajmari dhe paraqet përpjekjen më sistematike për rrënimin e rendit (K. Shmit), respektivisht për mbrojtjen e këtij rendi (H. Kelsen).

Duke dhënë kundërargumente se përse nuk duhet dhe nuk mund të këtë gjykatë kushtetuese, K. Shmit theksonte se nuk mund të këtë gjykim të normave juridike, meqë gjykimi i referohet subsumcionit të një gjendje faktike që ka ndodhur në të kaluarën ndaj një norme të përgjithshme. Sipas tij, në gjyqësinë kushtetuese flitet për gjykimin e dy normave të përgjithshme, e kjo do të thotë që, nëse themelohet kjo gjykatë, atëherë duhet të ndodhë prishja e dallimit ndërmjet krijimit të normës, e cila ndodh në parlament, dhe zbatimit të saj, e cila kryhet nga gjykatat. Kjo është kështu sepse, sipas tij, në gjyqësinë kushtetuese bëhet “gjykimi” i një norme kundrejt një tjetre e kjo domethënë politikë dhe humbje e dallimit ndërmjet pushtetit legjislativ dhe atij gjyqësor meqenëse, në fund, gjykata (kushtetuese) mban të drejtën e anulimit të normës jokushtetuese.<sup>70</sup> Ky ishte argument i parë kundër gjyqësisë kushtetuese. Në fakt, duke luftuar krijimin e një gjykate të veçantë kushtetuese, K. Shmit luftonte drejtësinë kushtetuese në kuptim të gjerë, sepse mbronte deri në fund parimin e unitetit të pushtetit me udhëheqësin (Fyhrerin) në krye të tij. Për të nuk paraqiste asnjë shqetësim nëse humbej dallimi ndërmjet krijimit dhe zbatimit të normës, si pasojë e krijimit eventual të një gjykate të veçantë kushtetuese, por sepse udhëheqësi (Fyhreri) si shef shteti më nuk do të mund t’i ushtronte këto dy pushtete vetëm (krijimin dhe zbatimin e normës juridike).<sup>71</sup>

69 Cf. David Dyzenhaus, *Legality and Legitimacy*. Carl Schmitt, Hans Kelsen and Herman Heller in Weimar (Oxford University Press: Oxford, 1997) fq. 51-58; 70-84.

70 Cf. Karl Smit, “Cuvar Ustava”, fq. 211-239.

71 Gjëja më e mirë që kishin sjellë nacional-socialistët, sipas Karl Shmitit, ishte vënia në jetë e parimit të udhëheqësit (Fyhrerit) dhe, bashkë me të, i koncepteve të tjera, siç ishin lojaliteti, ndjenja e verbër për ndjekje të udhëheqësit (Fyhrerit), si dhe disiplina e nderi. Këto koncepte mund të kuptohen vetëm nga rendi dhe nga shpirti konkret gjerman dhe jo nga ndonjë abstraksion normativ i bazuar në demokracinë kushtetuese liberale. Në këtë rend konkret, ekziston relacioni shtet-lëvizje-popull (gjerman). Në këtë relacion krijohet uniteti sociologjiko-politik i rendit, rend të cilit ligjvënësi nacional-socialist i jep formë dhe jetë konkrete gjermane. Fyhreri rri në krye të këtij rendi konkret gjerman. Me këtë, ky ligjvënës, po ashtu, i jep fund mendimit dhe praktikës pozitiviste të shtetit liberal vajmari të bazuar në ndarjen e pushteteve. Cf. Karl Smit, *Tri vrste pravnonaucnog misljenja*, fq. 51-54.

Gjatë viteve 1933-1936, Karl Shmit është marrë kryesisht me çështje dhe me probleme në lëmin kushtetues. Pas kësaj periudhe, ai intensifikoi krijimtarinë e tij në lëmin ndërkombëtar. Për kritikën e thella dhe sistematike të arsytimit të diktaturës nacional-socialiste në periudhën e viteve 1933-1936, Cf. David Dyzenhaus, “The Politics of the Question of Constituent Power”.

Argumenti i dytë, në vijim për sa më sipër, i referohet jo objektit të një gjykimi kushtetues, që ishte një normë ligjore, por vetë konceptit të gjykimit në fjalë. Sipas Karl Shmitit, ajo që quhej gjykim kushtetues në Gjermaninë vajmariane, ka pasur të bëjë vetëm me ato gjykime për kompetenca që mund të lindnin ndërmjet landeve (njësive federale), komunave dhe njësive të tjera brenda sistemit federal gjerman të kohës. Pra, vetëm gjykimet në nivel jofederal, mund të cilësoheshin si gjykime kushtetuese. Për të qenë një gjykim kushtetues në nivelin e Rajhut gjerman, sipas tij, duhet të ndryshojë natyra e kushtetutës dhe e vetë shtetit të ri gjerman. Sipas K. Shmitit, ky lloj gjyqi kushtetues mund të ekzistojë vetëm nëse kushtetuta kuptohet si një kontratë, jo si një vendim unik i krejt popullit homogjen gjerman. Kur kushtetuta është kontratë, atëherë, mendonte ai, mund të formohet një gjykatë federale kushtetuese për të zgjidhur kontestet kushtetuese ndërmjet subjekteve përbërëse. Por, në rastin e Vajmarit, kjo nuk është kështu: Kushtetuta e Vajmarit, sipas Karl Shmitit, është vendim unik i krejt popullit homogjen gjerman. Populli gjerman, sipas tij, është një tërësi homogjene organike. Për këtë arsye, ideja e Hans Kelsenit për një gjykatë kushtetuese duhet të kuptohet si një përpjekje për të ndryshuar natyrën e shtetit gjerman, ku ai më nuk do të quhej si një demokraci e bazuar në kushtetutën e popullit gjerman unik dhe homogjen, por në një kontratë me një parlament të përçarë. Ky i fundit nuk përfaqësonte, sipas K. Shmitit, asgjë tjetër pos tërësinë e shumësisë së interesave johomogjene të shtresave të ndryshme gjermane. Në fakt, K. Shmit, problemin kryesor e shihte te parlamenti gjerman dhe, si i tillë, paraqiste objektin kryesor të goditjes së tij.<sup>72</sup>

Argumenti i fundit kundër gjyqësisë kushtetuese bazohet, në vijim për sa më sipër, në mohimin e demokracisë kushtetuese parlamentare. Ky mohim bazohej në bindjen se Kushtetuta e Vajmarit paraqiste një vendim unik dhe të vetëm të krejt popullit unik dhe homogjen gjerman. Bartës i këtij vullneti, të kuptuar kështu, nuk mund të jetë parlamenti i përçarë, por organi tjetër, ai që zgjidhet nga populli me votën e drejtpërdrejtë të tij. Këtu bëhet fjalë për presidentin, jo për parlamentin gjerman. Kjo qasje paraqet zbatim të një logjike metafizike: një vendim unik i një populli unik e homogjen mund të zbatohet vetëm nga një organ i tillë – unik dhe homogjen. Uniteti dhe homogjeniteti i

---

Në Martin Loughlin & Neil Walker (eds.), *The Paradox of Constitutionalism. Constituent Power and Constitutional Form*, fq. 132-133; William Hooker, *Carl Schmitt's International Thought. Order and Orientation*, fq. 126-132.

72 Për një analizë të shkëlqyer të pozicionit të Karl Shmitit kundrejt pozicionit të Hans Kelsenit, si dhe për sulmet e tij kundër parlamentarizmit gjerman, Cf. David Dyzenhaus, *Legality and Legitimacy: Carl Schmitt, Hans Kelsen and Herman Heller in Weimar*, në veçanti kapitulli 1 ("Legality and Legitimacy: Reflections from Weimar") kapitulli 2 ("Friend and Enemy: Schmitt and the Politics of Law") dhe kapitulli 5 ("Lessons from Weimar: The Legitimacy of Legality").

kombit (popullit) gjerman prezumohej. Vetëm marrja e vendimit nga ky komb (popull) duhej të ndodhte. Pikërisht presidenti, në vijim të këtij koncepti të K. Shmitit, mund ta reflektonte dhe ta ruante kushtetutën si një vendim sublim i kombit (popullit) unik dhe homogjen gjerman, assesi një gjykatë e veçantë kushtetuese. Pse presidenti? Sepse, sipas K. Shmitit, vetëm ai përfaqësonte dhe personifikonte vullnetin e krejt kombit (popullit) unik homogjen gjerman. Sipas Kushtetutës së Vajmarit, mendonte Shmit, vetëm presidenti posedonte ato pushtete neutrale që i jepnin mundësinë për zgjidhjen e konflikteve kushtetuese dhe politike në nivel të Rajhut: vetëm presidenti është neutral, i tretë, i paanshëm dhe me pushtete kushtetuese neutrale, të cilat mundësojnë zgjidhjen e çdo konflikti shtetëror, politik dhe kushtetues brenda Rajhut.<sup>73</sup> “Integrimi funksional”, i cili ndodh nëpërmjet zgjedhjeve, votimeve, koalicioneve zgjedhore, etj., siç predikohej prej Rudolf Smendit dhe liberalëve të tjerë të kohës,<sup>74</sup> nuk i përshtatej këtij koncepti shmitian. Presidenti nuk përfaqësonte këtë integrim funksional, por vetëm kombin (popullin) organik e homogjen të integruar politikisht në një shtet të ri gjerman. Ky integrim politik po ndodh sepse, mendonte K. Shmit, gjermanët po lëviznin drejt krijimit të shtetit total, ku do të humbiste çdo dallim ndërmjet shtetit dhe pjesës tjetër të shoqërisë që ekzistonte jashtë shtetit. Kjo nënkuptonte se shteti po bëhej total në kuptimin e gllabërimit të shoqërisë tjetër gjermane në të gjitha sferat: politike, ekonomike, sociale e kulturore. Në këto rrethana e në këto kushte, vetëm presidenti mund të ishte mbrojtës i kushtetutës, sepse vetëm ai përfaqësonte unitetin organik të kombit (popullit) gjerman.<sup>75</sup> Sipas këtij interpretimi shmitian, del se kombi (populli) gjerman gjithnjë presumohet të jetë homogjen në pikëpamje sociologjiko-politike.

Duke e mbrojtur fuqishëm idenë e krijimit të një gjykate kushtetuese të veçantë dhe të ndarë nga tri pushtetet e tjera, Hans Kelsen ka dhënë argumente që i kanë qëndruar kohës. Në rend të parë, ai është mbështetur në formën parlamentare të sistemit kushtetues vajmarian. Këtë formë, assesi popullin gjerman si tërësi, ai e ka parë si personifikim të vullnetit origjinal të pushtetit konstitutiv (“*pouvoirs constituant*”). Ky vullnet origjinal, krijues, i pushtetit konstitutiv, realizohet nëpërmjet institucioneve dhe organeve përkatëse kushtetuese si pushtete derivative (“*pouvoirs constituee*”), të krijuara nga pushteti konstitutiv. Në një demokraci kushtetuese, pushtetet janë të ndara dhe vetë presidenti vajmarian konsiderohej pjesë përbërëse e atyre pushteteve, meqë kishte jo vetëm pushtete pasive, të cilat K. Shmit i cilëson-

73 Karl Smit, “Cuvar Ustava”, fq. 239-252.

74 Cf. Stefan Koriotoh, “Rudolf Smend”. Në Arthur J. Jacobson and Benrhard Schlink (eds.), Weimar . A Jurisprudence of Crisis, fq. 207-212; Rudolf Smend, “Constitution and Constitutional Law”. Në Arthur J. Jacobson and Benrhard Schlink (eds.), Weimar . A Jurisprudence of Crisis, fq. 213-248.

75 Karl Smit, “Cuvar Ustava”, fq. 244-253.

te si pushtete neutrale, por edhe aktive, të cilat e bënin të pamundur që ai të shërbente si gardian i kushtetutës. Në esencë, thotë H. Kelsen, Kushtetuta e Vajmarit e ndan pushtetin ndërmjet dy faktorëve: parlamentit dhe qeverisë. Kjo e fundit ngërthente në vete edhe shefin e shtetit dhe ministrat e qeverisë, të cilët kundërfirmosnin aktet e tij.<sup>76</sup>

H. Kelsen fuqishëm ka kundërshtuar teorinë e K. Shmitit që theksonte se kombi (populli) gjerman është homogjen dhe se Kushtetuta e Vajmarit, në preambulën e saj, i referohej pikërisht këtij homogjeniteti. Ky homogjenitet, sipas K. Shmitit, rrezikonte të prishej nga pluralizmi i Rajhstagut, në të cilin ravijëzoheshin në pafundësi dhe pa kthim dallimet thelbësore ndërmjet shtetit dhe shoqërisë gjermane. Për të penguar prishjen (copëtimin) e këtij homogjeniteti, shoqëria gjermane po lëvizte drejt një integrimi tjetër jofunksional, integrim që bazohej në shtetin total. Instrumenti kryesor dhe leva lëvizëse drejt shtetit total ishte presidenti i Rajhut: ai dhe askush tjetër kishte detyrimin dhe mundësinë kushtetuese të personifikimit të vullnetit unik dhe homogjen të kombit (popullit) gjerman të integruar në tërësi në aspektin socio-politik. H. Kelsen, me një mjeshtëri të rrallë, vërejti se K. Shmit po luftonte unitetin juridiko-kushtetues të popullit gjerman nëpërmjet ndërtimeve teorike, të nxjerra nga një interpretim momental pozitivist i Kushtetutës së Vajmarit. Në këtë ndërtim joreal, Shmit po i jepte presidentit të Rajhut rolin e përfaqësuesit dhe personifikuesit të vetëm të vullnetit momental, unik dhe homogjen të tërë kombit (popullit) gjerman. Kushtetuta e Vajmarit ishte një vendim momental i këtij kombi (populli) gjerman, i kuptuar në këtë mënyrë. Ky fakt, që është vërejtur nga H. Kelsen, ka mjaftuar që K. Shmit ta paraqiste presidentin e Rajhut si gardianin e vetëm të kushtetutës: zgjedhja e tij e drejt-përdrejtë garantonte se ai, dhe vetëm ai, mund t'i kundërvihej parlamentit, si simbol i ndarjes së shtetit nga shoqëria dhe, në të njëjtën kohë, të shërbente si garantues i "shtetit total", ku do të humbiste përgjithmonë dallimi ndërmjet shtetit dhe shoqërisë. Këtij koncepti, thuajse kuazibiologjik, H. Kelsen i kundërvihej me teorinë gjithnjë aktuale e moderne, e cila thotë se nuk ka unitet të popullit në kuptimin sociologjik dhe as fshirje të dallimit ndërmjet shtetit dhe shoqërisë: ai unitet në secilën kushtetutë është vetëm juridiko-kushtetues dhe, si i tillë, mbijeton dallimet socio-politike dhe dallimet e tjera në shtet dhe në shoqëri, duke paqësuar dallimet e tilla vetëm me rrugë institucionale dhe me organe të sistemit, të krijuara me kushtetutë e me ligje. Teorinë e Karl Shmitit për gjykatën kushtetuese si një fikcion, Hans Kelsen e rrëzon pikërisht me këtë që u tha këtu, pra me atë se uniteti i popullit në kuptimin sociologjiko-politik është fikcion metafizik që nuk mund të provohet në asnjë mënyrë dhe me asnjë mjet. Ajo që shefi i shtetit përfaqëson unitetin shtetëror, thotë Kelsen, nuk nënkupton asnjëherë dhe në asnjë mënyrë se



bëhet fjalë për unitet material, sociologjik, por për një unitet juridiko-kushtetues të shtetit. Ky unitet, thotë më tutje Kelsen, nuk nënkupton se shefi i shtetit përfaqëson solidaritetin e interesave efektive në një kohë konkrete, por të kundërtën e tyre: kuptimi i saktë dhe i vërtetë i teorisë për “*pouvoir neutre et intermediaire*” të shefit të shtetit është se ai duhet t'i fshehë (mbulojë) dhe të neutralizojë kundërthëniet radikale të interesave socio-politike, klasore dhe të interesave të tjera që përfaqësojnë partitë politike dhe aktorët e tjerë. Me një fjalë, shefi i shtetit nuk mund të jetë përfaqësues i interesave radikalisht të kundërta të aktorëve socio-politikë, socio-ekonomikë dhe socio-kulturorë në shoqëri dhe në shtet.<sup>77</sup>

Sikundër vërehet, K. Shmit e bën çdo arsyetim nga një prizëm e demokracisë radikale, e kuptuar si sundim i shumicës, pra jo në kuptimin modern të demokracisë kushtetuese që bazohet në ndarjen dhe në balansimin e pushteteve, në sundimin e ligjit dhe në respektimin e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve. Kjo qasje e dytë, me gjyqësinë kushtetuese si garant dhe si mbrojtës i parimeve, i vlerave e i normave të konstitucionalizmit bashkëkohor, ekziston vetëm te H. Kelsen dhe përbën një pjesë mjaft të madhe të polemikës së tij me K. Shmitin dhe me autorët e tjerë të proveniencës konservative vajmariane.<sup>78</sup> Për këtë arsye, ka rëndësi të shohim te këta dy autorë raportin ndërmjet demokracisë radikale, e kuptuar si sundim i shumicës, me demokracinë kushtetuese dhe përbërësit e saj. Kjo, në esencë, nuk është asgjë tjetër veçse një anë tjetër e debatit të tyre për pushtetin krijues, origjinal, konstitutiv (“*pouvoir constituant*”) dhe pushtetit derivativ, joorigjinal, të konstituuar (“*pouvoir constituee*”) dhe për rolin e presidentit, si personifikues dhe si përfaqësues i unitetit juridiko-kushtetues të popullit, i cili, si i tillë, është i ndarë sipas shtresëzimeve të ndryshme socio-politike, ekonomike, kulturore e të tjera.

Esenca e diskursit të K. Shmitit, jo vetëm në polemikën me H. Kelsenin, qëndron në përpjekjen e tij të qëllimshme e sistematike për të mbajtur gjallë epërsinë e demokracisë radikale, e kuptuar si sundim i shumicës, me Fyhre-rin në krye të saj.<sup>79</sup> Demokracia kushtetuese, siç u vërejt më herët në këtë

77 Ibid., fq. 285-289.

78 Cf. përveç kapitujve nga fusnota 72 e më lart, edhe kapitullin 3 (“The Pure Theory in Practice: Kelsen’s Science of Law”) nga libri David Dyzenhaus, *Legality and Legitimacy: Carl Schmitt, Hans Kelsen and Herman Heller in Weimar*. Nuk ka asnjë dyshim se vepra kryesore e Hans Kelsenit, që sublimon tërë esencën e diskursit të tij për gjyqësinë kushtetuese, është *General Theory of Law and State* (The Lawbook Exchange Ltd.: Clark, New Jersey, 2007, 2009). Kjo, në fakt, është riformulim i përmbledhur i librit të tij, *Pure Theory of Law* (The Lawbook Exchange Ltd.: Clark, New Jersey, 2002, 2009). Botimet e para të këtyre dy librave kanë parë dritën para se të zhvillohej polemika me Karl Shmitin, në gjuhë dhe me tituj pak më të ndryshëm.

79 Përveç shkrimeve të përmendura deri më tash në këtë punim, vlen të theksohen

shkrim, paraqet sinonim të drejtësisë kushtetuese në kuptimin e gjerë të fjalës. Për të ruajtur këtë vijë arsyetimi, pra të epërsisë së demokracisë radikale, e kuptuar si sundim i shumicës, kundrejt demokracisë kushtetuese në kuptim të gjerë të fjalës, Karl Shmit ka një shtjellim me një arsyetim të veçantë të kufizimeve të pushtetit shtetëror, kufizime që ai i gjen në dispozitat e Kushtetutës së Vajmarit për të drejtat e njeriut dhe për balansimin e pushteteve. Të parat, ai i sheh si kufizime, të cilat në thelb burojnë nga vendimi konkret konstitutiv i kombit (popullit) unik homogjen gjerman, i cili ka thënë se individët duhet t'i gëzojnë këto të drejta në një mënyrë të caktuar, kurse të dytat kufizime i sheh si të bazuara mbi ekzistimin e supozuar të një pushteti unik dhe të pandarë, nga i cili më pastaj burojnë kompetencat në dobi të degëve të caktuara të pushtetit.

Këto dy lloje të dispozitave, K. Shmit i quan ide të shtetit liberal, të cilat synojnë neutralizimin e çdo veprimi politik. Ky neutralizim buron në shtetin liberal, nga një interpretim i Kushtetutës së Vajmarit, i cili është qëllimisht normativ, jopolitik dhe josociologjik. Kjo nënkupton se çdo pjesë e pushtetit shtetëror rregullohet me norma juridiko-kushtetuese dhe ligjore, ashtu që nuk mund të ketë vend për aksion politik të tipit të demokracisë radikale. Thënë shkurt, jashtë normave juridiko-kushtetuese e ligjore, nuk ka veprim politik të subjektit, i kuptuar si popull shumicë, i cili ushtron pushtetin krijues (origjinal, konstitutiv).<sup>80</sup> Kjo do të thotë se K. Shmit, për dallim nga H. Kelsen, i sheh këto dy çështje (të drejtat e njeriut dhe ndarjen e balansimin e pushteteve) si neutralizim të demokracisë radikale, sepse e zëvendësojnë aksionin politik të subjektit popull, i kuptuar si shumicë, me aksionin politik në emër të subjektit të tillë.

---

edhe këto shkrime të Karl Shmitit, në të cilat ai, në mënyrë sistematike, angazhohet për demokraci radikale dhe kundër demokracisë kushtetuese: Carl Schmitt, *Political Theology: Four Chapters on the Concept of Sovereignty* (The University of Chicago Press: Chicago, 1985); Carl Schmitt, *Political Romanticism* (MIT Press: Massachusetts, 1986); Carl Schmitt, *The Crisis of Parliamentary Democracy* (The MIT Press: Massachusetts, 1988); Carl Schmitt, *Roman Catholicism and Political Form* (Greenwood Press: Westport, 1996); Carl Schmitt, *The Concept of the Political* (The University of Chicago Press: Chicago, 1996, 2007); Carl Schmitt, *Theory of the Partisan* (Telos Press Publishing: New York, 2007); Carl Schmitt, *The Leviathan in the State Theory of Thomas Hobbes* (The University of Chicago Press: Chicago, 2008); Carl Schmitt, *Political Theology II: The Myth of the Closure of Any Political Theology* (Polity Press: USA, 2008). Shumica e këtyre veprave janë botuar në kohën e Gjermanisë vajmariane, në gjuhën gjermane. Për kritikën e diskursit shmitian të kësaj kohe, Cf. David Dyzenhaus (ed.), *Law as Politics* (Duke University Press: Durham and London, 1998); Alberto Predieri, *Carl Schmitt, un NAZISTA senza CORAGGIO. Vëllimi I dhe II* (La Nuova Italia Editrice: Firenze, 1998, 1999).

80 Cf. Carl Schmitt, *Constitutional Theory*, fq. 200 e tutje; Hans Kelsen, 'On the Essence and Value of Democracy'. Në Arthur J. Jacobson and Bernhard Schlink (eds.), *Weimar: A Jurisprudence of Crisis*, fq. 154-155; 291-292.

Në teorinë dhe në praktikën kushtetuese të tipit kelsenian, megjithatë, pranohej se populli, si subjekt, vetë kurrë nuk është i pranishëm në veprimin politik konstitutiv (krijues, origjinal).<sup>81</sup> Një akt i tillë mund të identifikohet si akt i subjektit, i kuptuar si popull, vetëm duke qenë e mundur që akti në fjalë t'i atribuohet (mvishet) subjektit popull-shumicë, akt që realizohet nëpërmjet organeve apo përfaqësuesve të këtij subjekti. Në terma kushtetues, ky veprim që i atribuohet (mvishet) subjektit popull-shumicë, por që ndërmerret nga organet apo nga individët që përfaqësojnë pushtetin konstitutiv (krijues, origjinal), paraqet kushtin minimal për mbrojtjen e individit (segmenti i mbrojtjes së të drejtave të njeriut) dhe ushtrimin e pushtetit në kuptimin modern kushtetues (segmenti i ndarjes dhe i balansimit të pushteteve). Shikuar nga ky kuptim, demokracia kushtetuese nuk e neutralizon veprimin politik të subjektit popull-shumicë. Ajo, e kuptuar si tërësi e dispozitave dhe e praktikave për të drejtat e njeriut dhe për ndarjen e balansimit të pushteteve, nuk bën asgjë tjetër veçse garanton kushtet institucionale për veprim politik në emër të subjektit (i kuptuar si popull, që nuk është as shumicë e as pakicë, por thjesht subjekt-popull). Kushdo që flet në emër të popullit, duhet ta ketë parasysh se demokracia kushtetuese jep dhe garanton formën institucionale të identitetit kolektiv dhe individual, mbi të cilin mbështetet një shoqëri moderne demokratike. Thënë ndryshe, demokracia radikale, e kuptuar si sundim i shumicës, “kullohet” nëpërmjet filtrave që përbëjnë demokracinë kushtetuese, si dhe veprimeve të cilat qartë mund t'i atribuohen (mvishen) subjektit i kuptuar si popull (që nuk është as shumicë e as pakicë, por thjesht subjekt-popull). Ky atribuim (mvëshje) del si pasojë e veprimeve të organizuara të individëve që përfaqësojnë subjektin e tillë. Dispozitat kushtetuese për ndarjen dhe për balansimin e pushteteve dhe ato për të drejtat e njeriut, paraqesin “filtrat” kryesorë që zbusin parimin e demokracisë radikale, e kuptuar si sundim i shumicës, dhe janë vetë baza mbi të cilën mbështetet uniteti juridiko-kushtetues i popullit, i kuptuar si subjekt.

Dispozita të tilla përmbajnë të gjitha kushtetutat evropiane dhe ato të vendeve të tjera, të modeluara sipas modelit të konstitucionizmit perëndimor. Kosova nuk përbën përjashtim nga kjo: nenet 4.3 dhe 83 të Kushtetutës flasin për këtë lloj të unitetit juridiko-kushtetues, të cilin e përfaqëson presidenti i Kosovës, kurse çdo veprim i autorizuar nga dispozitat kushtetuese të nenit 84 të Kushtetutës nuk përbëjnë veçse veprime të cilat mund t'i atribuohen (mvishen) presidentit të Kosovës.<sup>82</sup> Presidenti, thotë Kushtetuta në nenin

81 Cf. analizën elokuyente krahasuese të kësaj çështjeje, në Hans Lindahl, “Constituent Power and Refleksive Identity: Towards and Ontology of Collective Statehood”. In Martin Loughlin and Neil Walker (eds.), *The Paradox of Constitutionalism. Constituent Power and Constitutional Form*, fq. 9-24;

82 Në nenin 84 të Kushtetutës së Kosovës janë paraparë tridhjetë (30) lloj kompetencash, të cilat i takojnë Presidentit të Republikës. Dy të parat, jo rastësisht, sërish përsërisin

83, “është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës”. Dispozitat kushtetuese nga neni 84 janë dispozita autorizuese në sensin që çdo veprim i ndërmarrë në vijim të zbatimit të tyre cilësohet si atributiv, pra mund t’i mvishet presidentit. Kjo cilësi buron nga neni 84 i Kushtetutës, i cili i operacionalizon dhe u jep kuptim dispozitave të neneve 4.3 dhe 83 të Kushtetutës, me të cilat definohet rëndësia dhe roli primar i kreut të shtetit kosovar. Por, dispozitat në fjalë nuk mund të shikohen të izoluara, sepse ato autorizojnë veprime që mund t’i atribuohen (mvishen) presidentit vetëm atëherë kur ushtrohen brenda kuadrit kushtetues dhe në frymën e parimeve e të normave të tjera për ndarjen e për balansimin e pushteteve, për sundimin e ligjit dhe të demokracisë, si dhe të respektit për të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve. Këto parime e norma gjenden të sanksionuara në Kapitullin I (Dispozitat Themelore), në Kapitullin II (Të Drejtat dhe Liritë Themelore) dhe në Kapitullin III (Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre) të Kushtetutës. Çdo ushtrim i pushtetit dhe çdo veprim politik që kryhet, mund t’i mvishet (atribuohet) popullit të Kosovës vetëm atëherë kur ushtrohet në respektim të këtyre kapitujve të Kushtetutës. Kjo vlen edhe për presidentin e Kosovës, i cili përfaqëson dhe mishëron unitetin juridiko-kushtetues të popullit të Kosovës si tërësi, me kusht që autorizimet nga neni 84 i Kushtetutës kryhen brenda kuadrit kushtetues të këtyre tre kapitujve.

#### **IV. Kushtetutat mbrojnë shefin e shtetit, jo individin *ad hominem***

Ideja e kontrollit kushtetues të amendamenteve kushtetuese tingëllon paradoksale në sensin që, në këto raste, bëhet kontrolli kushtetues i një propozim-norme kushtetuese, duke e krahasuar me një normë tjetër kushtetuese, e cila gjendet në tekstin fillestar (origjinal) kushtetues. Kjo, vetvetiu, hap dilema kuptimore, sepse vetë ideja e drejtësisë kushtetuese, në kuptim të ngushtë të fjalës, e konceptuar nga H. Kelsen, konsiston në kontrollin kushtetues të normës ligjore, si normë më e ulët se norma kushtetuese, për të parë nëse norma e tillë ligjore është në pajtim (harmoni) me normën kushtetuese, si normë më e lartë për nga fuqia juridike në hierarkinë e përgjithshme të normave. Megjithatë, ky lloj kontrolli kushtetues jo vetëm që ekziston por, në disa vende (si p.sh., në SHBA), është më i vjetër sesa vetë kontrolli kushtetues i ligjeve.<sup>83</sup>

---

tekstin e dispozitave të neneve 4.3 dhe 83 të Kushtetutës. Pra, që në fillim të përcaktimit të kompetencave të Presidentit të Republikës, në dy paragrafët e parë ritheksohet se ai/ajo është përfaqësues i Republikës së Kosovës, brenda dhe jashtë, si dhe garantues i funksionimit kushtetues të institucioneve të përcaktuara me Kushtetutë.

83 Vendimi i parë i Gjykatës Supreme përkita me kushtetutshmërinë e amendamenteve kushtetuese është marrë më 1798, në rastin *Hollingsworth v. Virginia*, pesë vjet para rastit *Marbury v. Madison* (1803), me të cilin u themelua praktika e kontrollit kushtetues të

Arsyeja kryesore dhe e vetme për ekzistimin e këtij lloji të kontrollit kushtetues qëndron në faktin se, në mjaft raste, kushtetutat përmbajnë parime e dispozita që konsiderohen si të paamendmentueshme. Kjo do të thotë se, parimet e dispozitat e tilla, në asnjë rast nuk mund të jenë objekt amendamenti. Këto parime e dispozita, të cilat nuk mund të jenë objekt amendamenti në asnjë rast apo rrethanë, u cilësuan me emra të ndryshëm nga teoria kushtetuese. Kjo u tha në pjesën e parë të këtij shkrimi. Këtu mjafton të thuhet se, termi i përdorur për herë të parë, me qëllim të tregimit të parimeve dhe të dispozitave kushtetuese që nuk mund të amendamentohen, ka qenë “dispozitat e rrënjosura” (“*entrenched provisions*”) dhe është futur në përdorim nga vetë K. Shmit para Luftës së Dytë Botërore.<sup>84</sup> Në Evropë, pas Luftës së Dytë Botërore, koncepti për “dispozitat e rrënjosura” (“*entrenched provisions*”) u rikrijua nga doktrina gjermane.<sup>85</sup> Tashmë u theksua më herët se, në një mënyrë krejt paradoksale, ka qenë Karl Shmit prapa idesë së tekstit nga dispozita 79.3 e Ligjit Themelor të Republikës Federale të Gjermanisë, nen ky në të cilin u mbështet teoria dhe praktika gjermane për parimet dhe për dispozitat e paamendmentueshme kushtetuese. Nganjëherë kjo cilësohet si teoria dhe praktika për “amendamentet jokushtetuese në kushtetutë” (“*unconstitutional constitutional amendments*”).<sup>86</sup>

Kjo teori, dhe praktika e bazuar mbi të, duhet të dallohen nga pengesat pro-

ligjeve. Cituar në Kemal Gozler, *Judicial Review of Constitutional Amendments. A Comparative Study* (EKIN PRESS: Bursa, 2008), fq. 29.

84 Ai përdori këtë term, siç u tha më herët në këtë shkrim, në një analizë të tij për Kapitullin II të Kushtetutës së Vajmarit, ku sanksionoheshin të drejtat dhe liritë e gjermanëve. Këto “dispozita të rrënjosura”, sipas tij, paraqisnin kushtetutën e dytë të Gjermanisë (krahas Kushtetutës së Vajmarit). Pse? Sepse, mendonte ai, ky kapitull kufizonte ushtrimin e pushtetit shtetëror të presidentit të Rajhut dhe të qeverisë së tij, meqenëse krijonte detyrime shtesë dhe të veçanta për këto organe, e në favor të gjermanëve. Cf. Karl Smit, “Legalnost i Legitimnost”, fq. 323-336. Pwr mw shumw komente nga autorwt tjerw, Cf. Ulrich K. Preuss, “The Implications of ‘Eternity Clauses’: The German Experience”. *Nw ISRAEL LAW REVIEW* Vol. 44 No. 3 (2012).

85 Rasti i parë në praktikë ka ndodhur më 23 tetor 1952 dhe njihet me emrin “South-west Case”. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese Federale e Gjermanisë ka theksuar se ekzistojnë disa parime e vendime të cilave i nënshtrohen dispozitat e tjera kushtetuese dhe të cilat nuk mund dhe nuk guxojnë të cenohen në asnjë rast. Cf. Kemal Gozler, *Judicial Review of Constitutional Amendments. A Comparative Study*, fq. 55-56; 84-86; Donalds P. Kommers, “German Constitutionalism.: A Prolegomenon”, fq. 858-859, fusnota nr. 60.

86 Kushtetuta e SHBA-së, në nenin V, flet për ndalimin e çfarëdo amendamenti që cenon të drejtën e votës së barabartë të shteteve anëtare, kurse Kushtetuta e Norvegjisë, e vitit 1814, në nenin 112 të saj, flet për ndalimin e çfarëdo amendamenti që bie ndesh me parimet dhe me shpirtin e tekstit origjinal kushtetues. Cf. më shumë për këtë në Kemal Gozler, *Judicial Review of Constitutional Amendments. A comparative Perspective*, fq. 10-12; 28-34; 78-80; Lechh Garlicki and Zofia A. Garlicka, “Review of Constitutionality of Constitutional Amendments (An Imperfect Response to Imperfections). *Journal of Constitutional Law/Review De Droit Constitutionnel* Vol. 1, Issue 1 (Year 2012) fq. 205 fusnota nr. 46.

cedurale kushtetuese, të cilat vështirësojnë dukshëm, nganjëherë edhe e bëjnë të pamundshëm, amendamentimin e kushtetutës. Në këso raste, pa pasur një konsensus substancial brenda shoqërisë, nuk mund të ndodhë amendamentimi kushtetues. Këto pengesa, për herë të parë, janë sanksionuar në nenin V të Kushtetutës Amerikane të vitit 1787 dhe, më pastaj, janë bartur nëpër kushtetutat e vendeve të tjera, por janë rimodeluar në mënyra të ndryshme. Këto dispozita procedurale paraqesin kuptimin e “kushtetutës rigjide”, e cila u diskutua më herët. Në rastin e teorisë dhe të praktikës për parimet dhe për dispozitat e paamendamentueshme, megjithatë, bëhet fjalë për parime dhe për dispozita që gjenden në pjesët materiale të kushtetutës. Si të tilla, ato vetvetiu nuk mund të jenë objekt amendamentimi. Dispozitat procedurale, që paraqesin kuptimin e “kushtetutës rigjide”, përkundrazi, mund të ndryshohen nëse ndjekin procedurën e paracaktuar kushtetuese. Ky dallim, siç shihet, është mjaft i madh, sepse, derisa të parat nuk mund të ndryshohen fare, në rastin e dispozitave procedurale kushtetuese, ndryshimi nuk përjashtohet nëse ndiqet një procedurë e paracaktuar kushtetuese.

Në vijim për sa më sipër, së dyti, këto parime e dispozita të paamendamentueshme janë vetë identiteti kushtetues i një vendi, vetë “ADN”-ja e tij, pa të cilat vetë kushtetuta nuk ka asnjë kuptim. Parimet dhe dispozitat, të cilat nuk mund të ndryshohen asnjëherë dhe në asnjë rrethanë, zakonisht i referohen formës republikane të qeverisjes, raportit ndërmjet qendrës dhe periferisë shtetërore, laicitetit të shtetit, demokracisë kushtetuese, sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut, etj. I tillë është rasti, ta zëmë, i Gjermanisë, i Francës, i Turqisë, i Norvegjinë, i Portugalisë, i Rumanisë, i Ukrainës, i Azerbajxhanit, i Afrikës së Jugut, dhe i mjaft shteteve të tjera. Këtu e kemi fjalën për vendet që kultivojnë demokraci kushtetuese të modeluar sipas konstitucionalizmit perëndimor, sepse ka vende të tjera, ta zëmë Maroku, në të cilin, si dispozita të paamendamentueshme, janë ato që kanë të bëjnë me ruajtjen e rolit primar të islamit në shoqëritë e këtyre vendeve.<sup>87</sup>

Së treti, vetë ekzistimi i këtyre parimeve e i dispozitave të paamendamentueshme kushtetuese, gëzon mbrojtje gjyqësore në sensin që çdo amendament kushtetues, i cili bie ndesh me to, shpallet antikushtetues nga gjykata respektive. Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se kontrolli kushtetues i amendamenteve ekziston vetëm në ato vende ku kushtetutat përmbajnë parime dhe dispozita të paamendamentueshme dhe anasjelltas. Ka raste kur teksti origjinal ekzistues kushtetues përmban parime dhe dispozita kushtetuese që nuk mund të amendamentohen, por që në praktikë kurrë nuk ka

87 Jo vetëm Maroku, por edhe shumë vende islamike, kanë të njëjtin modelim të dispozitave kushtetuese të pandryshueshme dhe i referohen kryesisht rolit primar të fesë islame në shoqëritë e tyre. Cf. Amina El Messaoudi, “Il Modelo di Giustizia Costituzionale in Marocco”. Në Luca Mezzeti, Sistemi e Modeli di Giustizia Costituzionale. Tomo II CEDAM: Padova, 2011.

ndodhur kontrolli i amendamenteve kushtetuese. I tillë është rasti, ta zëmë, me Kushtetutën e Norvegjisë, të vitit 1814. Njëjtë me këtë, ka raste kur fare nuk ekzistojnë parime dhe dispozita kushtetuese, të cilat nuk mund të amendamentohen, por që, në praktikë, gjykatat respektive kanë zhvilluar një praktikë gjyqësore për lakmi dhe tepër të pasur. I tillë është rasti, ta zëmë, i Indisë.

Së fundi, rasti i kontrollit kushtetues të amendamenteve është kontroll abstrakt i normës juridiko-kushtetuese, pra nuk i referohet zbatimit të saj në një rast konkret, por ndaj të gjitha rasteve të kohës që vjen. Në pjesën dërmuese të shteteve, kontrolli abstrakt i normës juridiko-kushtetuese kryhet vetëm *a posteriori*, pra pasi të ketë hyrë në fuqi norma juridiko-kushtetuese e përmbajtur në amendament. Përjashtimet janë të rralla, siç u theksua më herët, kur kontrolli kushtetues i amendamenteve kryhet para se ato të hyjnë në fuqi. Në këtë përjashtim, në Evropë, bën pjesë edhe Kosova, kurse jashtë Evropës: Kili, Afrika e Jugut, Azerbajxhani, etj.

Në vijim të zbatimit të dispozitës kushtetuese të neneve 113.9 dhe 144.1 të Kushtetutës së Kosovës, të cilat parashohin si të detyrueshëm dërgimin për kontroll kushtetues të çdo amendamenti kushtetues, ka lindur edhe “çështja e presidentes Jahjaga”. Kontestimi i legjitimitetit të saj nuk është juridiko-kushtetues, por është politik, dhe bazohet në bindjen se “ajo nuk përfaqëson vullnetin politik të popullit të Kosovës”, kurse Gjykata Kushtetuese, sipas kontestuesve, ka gabuar kur ka thënë se “populli i Kosovës pret që presidentja të jetë përfaqësuese e tyre për pesë vjetët e ardhshëm”.

Ky shkrim trajton vetëm anën jopolitike të “çështjes së presidentes Jahjaga”, pra atë që ka të bëjë me sqarimin komparativ të kontrollit abstrakt dhe preventiv (paraprak) të amendamenteve, të cilin Gjykata e kryen në bazë të neneve 113.9 dhe 114.1 të Kushtetutës së Kosovës. Politikës ditore dhe aktorëve të saj, i lihet liri e plotë e gjykimit në kontestimet reciproke politike *ad hominem*. Këto kontestime, në asnjë mënyrë, nuk mund ta zbehin esencën e teorisë dhe të praktikës për “amendamentet jokushtetuese në kushtetutë” dhe për zbatimin e saj “në rastin konkret të presidentes Jahjaga”.

Në rastin e Kosovës, kjo teori dhe praktikë, mbështet vetëm te një fjali, e cila thotë se çdo amendament në Kushtetutën e Kosovës duhet të shkojë në Gjykatën Kushtetuese për kontroll gjyqësor, për të parë nëse amendamenti i propozuar zvogëlon të drejtat nga Kapitulli II i Kushtetutës. Kjo do të thotë se, në praktikë, Kapitulli II i Kushtetutës është “ADN“-ja e Kushtetutës së Kosovës, vetë identiteti i saj si shtet sovran e i pavarur. Çdo kontroll gjyqësor i amendamenteve si më sipër, bëhet *in abstracto*, duke i marrë parasysh vetëm kriteret e gjykimit profesional abstrakt, të cilat vlejné çdo herë, për këdo dhe në çdo rast apo rrethanë në të ardhmen. Kjo do të thotë se Gjykata Kushtetuese fare nuk ka mundur të marrë parasysh se çfarë ka qenë forma

dhe përmbajtja e marrëveshjes politike, e as kush dhe si është bërë president i Kosovës në vijim të zbatimit të marrëveshjes. Këto aspekte kanë qenë dhe janë objekt diskutimi i politikës kosovare, jo i Gjykatës Kushtetuese.

Të shohim, pra, në pak më shumë detaje, çfarë ka thënë Gjykata Kushtetuese e Kosovës me rastin e kontrollit abstrakt dhe preventiv (paraparak) të amendamenteve kushtetuese, të propozuara nga grupi i 30 deputetëve të Kuvendit të Kosovës, gjatë muajve mars dhe maj të vitit 2012.

Gjykata, në asnjë rast, nuk është marrë me anën politike të “çështjes Jahjaga”. Fjala ka qenë dhe është për kontroll kushtetues abstrakt dhe preventiv (paraparak) të amendamenteve kushtetuese, 11 (njëmbëdhjetë) sish, të propozuara në vitin e katërt të jetës së Kushtetutës së Kosovës. Ky Aktgjykim është i dyti i llojit të vet në praktikën e Gjykatës.<sup>88</sup> Është abstrakt dhe fare nuk lidhet me emër, me situatë konkrete apo me rrethana të rastit konkret dhe të pranishëm. Një qasje e tillë e Gjykatës del nga vetë dispozitat kushtetuese për kontrollin preventiv (paraparak) të propozim-amendamenteve kushtetuese. Këto dispozita mandatojnë Gjykatën që të ushtrojë këtë lloj kontrolli, duke pasur parasysh çdo herë vetëm Kapitullin II të Kushtetutës, u mor vesh, pa u kufizuar në mënyrë dogmatike vetëm në atë kapitull. Një kufizim i tillë është tërësisht i pamundur për shkak të, siç u tha më herët, asaj që në teorinë dhe në praktikën gjermane njihet si lidhje organizative dhe strukturore e dispozitave kushtetuese, të marra në tërësinë e tyre.<sup>89</sup> Kjo është krejt normale, nëse kihet parasysh teoria për “ADN”-në e secilës kushtetutë, pra teoria për dispozitat dhe për parimet e pandryshueshme që e përshkojnë çdo “qelizë” të tekstit kushtetues dhe vetë shpirtit (frymës) së tij.

Në vijim të ushtrimit të këtij juridiksioni, Gjykata u ndesh, *inter alia*, edhe me vlerësimin e amendamentit 10 (dhjetë), i cili propozonte që shefi aktual i shtetit kosovar të linte detyrën dhe të shkonte në shtëpi, domethënë të shkarkohej nga detyra nëpërmjet një amendamenti kushtetues të kësaj legjislature kosovare. Verdikti profesional i Gjykatës, i cili buron nga silogjizmi (subsumcioni) gjyqësor i propozim-amendamentit 10 (dhjetë) kundrejt tekstit në fuqi të Kushtetutës së Kosovës, tha se asnjë president, në asnjë rast dhe në asnjë rrethanë, nuk mund të mënjanohet nga detyra përveçse duke i ndjekur procedurat kushtetuese të parapara në nenin 91 të Kushtetutës së Kosovës.<sup>90</sup> Amendamenti në fjalë, siç u tha më herët, zvogëlonte

---

88 Rasti i parë i kontrollit abstrakt dhe preventiv (paraparak) i amendamenteve kushtetuese ka qenë pak para këtij që diskutohet këtu: më 15 maj 2012, Gjykata vendosi për kushtetutshmërinë e amendamenteve të propozuara kushtetuese me të cilat konstitucionalizohej fundi i mbikëqyrjes së pavarësisë, ashtu siç e kishte thënë Plani Ahtisari në dispozitat e tij.

89 Cf. fusnotën 48.

90 Neni 91.1 (“Shkarkimi i Presidentit”): “Presidenti i Republikës së Kosovës mund



të drejtat njerëzore nga Kapitulli II i Kushtetutës, jo të drejtat konkrete të presidentes aktuale të Kosovës.<sup>91</sup> Thënë shkurt, propozim-amendamenti 10 (dhjetë) në Kushtetutën e Kosovës cenonte (prekte) seriozisht “ADN”-në e Kushtetutës, pra jo të drejtat konkrete të shefit *ad hominem* të shtetit kosovar, domethënë të drejtat e presidentes Atifete Jahjaga. “Çështja e presidentes Jahjaga” ka ekzistuar shumë më herët para se 11 (njëmbëdhjetë) propozim-amendamentet të sillëshin në Gjykatë për vlerësim. Më konkretisht, ajo çështje ka filluar të ekzistojë që nga data e lidhjes së marrëveshjes politike, më 6 prill 2011. Gjykata nuk ka mundur të merret me implementimin *ad hominem* të dispozitave të asaj marrëveshjeje. Gjykata kushtetuese mbrojnë vetëm parimet dhe dispozitat e konstitucionalizmit bashkëkohor. Në rastin tonë, ato parime dhe dispozita, nëpërmjet Kapitullit II, përshkojnë tërë Kushtetutën e Kosovës, letrën dhe frymën e saj.

Kur Gjykata shikon nëse propozim-amendamentet cenojnë parimet dhe dispozitat e Kapitullit II të Kushtetutës, ajo e bën këtë duke pasur parasysh përmbajtjen e normës kushtetuese që propozohet, krahasuar me normën dhe me parimet kushtetuese ekzistuese që janë në fuqi. Në rastin konkret, ai propozim-amendament nr. 10 (dhjetë) synonte ndryshimin esencial të mandatit të shefit aktual të shtetit kosovar. Kjo nuk mund të ndodhte, vendosi Gjykata, për dy arsye. E para kishte të bënte me vetë natyrën e shefit të shtetit: në nenet 4.3 dhe 83 të Kushtetutës së Kosovës ai përfaqëson unitetin juridiko-kushtetues të popullit kosovar, si brenda ashtu dhe jashtë, dhe garanton funksionimin normal të institucioneve të sistemit. Kjo natyrë e shefit të shtetit nuk guxon të ndryshohet apo të ndërpritet për asnjë moment. Çdo largim i parakohshëm i shefit aktual të shtetit, jashtë procedurave dhe jashtë kushteve të parapara në nenin 91 të Kushtetutës, paraqet cenim të parimeve dhe të dispozitave për unitetin juridiko-kushtetues dhe të atyre që kanë të bëjnë me përfaqësimin e popullit të Kosovës, brenda dhe jashtë saj, si dhe me garantimin e funksionimit stabil të institucioneve të shtetit kosovar.

E dyta, në vijim sa më sipër, synimi për shkarkim nëpërmjet amendamentit, përveç që pengon qytetarët e Kosovës nga të qenit unik në pikëpamje juridiko-kushtetuese, të përfaqësimit të tyre (brenda dhe jashtë vendit), të garantimit të stabilitetit institucional shtetëror, ai, në të njëjtën kohë, cenon parimet dhe dispozitat konkrete të Kapitullit II të Kushtetutës. Ky cenim nuk ka të bëjë me të drejtat dhe me liritë njerëzore *ad hominem*. Synimi për cenim të parimeve dhe të dispozitave, sa më sipër, ka të bëjë me çdo president të

---

të shkarkohet nga Kuvendi nëse ai/ajo është dënuar për kryerjen e krimit të rëndë ose nëse ajo/ai nuk është i/e aftë për të ushtruar përgjegjësitë e këtij posti për shkak të sëmundjes së rëndë ose nëse Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se ajo/ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës”.

Kosovës, sot dhe përgjithmonë. Sikundër mund të vërehet fare lehtë, Gjykata nuk ka mbrojtur *ad hominem* pozitën e presidentes aktuale, znj. Atifete Jahjaga, por formën dhe përmbajtjen e institucionit të kreut të shtetit kosovar, të paraparë me nenet 4.3 dhe 83 të Kushtetutës, kundrejt synimit antikush-tetues të propozim-amendamentit kushtetues nr. 10 (dhjetë). Ky propozim-amendament synonte që, në mënyrë krejt joprofesionale, të bënte agresion ndaj Kapitullit II të Kushtetutës në fuqi të Kosovës, i cili kapitull shërben si pikë themelore referimi me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së çdo propozim-amendamenti kushtetues.

U mor vesh, kjo nuk do të thotë se nuk ekziston një mënyrë kushtetuese për ta ndryshuar mandatin e kreut të shtetit. Në aspektin komparativ, ka pasur raste kur kjo ka ndodhur, pra kur është ndryshuar mandati i shefit të shtetit, ashtu sikundër që ka kushtetuta që e sanksionojnë një gjë të tillë. Rasti i parë ka ndodhur në Francë, në vitin 2000. Atë vit, francezët ndryshuan me amendament kushtetues mandatin e presidentit të atëhershëm francez nga 7 (shtatë) në 5 (pesë) vjet. Por, ky amendament hyri në fuqi dhe u zbatua vetëm për sa i përkiste presidentit tjetër që vinte, jo atij aktual. Kjo do të thotë se nuk u lejua apriori që amendamenti i ri, që ndryshoi mandatin e presidentit aktual francez, të kishte efekt retroaktiv si në rastin kosovar.<sup>92</sup> Nga kushtetutat që parashohin një gjë të tillë, vlen të theksohet Kushtetuta e Koresë së Jugut, e cila përcakton procedurat që duhet ndjekur në rastet kur ndryshohet mandati i kreut të shtetit, duke e bërë të qartë se ato ndryshime mund të vlejnjë vetëm për shefin e ardhëm të shtetit.<sup>93</sup> Është e qartë, pra, se gjyqësia kushtetuese, në asnjë rast, nuk mbron *ad hominem* askënd, por vetëm parimet dhe dispozitat kushtetuese që paraqesin esencën e konstitucionalizmit bashkëkohor.

---

92 Oliver Duhamel, "France's New Five – Year Presidential Term. BROOKINGS, 1 March 2001. Në internet, në këtë ueb-faqe: <http://www.brookings.edu/research/articles/2001/03/france-duhamel> (herën e fundit shikuar në nëntor të vitit 2012).

93 Kushtetuta e Koresë së Jugut, e 17 korrikut 1948, në nenin 128, iniciativa për ndryshim të saj, përcakton: "(2) Amendamentet në Kushtetutë për zgjatje të kohës së mandatit të Presidentit apo për lejimin e rizgjedhjes së tij nuk mund të hyjnë në fuqi për Presidentin në detyrë në kohën e parashtrimit të tyre". Komisioni i Venedikut këtë dispozitë e konsideron si një standard të mirë dhe si masë matëse për vlerësim të kushtetutshmërisë së amende-menteve kushtetuese që prekin mandatet e organeve kryesore të shtetit. Cf. Report on Constitutional Amendment, adopted by the Venice Commission at Its Plenary Session (Venice, 11-12 December 2009), paragrafi 145.

## Përfundim

Ky shkrim ka sqaruar në mënyrë shkencore, nga këndi komparativ kushtetues, rolin dhe pozitën e shefit të shtetit dhe mbrojtjen e tij nga shkarkimi jokushtetues nëpërmjet procesit të amendamentimit të kushtetutës në fuqi.

Në të drejtën kushtetuese komparative, shefit të shtetit i njihen dy role: roli përfaqësues dhe roli garantues. Roli përfaqësues mishërohet në shefin e shtetit si institucion personifikues i unitetit juridiko-kushtetues të popullit dhe i kontinuitetit juridiko-shtetëror. Si garantues, ndërkaq, shefi i shtetit paraqitet garant i funksionimit normal (të rregullt) të institucioneve dhe i stabilitetit të tyre. U mor vesh, këtu gjithnjë bëhet fjalë për një demokraci kushtetuese të tipit parlamentar.

Amendamentimi kushtetues paraqet një proces që ndodh në çdo shoqëri. Shpeshtësia (incidenca) e amendamentimit kushtetues varet nga shumë faktorë, prej gjatësisë së tekstit aktual kushtetues e deri te faktorët e tjerë që ndodhen jashtë tekstit në fjalë. Çështja e shpeshtësisë (incidencës) së ndryshimit të tekstit aktual kushtetues, megjithatë, nuk ka qenë objekt shqyrtimi i këtij shkrimi.<sup>94</sup> Ajo që u shqyrtua këtu ka të bëjë vetëm me një aspekt të procesit të amendamentimit kushtetues. Ai proces, që u shtjellua këtu, njihet si kontroll gjyqësor abstrakt dhe preventiv (paraprak) i propozim-amendamenteve kushtetuese. I njohur nga një numër mjaft i vogël i vendeve, përfshirë këtu Kosovën, ky kontroll nënkupton se vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamentit kushtetues bëhet para hyrjes së tij në fuqi.

Shumica e vendeve njohin vetëm kontrollin represiv të amendamenteve kushtetuese, pra, pasi ato të kenë hyrë në fuqi. E përbashkëta e kontrollit preventiv (paraprak) dhe atij represiv (pas hyrjes në fuqi) konsiston në atë se, në të dy rastet, vlerësimi bëhet duke kontrolluar nëse amendamentet kushtetuese cenojnë (prekin) parimet dhe dispozitat ekzistuese kushtetuese, të cilat nuk mund të amendamentohen. Në rastin e Kosovës, këto parime e dispozita, gjenden kryesisht në Kapitullin II të Kushtetutës, por edhe në parimet e në dispozitat e tjera të saj.

Në vijim të kontrollit abstrakt dhe preventiv (paraprak) të 11 (njëmbëdhjetë) amendamenteve të propozuara, Gjykata shpalli jokushtetues mbi 60 për qind të tyre. Pjesë e tyre ishte edhe amendamenti 10 (dhjetë), i cili kryesisht ishte objekt i këtij shkrimi. Më këtë rast, Gjykata ka bërë të ditur se është

94 Për një analizë komparative shkencore të shkaqeve që çojnë në amendamente të shpeshta kushtetuese Cf. Sanford Levinson (ed.), *Responding to Imperfection. The Theory and Practice of Constitutional Amendment* (Princeton University Press: Princeton, New Jersey, 1995).

jokushtetuese ndërprerja, nëpërmjet amendamentiit kushtetues, e mandatit kushtetues pesëvjeçar të shefit të shtetit kosovar, sot dhe përgjithmonë. Nuk ka rëndësi nëse ndërprerja bëhet nëpërmjet sanksionimit të zgjedhjeve të parakohshme “brenda gjashtë muajsh” apo “pas gjashtë muajsh”. Për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës dhe për drejtësinë kushtetuese bashkëkohore, ndërprerja e mandatit të shefit të shtetit mund të ndodhë vetëm duke respektuar parimet dhe dispozitat kushtetuese në fuqi. Çdo rrugë tjetër, si kjo e synuar me propozim-amendamentin 10 (dhjetë), cenon Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës, vetë natyrën dhe pozitën e shefit të shtetit kosovar, si përfaqësues i unitetit juridiko-kushtetues, brenda dhe jashtë, dhe si garantues i funksionimit normal (të rregullt) të institucioneve shtetërore. Kjo është kështu për çdo shef shteti në demokracitë kushtetuese të tipit parlamentar.

Teoria dhe praktika për shefin e shtetit, si përfaqësues i unitetit juridiko-kushtetues të popullit dhe si garantues i funksionimit normal (të rregullt) të institucioneve të sistemit, ka filluar në Francë pas Revolucionit të vitit 1878, fillimisht e elaboruar nga Benjamin Konstanti. Në fakt, kjo teori u elaborua në një kontekst më të gjerë, në atë që ka të bëjë me natyrën dhe me pozitën e pushtetit konstitutiv të popullit, si sovran i ri që po dilte në skenë pas Revolucionit të vitit 1878. Tërë përpjekja e Benjamin Konstantit ka konsistuar në “juridifikimin” e këtij vullneti të pakontrolluar të popullit, si sovran i ri i sapodalë në skenë. Në kuadër të kësaj përpjekjeje, u krijua sintagma për monarkun si institucion, i cili “*regne et ne gouverne pas*”. Kështu ka besuar një pjesë fare e vogël e ithtarëve të teorisë politike dhe kushtetuese, përfshirë Karl Shmitin. Kjo, u mor vesh, nuk ka qenë e saktë, siç ka vërejtur me të drejtë Hans Kelsen në përgjigjen e tij Karl Shmitit. Pse? Sepse, siç thotë Kelsen, monarku ka qenë pjesë përbërëse e ekzekutivit (qeverisë). Përgjatë tërë shekullit XIX, e deri në Kushtetutën e Vajmarit, teoria dhe praktika provuan të kufizonin sa më shumë autorizimet ekzekutive të monarkëve të kohës. Kushtetuta e Vajmarit ishte përpjekja e fundit që synonte krijimin e një shefi të shtetit që “*regne et ne gouverne pas*”, mirëpo, pa ndonjë sukses të madh, për shkak të autorizimeve që dilnin nga dispozita e nenit 48 të saj. Ky nen nuk mundësonte që presidenti i Rajhut të ishte gardian i kushtetutës, sepse vetë ai paraqiste pushtetin ekzekutiv që rrinte mbi Rajhstagun dhe mbi të gjitha pushtetet e tjera. Shefi vajmarian i shtetit nuk mund të garantonte funksionimin normal (të rregullt) të institucioneve, sepse qëndronte mbi të gjithë. Autorizimet e ligjvënies dhe ato ekzekutive, nga neni 48 dhe nga nenet e tjera të Kushtetutës së Vajmarit, bënë që shefi i shtetit të mos përfaqësonte unitetin juridiko-kushtetues të popullit gjerman, por vetëm interesat momentale të pushtetit ekzekutivo-legjislativ, të cilat i posedonte sipas këtij neni. Me një fjalë, shefi vajmarian i shtetit nuk ka përfaqësuar as unitetin sociologjik dhe politik, siç besonte Karl Shmit, lëre më atë juridiko-kushtetues, siç e

mohonte në vazhdimësi Hans Kelsen. Kjo e fundit ka ndodhur dhe është sanksionuar vetëm me kushtetutat e demokracive kushtetuese të Evropës pas Luftës së Dytë Botërore.

Mbase, duket disi e çuditshme që, në këtë shkrim, sqarojmë se gjykatat nuk mbrojnë pozicionet apo të drejtat e liritë njerëzore *ad hominem*. Ky sqarim këtu, në fakt, bëhet si përgjigje ndaj diskursit të njëanshëm kosovar që mëtoi të kontestojë fuqinë juridike të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në pjesën që i referohet shefit kosovar të shtetit. Vetë kontrolli preventiv (paraprak) i amendamenteve kushtetuese është deri në fund abstrakt. Ai i referohet çdo personi dhe çdo situatë në të ardhmen, kushdo qoftë ai dhe çfarëdo qofshin ato. Një gjykatë serioze dhe profesionale nuk guxon asnjëherë, në rastin e gjykimeve abstrakte të normës, të marrë parasysh argumentet *ad hominem*. Në gjykimet abstrakte të kushtetutshmërisë së normës, qoftë ajo normë ligjore apo kushtetuese, kjo qasje vjen më shumë në shprehje, se sa ajo me rastin e gjykimeve konkrete dhe kundërthënëse.

Prof. dr Enver Hasani

## **APSTRAKTNA I PREVENTIVNA (PRELIMINARNA) KONTROLA USTAVNIH AMANDMANA I ZAŠTITA ŠEFA DRŽAVE OD RAZREŠENJA DUŽNOSTI: SLUČAJ KOSOVA**

*Ovaj rad razjašnjava ulogu i položaj šefa države sa uporedne perspektive, kao i zaštitu ove ustavne institucije od neustavnog razrešenja preko ustavnih amandmana. Početna tačka rada je sprovođenje preventivne apstraktne kontrole jedanaest (11) predloženih ustavnih amandmana od strane Ustavnog suda. Sud je oglasio neustavnim više od šesdeset (60) posto predloga, uključujući i amandman deset (10), koji je glavni predmet izlaganja u ovom radu. Ovom prilikom Ustavni sud je razjasnio da je prevremeni prekid mandata šefa države donošenjem novih ustavnih amandmana neustavan. Ovim radom se naučno u potpunosti dokazuje da ne postoji nijedan ozbiljan sud koji bi uzeo u obzir ad hominem argumente u slučajevima koji se odnose na apstraktnu kontrolu zakona i ustavnih amandmana i koji bi i dalje mogao biti nazivan profesionalnim sudom.*

**Ključne reči:** *ustavna pravda; ustavna uloga šefa države; debata Hansa Kelsena i Karla Shmita; Ustavni sud Kosova.*

### **Uvod**

Polemika koja se je odvijala između dva svetska rata, 30-ih godina prošlog veka, između dva filozofa sa najvišim uticajem na polju prava i politike, Karla Shmita i Hansa Kelsena, bez ikakve sumnje dotiče teorijske i praktične temelje ustavne institucije koja se naziva šef države, njene forme i sadržaja. Ovo važi kako za predsednika republike tako i za monarha. Navedena debata je aktuelna i od važnosti i u današnjim danima i uvek, isto koliko je bila aktuelna i važna i u vremenu u kojem se je odvijala.

U stvari, važnost debate se na Kosovu svakim danom povećava u vreme kada se na svaki način pokušava stvoriti politička debata osporavanja poslednje odluke Ustavnog suda<sup>95</sup>.

„Shmitovci“ i „kelsianci“ kosovskog konteksta se ne ocrtavaju, a još manje se modeliraju, suprotno originalnim autorima navedene polemike, prema ideološkim, partijsko-političkim kriterijumima ili nekoj posebnoj ustavnoj doktrini. Nedostatak političko-ideološke i teorijsko-ustavne kosovske debate o „pitanju predsednika Jahjaga“ nije jedini; slična situacija, manje više, preovladava u javnom kosovskom diskursu kada se govori i o drugim pitanjima. Diskurs kojim se osporava navedena presuda Ustavnog suda se u potpunosti zasniva na neprofesionalnim kriterijumima i bez ikakvog poštovanja osnovnih profesionalnih pravila, koja važe kada se osporava određena odluka

---

95 Presuda u slučajevima KO29/12 i KO48/12, od 20. jula 2012. (ref. br.: AGJ284/12). Ova presuda, od strane onih koji je osporavaju, je neopravdano nazvana „odlukom Ustavnog suda o predsedniku Kosova, gđi Atifete Jahjaga“. Ipak moramo naglasiti da se presuda odnosi na apstraktnu i preventivnu (preliminarnu) kontrolu predloženih ustavnih amandmana na Ustav Republike Kosovo, koje je, saglasno članu 144. stav 1. a u vezi sa članom 113. stav 9. Ustava, predložila jedna četvrtina (1/4) poslanika Skupštine Republike Kosovo od 120 članova. Predsednik Skupštine, prema gore navedenim ustavnim odredbama, je jedini koji ima ustavno ovlašćenje da Ustavnom sudu uputi amandmane koje predlože ustavni subjekti iz člana 144. stava 1. Ustava, u cilju preventivne (preliminarne) kontrole njihove ustavnosti. Druga grupa, odbor za ustavne izmene, je sve vreme je težio da bude na čelu osporavanja pravno-ustavne snage ove presude. Takvo osporavanje je 25. septembra 2012. otišlo toliko daleko da su pokušana osporavanja samih odredaba članova 113. stav 9. i 144. stav 3. Ustava, koji daju mandat Ustavnom sudu da izvrši apstraktnu i preventivnu (preliminarnu) kontrolu ustavnosti svakog ustavnog amandmana predloženog na pravni način: komisija je izjavila da se o amandmanima koje je Sud oglasio neustavnim može glasati u Skupštini, bez obzira na to što je Sud više od 60 (šesdeset) odsto njih proglasio neustavnim. (Cf. Besnik Krasniqi, „Bajrami: Amandman 10 će biti stavljen na glasanje u Skupštini“, dnevni list „Koha ditore“, sreda, 26. septembar 2012., str. 2).

Preventivna (preliminarna) kontrola ustavnosti ustavnih amandmana se vrši pre nego se o njima glasa u Skupštini. Sud in abstractio ocenjuje da li predloženi amandmani umanjuju prava i slobode iz Poglavlja II Ustava. Skupština Kosova ne sme glasati o amandmanima koje je Sud oglasio neustavnim. Ovo se izričito propisuje u čl. 113. stav 9. i 144. stav 3. Ustava Kosova. O komparativnim praksama apstraktno i preventivne (preliminarne) ustavne kontrole ustavnih amandmana će biti više govoreno u daljem tekstu.

Kao što će se primetiti na samom početku, primarni cilj predlagača ovih amandmana je bila „konstitucionalizacija“ (davanje ustavne moći i legitimiteta) određenog političkog sporazuma koji je sklopljen u aprilu 2011. među glavnim akterima kosovske politike, sporazuma koji je izričito sankcionisao razrešenje šefa države Kosovo, sadašnjeg predsednika, gđe Atifete Jahjaga, putem ustavnog amandmana. Osim pomenutog, navedenim amandmanima je, u velikoj većini, pokušana konstitucionalizacija konjunktura momentalnog političkog interesa, koje su povezane sa ulogom i položajem sistema pravosuđa i sa položajem i prirodom nadležnosti vršioca dužnosti predsednika Kosova. Svi ovi napori su preduzeti imajući u vidu ponašanje prethodnog vršioca dužnosti predsednika, tokom perioda koji je prethodio izboru gđe Atifete Jahjaga za predsednika Kosova (septembar 2010. – april 2011.).

nepolitičkog i nezavisnog organa, kao što je Ustavni sud. U suštini, kao što se može primetiti, više se govori o diskursu odbijanja, koji *en generale* osporava rad Suda i koji za glavni cilj ima pokretanje debate *pro et contra* navedene odluke na opštekosovskom nivou. Međutim, ovaj cilj nije ni približno postignut zbog slabe moći argumenata na koje se oslanja. Kao glavni protagonisti ovog diskursa, sa jedne strane, su visoki zvaničnici glavne opozicione stranke na Kosovu, LDK (Demokratski savez Kosova), a sa druge, glavni članovi Odbora za ustavne promene, u kojem većinom dominiraju članovi stranke na vlasti, PDK (Demokratske partije Kosova).<sup>96</sup>

Kao što je poznato iz istorije ustavne teorije do debate Shmit – Kelsen je došlo kako bi se ustanovilo ko je, ili ko treba da bude garant Ustava. Tokom te početne debate bačeno je svetlo i na ulogu i važnost šefa države (većinom) u parlamentarnim demokratijama sa (većinom) republikanskim uređenjem. Veliki deo te debate se odnosio na šefa države, kao predstavnika jedinstva naroda, sa konceptualnim neslaganjem u odnosu na to da li je to jedinstvo socio-političko ili je samo isključive pravno-ustavne prirode. Prvi stav je izgradio i do kraja ga podržavao Karl Shmit, a drugi – Hans Kelsen. Ne postoji nikakva sumnja da je svetlost koju su ova dva autora usmerila, služila kao putokaz za teoriju i savremenu državnu praksu koja se bavi položajem i ulogom šefa države u ustavnim parlamentarnim demokratijama. U njihovim diskusijama o ulozi i ustavnom položaju šefa države, oni su, u suštini, pokrili pitanja koja predstavljaju same temelje ustavne demokratije i njene glavne činioce, kao što su: podela vlasti i vladavina prava, poštovanje ljudskih i manjinskih prava i demokratija<sup>97</sup>. Ovi aspekti navedene debate se takođe prikazuju tokom naših obrazlaganja o ovoj temi.

---

96 Ovaj odbor sam po sebi nije ustavan jer su ovlašćene strane za predlaganje izmena i amandmana samo Vlada, predsednik ili jedna četvrtina (1/4) poslanika Skupštine (član 144. stav 1. Ustava). Samo ovi subjekti, niko drugi, mogu predložiti amandmane i izmene Ustava.

Cilj ove komisije kako bi se pokazala kao stranka pred Sudom je prouzrokovao probleme proceduralne prirode i konfuziju. U odredbi člana 113. stav 9. Ustava, između ostalog, stoji: „Predsednik Skupštine Kosova mora da podnese predloženi (Ustavnom sudu – naša primedba) Ustavni amandman pre usvajanja istog na Skupštini, kako bi se osiguralo da predloženi amandman ne umanjuje prava i slobode garantovane poglavljem II ovog Ustava“. Dakle, stranka pred Sudom može biti samo predsednik Skupštine, per constitutionem, dok predlagači izmena i amandmana, prema članu 144. stav 1. mogu biti samo Vlada, predsednik ili jedna četvrtina (1/4) skupštinskih poslanika. Kao što je rečeno, ovaj odbor je osnovan ad hoc političkim sporazumom tri glavne političke snage: PDK (Demokratska partija Kosova), LDK (Demokratski savez Kosova) i AKR (Alijansa za novo Kosovo). Predsedavajući ovog odbora je iz stranke na vlasti, PDK, dok ostale stranke učestvuju prema političkoj snazi koju imaju.

97 O dubljem razmatranju glavnih tačaka ustavne debate K. Shmit – H. Kelsen, cf. Michael Stollies, *A History of Public Law in Germany: 1914-1945* (Oxford University Press: Oxford, 2004), posebno poglavlje 3 („Revolution, Weimar Constitution, and Versailles“) i poglavlje 5 („Quarrel Over Methods and the Crisis of the State“).



Koncept šefa države, kao predstavnika socio-političkog jedinstva kod Karla Shmita, je uveliko strukturiran i okončava se u osobi Firera, koji se nalazi na vrhu državne piramide kao otelotvorenje takvog jedinstva. Kod Hansa Kelsena, koncept je takođe uveliko strukturiran, međutim na drugačiji način i u drugačijem, u potpunosti suprotnom smeru, u odnosu na K. Shmita. Šef države kod H. Kelsena, predstavlja otelotvorenje pravno-ustavnog jedinstva naroda, dok se na vrhu državne piramide nalazi osnovna norma („*grund-norm*“), koju šef države treba da oživotvori zajedno sa drugim ustavnim institucijama. Dok je prva teorija u suštini diktatorska, druga predstavlja njenu suprotnost.

Protokom vremena druga teorija je postala sama srž onoga što je sada poznato kao teorija i praksa za ustavnu demokratiju. Tačnije, druga teorija, u odnosu na prvu, koja je postavila temelje iracionalnog razmišljanja nacističke diktature, je služila kao osnova za teoriju i praksu modernog konstitucionalizma koji se uveliko razvio nakon II Svetskog Rata.

Kao što je navedeno, u slučaju Kosova se, u suštini, suočavamo sa nemogućnošću održavanja i pokretanja ozbiljne političke i dobro argumentovane debate u naučnim i intelektualnim pojmovima. Umesto toga, nakon navedene odluke Suda je došlo do osporavajućeg diskursa, na prvi pogled sporadičnog, u kojem se kao glavni protagonisti prikazuju visoki zvaničnici LDK-a, kao najveće opozicione stranke, kao i članovi ustavnog odbora. Sa druge strane, na ojačan i na svaki način je pokušavano da se Ustavni sud prikaže kao deo ovog diskursa. Sud, razume se, ne može da prihvati takav „poziv“ i zbog činjenice da je u presudi od više od četrdeset stranica istrošio svoj celokupni teorijsko-ustavni stručni i praktični arsenal, u cilju zaštite vrednosti i načela zapadnog konstitucionalizma, koja su izražena u svakoj odredbi Ustava Kosova.

Pitanje o kojem se diskutuje u ovom radu, pokrenuto je nakon apstraktne i preventivne (preliminarne) kontrole ustavnosti 11 (jedanaest) amandmana koje je predložila grupa poslanika Skupštine Kosova. Sud vrši ovu nadležnost *per constitutionem*, svaki put kada postoje predlozi za izmenu Ustava, shodno članu 144. Ustava. Ovaj proces izmene je bio deo ranijeg političkog sporazuma glavnih političkih snaga. Potreba za izmenom se međutim primetila kada je u veoma kratkom vremenskom periodu (septembar 2010. – april 2011.) sud „oborio“ dva kosovska predsednika, prateći zaštitu načela, vrednosti i ustavnih normi koje se odnose na ulogu, položaj i prirodu institucije predsednika Republike<sup>98</sup>. Ovo znači da se, ne razumevajući osnovu događaja i dešavanja koja se nadovezuju na dve presude o dva bivša predsednika Kosova, ne može se razumeti suština odluke o kojoj se diskutuje ovde i koja se odnosi na apstraktnu i preventivnu (preliminarnu) kontrolu 11 (jedanaest)

predloženih ustavnih amandmana na Ustav Republike Kosovo. Jedan deo ovih predloženih amandmana se odnosio na način i vreme izbora budućeg predsednika Kosova. Upravo ovaj deo, odnosno predlog amandmana 10 (deset), koji se odnosio na proglašavanje prvih predsedničkih izbora na Kosovu, dramatisovan je u javnosti, ostavljajući u senci druge, veoma važne aspekte presude. Stvoren je diskurs, na prvi pogled u potpunosti spontan, ali u suštini u potpunosti planiran i maliciozan, koji se otvoreno oslanja na legitimnost ustavne teorije i prakse o socio-političkom jedinstvu naroda i dominaciji većine nad drugima. Kao takav, ovaj sporni diskurs se prožima kroz sve aspekte ustavne demokratije i ne ograničava se samo na važnost, ulogu i položaj šefa države Kosovo.

Presuda Ustavnog suda, kojom se proglašava neustavnim 60 (šesdeset) odsto 11 (jedanaest) predloženih amandmana, je predmet razmatranja u prvom delu ovog rada. Ovaj deo prati drugi deo, čiji je naslov na francuskom jeziku, jer je kao takav korišćen prvi put od strane Benjamina Konstana i drugih autora iz XIX v. Dakle, ovim konceptom „*il regne et ne gouverne pas*“ („Šef države je poglavar, ali ne upravlja“) je želeo razjasniti da takozvana *pouvoir neutre et intermediaires* („Neutralna i posrednička ovlašćenja“) šefa države u ustavnim parlamentarnim demokratijama, istorijski, ne postoje kako bi se stvorila druga vlast u odnosu na izvršnu, zakonodavnu i sudsku. Nasuprot tome, ta ovlašćenja služe kako bi se omogućilo trećoj strani, šefu države, da uravnoteži druge vlasti, garantujući mirno i normalno funkcionisanje ustavnih institucija<sup>99</sup>. Ova ovlašćenja određuju sadržaj sintagme na francuskom jeziku „*il regne et ne gouverne pas*“. Ona, u suštini, predstavljaju samu srž položaja, uloge i važnosti koju šef države ima u sistemu upravljanja koji se naziva ustavna demokratija.

Treći deo se prirodno nadovezuje i dotiče se srži aktuelnog diskursa kojim se osporava presuda Suda o 11 (jedanaest) predloženih ustavnih amandmana. U našem obrazlaganju ovde, kao što je i Sud učinio, ne bavimo se i ne govorimo *ad hominem* o sadašnjem šefu države Kosovo. Naš rad u potpunosti teži da bude akademski i stručan i kao primarni cilj ima odbranu institucije šefa države, u današnjem kosovskom kontekstu i u svetlu uvek aktuelne i

99 Ova uloga šefa države postoji i sankcionisana je u svim evropskim zemljama, izuzev Francuske, koja ima polupredsednički sistem, u kojoj šef države ima veliko učešće u izvršnoj vlasti zemlje. Kosovo nije izuzetak u ovom smislu. Odredbe čl. 4. (stav 3.) i 83. veoma jasno iznose navedeno:

Član 4. stav 3. (Oblik vladanja i podela vlasti): „Predsednik Republike Kosovo predstavlja jedinstvo naroda. Predsednik Republike Kosovo je legitimni predstavnik unutar i van zemlje, koji garantuje demokratsko funkcionisanje institucija Republike Kosovo, u saglasnosti sa ovim Ustavom“.

Član 83. (Položaj predsednika): „Predsednik predstavlja vrhovnu vlast države i jedinstvo građana Republike Kosovo“.

naučne debate Shmit – Kelsen. Ova izneta odbrana važi za sve situacije i sva vremena u kojima se može naći određeni šef države, pod rizikom neustavnog razrešenja putem izmene teksta postojećeg Ustava.

Zajednička misija ustavne pravde i teorije se sastoji od zaštite načela i vrednosti ideologije modernog zapadnog konstitucionalizma. Svaka argumentacija *ad hominem* određene ustavne institucije je strana za moderni konstitucionalizam i ustavnu teoriju, kao što se može primetiti u četvrtom, poslednjem delu ovog rada.

Naši zaključci poštuju duh obrazlaganja tokom ovog teksta i tečno odražavaju zaključke svakog od četiri dela ovog rada.

## I. Istorijat jedne odluke, njena forma i sadržaj

Gore navedena odluka, koja je predmet analize u ovom delu, ima formu presude. Njoj je prethodio određeni politički proces, do kojeg je došlo nakon odluke Ustavnog suda od 30. marta 2011. kojom je izbor g. Behgjeta Pacollija za predsednika Kosova u Skupštini Republike oglašen neustavnim<sup>100</sup>. Sud nije dao retroaktivnu snagu odluci u „slučaju Pacolli“ priznajući time sva dela i radnje koje je g. Pacolli obavio u svojstvu bivšeg predsednika Kosova. Ovim pristupom Sud je potvrdio dominantnu savremenu ustavnu teoriju i praksu, koja šefu države priznaje pravo pravno-ustavnog identifikovanja sa državom, kako unutar tako i van zemlje. Nema nikakve važnosti ko vrši tu funkciju *ad hominem*: ozbiljna država si ne sme dozvoliti da ni na jedan momenat prekine svoj institucionalni život, život koji se, između ostalog, oživotvorava i personifikuje u ličnosti šefa države<sup>101</sup>. Ovo znači da šef države

100 Slučaj KO29/11. Sabri Hamiti i drugi poslanici: Ocena ustavnosti odluke Skupštine Republike Kosovo, br. 04-V-04, u vezi sa izborom predsednika Republike Kosovo, presuda od 22. februara 2011. god.

101 Kod Hansa Kelsena ovo personifikovanje se nadovezuje sa kategorijom atribucije (pripisivanja). Prema njemu, svaki akt koji se može atribuisati (pripisati) šefu države je državni akt. Isto važi i za akte nosilaca drugih javnih ustavnih ovlašćenja. Ova teorija je razrada koju je pokrenuo poznati nemački pravnik Georg Jelinek, što potvrđuje i sam Hans Kelsen. Georg Jelinek je prvi govorio o pravnom kontinuitetu države, koji se realizuje delovanjem drugih organa. Pre vremena Napoleona, odnosno u vreme od Vestfalskog mira (1648.) do Francuske revolucije 1878, debate o državnom subjektivitetu su bile usredsređene na pravno-međunarodni subjektivitet države. Tek nakon Francuske revolucije i kasnije, je pokrenuta debata o pravno-ustavnom subjektivitetu države i njegovim posledicama na unutrašnji ustavni poredak. Cf. Clemens Jabloner, Hans Kelsen: Introduction. U: Arthur J. Jacobson I Bernhard Schlink (eds.), Wiemar. A Jurisprudence of Crisis (University of California Press: Berkeley I Los Angeles, 2000) str. 67-76; Hans Kelsen, „Legal Formalism and the Pure Theory of Law“. u Arthur J. Jacobson I Bernhard Schlink (eds.), Wiemar. A Jurisprudence of Crisis, str. 77-84; Hans Kelsen, General Theory of Law and State (The Lawbook Exchange, LTD.: Clark, New Jersey, 2009), str. 181-207; Janne Elisabeth Nijman, The Concept of International Legal Per-

preživljava socio-političke promene koje se dešavaju u državi jer predstavlja otelotvorenje same suštine državno-pravnog kontinuiteta.

Teorija preživljavanja promena od strane šefa države je poznata i razrađena od strane Benjamina Konstana, u njegovim razmatranjima i razmatranjima drugih autora u XIX v. u kontekstu ustavnih monarhija tog vremena. Ta razrađivanja su se odnosila na razjašnjavanje uloge i važnosti monarha, kao šefa države u evropskim monarhijama tokom i nakon Napoleonovog vremena<sup>102</sup>. Ovaj aspekt prikazivanja šefa države u državnom i pravnom kontinuitetu je sankcionisao i obradio Sud u presudi u slučaju bivšeg predsednika Behgjeta Pacollija, priznajući kao važeći i sa ustavnom snagom i nadležnošću svaki akt i svako delo koje je on preduzeo. Istom presudom Sud je vratio predsednika Skupštine na mesto vršioca dužnosti šefa kosovske države, ne ostavljajući time ni na jedan momenat ikakav pravno-ustavni vakuum u funkcionisanju institucije predsednika Kosova<sup>103</sup>. Nakon navedene presude u „slučaju Pacolli“ otvoren je put za izbor novog šefa države, imajući uvek u vidu potpuno poštovanje ustavnih odredaba o izboru nosioca navedene institucije.

Konstatacija Suda, kojom je oglašena neustavnom odluka Skupštine o izboru g. Pacollija za predsednika Kosova, je imala u vidu tri vrste ustavnih posledica: prvo, on je bio predsednik, dok se njegova dela i akti, koje je vršio tokom duže od jednog meseca, atribuišu (pripisuju) njemu i samo njemu; drugo, njegov izbor je bio neustavan i, sledstveno tome, prilikom izbora drugog šefa kosovske države treba poštovati Ustav do kraja; i treće, vraćanjem predsednika Skupštine na položaj vršioca dužnosti šefa kosovske države je jasno pokazano da Kosovo niti jednog momenta nije živelo bez svog poglavara države.

Nekoliko dana nakon presude Ustavnog suda, kojom se porekla ustavnost odluke Skupštine o izboru g. Behgjeta Pacollija za predsednika Kosova, glavne političke snage u zemlji su postigle politički sporazum, čiji je primarni cilj bilo prevazilaženje stvorene političke krize. Ovaj sporazum je postignut 6. aprila 2011. i potpisan od strane premijera Kosova, g. Hashima Tačija, u ime PDK, prof. Ise Mustafe, u ime LDK, najveće opozicione partije, i bivšeg

---

sonality: An Inquiry Into the History and Theory of International Law (T.M.C. Asser Press: The Hague, 2004), posebno poglavlje 2 („Historical Introduction: Leibniz and the Emergence of the Concept of ILP“) i poglavlje 3 („Demystifying the ILP: Brierly, Kelsen and Scelle“).

102 Cf. Biancamaria Fontana (ed), Benjamin Constant: Political Writings (Cambridge University Press: Cambridge, 2010) str. 171-328.

103 Behgjet Pacolli je izabran za predsednika Kosova 22. februara 2011. i obavljao je tu funkciju do 30. marta 2011, kada je Ustavni sud ustanovio da je došlo do kršenja Ustava prilikom njegovog izbora i sledstveno tome je poništio, bez retroaktivnog dejstva, odluku Skupštine, br. 04-V-04, od 22. februara 2011, u vezi sa izborom predsednika Republike Kosovo.

predsednika Kosova, g. Behgjeta Pacollija, u ime AKR, kao partije koalicije na vlasti. Ovim sporazumom, strane potpisnice, u ime obaveznosti postavljanja interesa zemlje iznad svojih interesa, su se dogovorile kao što sledi:

- da predlože gđu Atifete Jahjaga kao zajedničkog kandidata za predsednika Republike Kosovo;
- da se počne sa izmenama Ustava i Zakona o opštim izborima, kako bi one odražavale novi koncept direktnih izbora za predsednika Republike, uz sve izmene u položaju i ulozi predsednika Republike, koje mogu proisteći iz primene načina izbora šefa države;
- da prvi izbori za predsednika Republike budu organizovani ne kasnije od šest meseci od dana kada stupe na snagu neophodne ustavne i zakonske izmene; i konačno,
- da opšti izbori, prema izmenjenom Zakonu o opštim izborima i odgovarajućim amandmanima, budu organizovani ne kasnije od 18 meseci od stupanja na snagu ovih ustavnih i zakonskih amandmana.

Sutradan, 7. aprila 2011, Skupština Kosova je usvojila rezoluciju kojom je potvrđen postignuti sporazum<sup>104</sup>. Tom rezolucijom Skupštine politički sporazum je u potpunosti potvrđen. Štaviše, to je učinjeno parafrazirajući u potpunosti celokupni tekst sporazuma. Ipak, moramo reći da postoji suštinska razlika među njima. Ta razlika se sadrži u činjenici da u poslednjem pasusu rezolucije stoji da se podrška političkog sporazuma vrši u potpunosti na osnovu Ustava Republike Kosovo.

Ovo je bio razvoj događaja i sam politički kontekst kada je Skupština izglasala gđu Atifete Jahjaga za predsednika Kosova 7. aprila 2011. Ona je izabrana u prvom krugu<sup>105</sup>. Nedugo nakon ovoga, Skupština je osnovala dva odbora koji su bili predviđeni političkim sporazumom, i to: Odbor za ustavne izmene i Odbor za odgovarajuću izmenu Zakona o opštim izborima na Kosovu<sup>106</sup>. Predsednik Skupštine, dr Jakup Krasniqi, je istog dana skrenuo pažnju na neustavnost odbora, ukazujući da su oni bili isključivo političke prirode. Dr Jakup Krasniqi je otišao i korak dalje, kada je rekao da se njihovim osnivanjem u stvari krši Ustav Kosova. Međutim, ovu njegovu reakciju nisu prihvatili

---

104 Rezolucija Skupštine Kosova br. 04-R-02 od 7. aprila 2011, kojom je potvrđen politički sporazum postignut 6. aprila 2011. Rezolucija je usvojena sa 75 glasova za, 2 uzdržana i 1 glasom protiv.

105 Odluka Skupštine Republike Kosovo, br. 04-V-11, od 7. aprila 2011, o izboru predsednika Republike Kosovo.

106 Odluka Skupštine Republike Kosovo br. 04-V-12, od 22. aprila 2011, o osnivanju Odbora za izmenu Ustava Republike Kosovo, i odluka Skupštine Republike Kosovo. 04-V-13, od 22. aprila 2011. o osnivanju Odbora za izmenu Zakona o opštim izborima u Republici Kosovo.

kosovski poslanici koji su glasali za osnivanje oba navedena odbora<sup>107</sup>.

273 Article Five of the United States Constitution describes the process whereby the Constitution may be altered. Altering the Constitution consists of proposing an amendment or amendments and subsequent ratification. Once ratified, amendment or amendments become a valid part of the Constitution, provided that no state “shall be deprived of its equal suffrage in the senate,” without its consent. In a similar fashion, the Constitution of Norway of 184 speaks of the ban on any amendment that runs against the principles and the very spirit of the original text of the Constitution. Cf. more on these issues in Kemal Gozler, *Judicial Review of Constitutional Amendments. A comparative Perspective*, pp. 10-12; 28-34; 78-80; Lechh Garlicki and Zofia A. Garlicka, “Review of Constitutionality of Constitutional Amendments ( An Imperfect Response to Imperfections). *Journal of Constitutional Law/Review De Droit Constitutionnel* Vol. 1 Issue 1 (Year 2012) pp. 205 footnote No. fusn. 46.



not be amended represent the crux of the constitutional identity of a given country, a kind of “DNA” of a given country. Principles, norms and values that can under no circumstances be changed usually refer to republican form of government, relationship among central and local authorities, constitutional democracy, rule of law and human rights, etc. Such is the case, for example, with Germany, France, Turkey, Norway, Portugal, Rumania, Ukraine, Azerbaijan, South Africa and many other countries. Here we have in mind countries that cultivate a constitutional democracy modeled after Western-type constitutionalism because there are countries, such as Maroko for example, in constitutional provisions that cannot be amended have to do with the preservation of the primary role of Islam in these societies<sup>274</sup>.

Third, the fact that there exist these kinds of constitutional principles and provisions means that they enjoy judicial protection and enforcement so that every future amendment that runs counter to them is to be considered by the courts as unconstitutional. This does not mean, however, that constitutional review of constitutional amendments exists only in those countries that have these kinds of principles and provisions that cannot be subject to constitutional amendment. The opposite is true as well. There are cases in when the original constitutional text contained principles and provisions that could not be amended but in practice this fact did not play in role and no review of constitutional amendments ever took place. Such is the case, for example, with the Constitution of Norway of 1814. In a similar fashion, there are cases where no principle or provision exists that cannot be amended but still in practice the courts in these countries have developed an impressive case law, such is the case with India.

Lastly, the review of constitutional amendments is an abstract-type of control of the constitutionality, meaning that it does not refer to a concrete case and controversy but to all cases, situations and persons in the future to come. In a majority of the states of today abstract review of constitutional norms is *a posteriori*, meaning that it takes lace only after the norm contained in the constitutional amendment has entered into force. Cases in which review of constitutional norms takes place *a priori* are rare indeed. Among them in Europe belongs Kosovo as well, while outside Europe there are Chile, South Africa, Azerbaijan, etc.

The above elaboration has found its sublime expression in the case of Kosovo within the context of the application of Articles 113.9 and 144.1 of the Constitution. They require from the speaker of the Assembly of Kosovo, as

---

274 Not only Maroco but many other Islamic states follow the same model of the unamendable constitutional provisions referring mainly to the primary role of Islam in their societies. Cf. Amina El Messaoudi, “Il Modello di Giustizia Costituzionale in Marocco”. In Luca Mezzeti, Sistemi e Modeli di Giustizia Costituzionale. Tomo II CEDAM: Padova, 2011).

noted, to refer to the Court for a review every constitutional amendments to the Constitution that might be put foreword. This is a mandatory requirement which cannot be evaded. The contestation of the legitimacy of the current President Mrs. Jahjaga of Kosovo is not based on the constitutional – legal criteria but others. It is based on a belief “that she does not represent the political will of the Kosovo people”. For this reason, those contesting her legitimacy as the head of state believe that the Constitutional Court has made a grave mistake when it said that “people of Kosovo expect that their President represents them for five coming years”.

This article and its author elaborate on only the non-political side of the “issue of President Jahjaga”, meaning the elaboration of those aspects of a comparative discourse having to do with abstract preventive review of the constitutionality of constitutional amendments. This review is exercised by the Court based on Articles 113.9 and 114.1 of the Constitution. Other segments of the controversy having to do with the daily politics in Kosovo challenging the legitimacy of the head of state based on the arguments *ad hominem* are outside the scope of this paper. Daily political contestation in no way can harm the essence of the theory and practice on “unconstitutional constitutional amendments” and their application in the concrete case of the current President Atifete Jahjaga of Kosovo.

In the case of Kosovo this theory and practice rely on one sentence that says that the amendments to the Constitution should be sent to the Court for review in order to see whether they diminish rights and freedoms from Chapter II of the Constitution. This practically means that Chapter II in the case of Kosovo represents a “DNA” of Its Constitution. The review that takes place in these cases is abstract and preventive one taking into account professional criteria only without any regard for other aspects of the referral. This means that the Court in the concrete case under discussion could not have taken into account the form and content of the political agreement providing for the election of the president of Kosovo and the change in the position and the role of future head of state in Kosovo and its manner of election. These aspects were subject of discussion among the politicians of Kosovo, not of the Constitutional Court. The Court ruled on different mannered and by different means and procedures. This is very obvious from the content of the abstract and preventive control of eleven (11) amendments proposed by a group of 30 deputies of the Assembly of Kosovo during March – May 2012.

The Court has never dealt with the political aspects of the “issue of President Jahjaga”. At stake was an abstract preventive review of the eleven (11) amendments proposed in the fourth year of the life of the Constitution of Kosovo. The Judgment rendered on that occasion is the second of its

kind.<sup>275</sup> It is abstract and has nothing to do with any concrete case and controversy. Such an approach of the Court derives from the provisions of the Constitution regulating the abstract and preventive review of constitutional amendments to the Constitution. These provisions give a mandate to the Court to review the constitutionality of any proposed amendment in order to see whether they diminish the rights and freedoms from Chapter II of the constitution. However, the Court does not confine itself dogmatically to this chapter only. Such a confinement is impossible due to, as elaborated in the German doctrine supporting the “entrenchment provisions”, organic and structural connection of the constitutional provisions taken in their entirety<sup>276</sup>.

While exercising this type of jurisdiction, the Court met with the review of amendment ten (10) which proposed that the head of state of Kosovo should leave its office and go home once the amendments entered into force. This was a dismissal through constitutional amendment, outside the procedure foreseen in Article 91 of the Constitution of Kosovo. The Court ruled that the dismissal of the head of state could be done only through following the form and procedure of article 91, meaning that constitutional amendment cannot serve that function<sup>277</sup>. Amendment ten (10) as drafted, according to the Court, violated rights and freedoms from Chapter II of the Constitution of Kosovo, not concrete rights and freedoms of the current President of Kosovo<sup>278</sup>. Put differently, this proposed amendment violated the “DNA” of the Constitution, not concrete individual rights of the concrete head of state of Kosovo, that is, rights and freedoms *ad hominem* of the current President Jahjaga of Kosovo. The “issue of President Jahjaga” existed long before the eleven (11) proposed amendments came for review before the Court, that is, it had been there since the conclusion of the agreement of 6 April 2011. The Court could not have dealt with the implementation of the *ad hominem* provisions of that agreement. The constitutional courts protect principles and provisions of contemporary constitutionalism only. In our case they are found in Chapter II of the Constitution of Kosovo.

When the Court evaluates whether proposed amendments diminish the

---

275 First case of abstract and preventive review of the constitutionality of amendments in Kosovo happened on 15 May 2012. In that day the Court decided on the constitutionality of the proposed amendments constitutionalizing the end of supervised independence of Kosovo based on the Ahtisari Plan and its provisions.

276 Cf. footnotes 18 and 47 in connection with footnote no. 85 and the comments accompanying them.

277 Article 91.1. (Dismissal of the President): “ The President of the Republic of Kosovo may be dismissed by the Assembly if he/she has been convicted of a serious crime or if she/he is unable to exercise the responsibilities of office due tot serious illness or if the Constitutional Court has determined that he/she has committed a serious violation of the Constitution”.

278 Cf. Footnotes 33 – 36.

rights and freedoms from Chapter II of the Constitution, it does so having in mind the material substance of the proposed constitutional norms compared to the principles and norms existing already in the text of the Constitution in force. In the concrete case, amendment ten (10) as proposed aimed at a substantial change in the mandate of the current Kosovar head of state. This, according to the Court could not happen for two reasons. The first reason had to do with the very nature of the head of state because Articles 4.3 and 83 of the Constitution clearly foresee that president of Kosovo represents the constitutional-legal unity of the Kosovars, inside and outside Kosovo, and guarantees the normal functioning of the institutions of the system. This nature of the state cannot be changed or terminated at no time. Any removal of the head of state outside the procedures and terms foreseen in Article 91 of the Constitution is a violation of the principles and provisions having to do with the constitutional-legal unity of the Kosovar people, its representation outside and within the country, as well as with the provisions and norms guaranteeing the normal functioning of the institutions of the state of Kosovo.

Second, in line with the above, the dismissal of the Kosovar head of state through constitutional amendments would without any doubt violate principles and norms of Chapter II of the Constitution. This violation has nothing to do with human rights and freedoms *ad hominem*. It has to do with violations of the rights and freedoms of all presidents at any times. It is so obvious that the Court did not protect the position *ad hominem* of the incumbent president Atifete Jahjaga of Kosovo but the form and content of the institution of the head of state as sanctioned in articles 4.3 and 83 of the Constitution against the attack coming from the proposed amendment ten (10). This amendment tried to transgress the prohibitions of Chapter II of the Constitution, which serve as a reference point in the process of evaluation of the constitutionality of draft-amendments to the Constitution of Kosovo.

It goes without saying that this in no way implies that there is no constitutional path for a dismissal of the head of state in Kosovo. In comparative constitutional law there have been cases in which the mandate of the head of state was changed but that change did not enter into force for the incumbent head of state, as well as cases of constitutions that foresee the same solution. This case happened in France in 2000. Then French citizens enacted an amendment changing the Constitution to the effect that the mandate of the head of state was to be from seven (7) to five (5) years. This amendment, nevertheless, would enter into force only for the next terms of office of the French president. This means that it was not allowed for the new amendment to change the mandate of the then incumbent president of France.<sup>279</sup>

---

279 Oliver Duhamel, "France's New Five – Year Presidential Term. BROOKINGS 1 March 2001. Nw internet nw kwtw veb faqe: <http://www.brookings.edu/research/articles/2001/03/>

As for constitutions, it is worth noting the case of South Korea, which foresees that every change in the mandate of the head of state shall take effect only for a future head of state not for the incumbent<sup>280</sup>. It is clear, therefore, that constitutional justice never protects *ad hominem* anyone. All it does is the protection of the principles and norms personifying the essence of the contemporary constitutionalism.

## Conclusion

This paper has clarified through scholarly terms the role and position of the head of state from a comparative perspective, as well as the protection of that institution from extraconstitutional dismissal via constitutional amendments.

In comparative constitutional law, the head of state is vested with two roles. One is representing the state both within and outside, while the other is to guarantee normal functioning of key state organs. The role of representation is enshrined in the head of state being seen as embodiment of the constitutional-legal unity of the people and of the state continuity as such. The other role, that is, the role of the guarantor, is seen in that it guarantees the normal function and stability of the key state organs. In both situations, one has in mind the cases of parliamentary constitutional democracies.

A constitutional amendment represents a process that happens in every society. The incidence of constitutional amendment is a matter depending on several factors starting from the longevity of the original constitutional text to other factors existing outside the text itself. The incidence of constitutional change, nevertheless, has not been object of discussion in this paper<sup>281</sup>. What is discussed here has to do with one aspect of the amending process only. That aspect is known as abstract and preventive judicial review of the constitutionality of the constitutional amendments. Known by a very limited

---

[france-duhamel](#) (herwn e fundit shikuar nw nwntor 2012).

280 The Constitution of South Korea of 17 July 1948, in its Article 128.2 of the Chapter X (Amendments to the Constitution – Initiative), provides as follows: "(2) Amendments to the Constitution for the extension of the term of office of the President or for a change allowing for the re-election of the President are not effective for the President in office at the time of the proposal for such amendments to the Constitution. Venice Commission treats this provision as a good standard to recon with and as a reference point for others when reviewing the constitutionality of the amendments touching upon the mandates of key constitutional organs of a state. Cf. Report on Constitutional Amendment, Adopted by The Venice Commission at Its Plenary Session (Venice, 11-12 December 2009), Para. 145.

281 For an excellent analysis of the causes leading to frequent constitutional amendments, Cf. Sanford Levinson (ed.), *Responding to Imperfection. The Theory and Practice of Constitutional Amendment* (Princeton University Press: Princeton, New Jersey, 1995).

number of the countries of the world, including Kosovo, this review consists in the evaluation of the constitutionality of constitutional amendments before they enter into force.

In most countries of the world there is known only the repressive review of constitutionality, meaning that the evaluation of the constitutionality of amendments is undertaken after they enter into force. A common feature of both situations is that the review tries to see whether constitutional amendments violate unamendable principles and norms as enshrined in the existing text of the constitution in force. In the case of Kosovo these principles and norms are contained in Chapter II of the Constitution but also in its other parts.

In line with the abstract preventive control of the eleven (11) proposed constitutional amendments, the Court declared unconstitutional over sixty (60) per cent of them, including amendment ten (10). The analysis of this amendment has been a major object of this paper. In this case the Court made it clear that it is unconstitutional to cause the early termination of the mandate of the head of state in cases undertaken through the enactment of a new constitutional amendment. This was the intent of the drafter of the constitutional amendment ten (10). It makes no difference whether the aim of the drafter was for the elections to be held within or after six months following the enactment of the amendment ten (10). For the Court, the important thing was to stress to the drafter and the public at large that the five (5) year mandate of the president of the Republic can be terminated prematurely only through the terms and procedure foreseen in Article 91 of the Constitution. Any other path chosen, such as this via proposed amendment ten (10), violates Chapter II of the Constitution. In fact, amendment ten (10) as proposed violates the very nature and position of the head of state as a representative of the constitutional-legal unity of the people and state continuity, both within and outside Kosovo, and as a guarantor of the normal functioning of key state organs. This applies equally to every head of state in a constitutional democracy of the parliamentary type.

The theory and practice on the head of state personifying the constitutional-legal unity of the people as well as the guarantor of the normal (regular) functioning of the key organs of the state first appeared in France following the 1878 Revolution. Benjamin Constant was the first to elaborate it in a wider context dealing with the nature and the position of the constituent powers of the people emerging in the scene as a new sovereign unknown until then. All his efforts were directed towards justifying the uncontrolled manifestation of the will of this new sovereign. Within these efforts appeared the expression depicting the monarch as an institution that reigns but does not govern ("*il regne et ne gouverne pas*"). As such, it was endorsed by a few political and

constitutional theorists, including here Carl Schmitt. The expression, it should be noted, did not reflect realities on the ground. This was first noted by Hans Kelsen in his reply to Carl Schmitt. As Kelsen noted, this was so because monarchs of the time were part and parcel of the executive (the government) and that since the 19<sup>th</sup> century there were constant efforts to curtail these executive powers of the monarchs. The Weimar Constitution was the last effort in practice to establish an institution that “*regne et ne gouverne pas*”, but not with a big success owing to the powers given to the head of state in Article 48 of the Constitution. This article did not enable the President of the Reich to be guardian of the constitution since it was itself part of the executive staying above Reichstag and other powers. The Weimar head of state, for this reason, also could not serve as a guarantor of the normal (regular) functioning of key state organs as it stayed above all of them. Legislative and executive powers recognized in Article 48 and others in the Constitution of Weimar stood for the fact that the head of state could not serve as a representative of the constitutional-legal unity of the people but only of the interests of the moment of legislative and executive powers of the time. This means that the head of state in Weimar could not represent the sociological-political unity of the people either. Only after World War Two the head of state as representative of the constitutional-legal unity of the people appeared in Europe in the constitutions of constitutional democracies.

It may seem strange that in this paper we had to clarify that courts do not protect positions and human rights *ad hominem* when deciding cases in proceedings of abstract review of constitutionality. This paper emerged as a reply to a unilateral discourse in Kosovo contesting the legal force of the Judgment of the Court in the part dealing with the head of state. We demonstrated in this paper that no serious and professional court would ever take into account arguments *ad hominem* in cases dealing with abstract review of constitutionality of laws and constitutional amendments.

Gjyqtari Michael J. Davis

Kryetar, Gjykata e Rrethit të Shteteve të Bashkuara, Rrethi i Minnesotes

## **RUAJTJA E TË DREJTAVE TË NJERIUT NË GJYKATAT E SHTETEVE TË BASHKUARA – ROLI I AVOKATIT MBROJTËS DHE GJYQTARIT**

Qershor 29, 2012, 11:30 – 12:15  
Prishtinë, Kosovë

### **I. Hyrje**

Profesor Dr. Hasani, Gjyqtar Robert Carolan dhe gjyqtarë tjerë të gjykatës kushtetuese, gjyqtar Stephen Swanson dhe gjyqtar John Tunheim:

Mirëmengjesi. Kam nderin të jem këtu këtë mëngjes. Gjyqtarët, prokurorët, dhe avokatët penal janë kyç në ruajtjen e të drejtave të njeriut në SHBA dhe në të gjitha demokracitë. Pavarësia e gjyqësorit dhe ndihma juridike efektive janë parimet bazë të sistemeve juridike, të cilat synojnë sigurimin e të drejtave të njeriut për të gjithë pjesëtarët e shoqërisë.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut thotë se “secili ka të drejtë në shqyrtim të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një tribunal i pavarur dhe paanshëm të themeluar me ligj: dhe secili i akuzuar për veprë penale duhet patjetër të gëzojë të drejtën “të mbrojtë vetën personalisht ose përmes ndihmës ligjore të cilën ai vetë e zgjedh, ose nëse nuk ka të holla të mjaftueshme për të paguar për këtë ndihmë ligjore, ajo do t’i jipet falas kur një gjë e tillë kërkohet në interes të drejtësisë.”<sup>1</sup>

Theksoj se kushtetuta e Kosovës ruan të njëjtat të drejta. “Secili ka të drejtë në shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm përkitazi të drejtave dhe detyrimeve të tij, apo përkitazi veprave penale, brenda një afati të arsyeshëm nga ana e një gjykate të pavarur dhe të paanshëm të themeluar me ligj.”<sup>2</sup> Kushtetuta e Kosovës, neni 31. “Secili i akuzuar penalisht gëzon të drejtat minimale në vijim...të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh...dhe, nëse ai/ajo nuk ka mjete të mjaftueshme, ka të drejtë në mbrojtje falas.”<sup>3</sup> Kushtetuta e Kosovës, neni 30.

---

1 Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore [Konventa evropiane mbi të drejtat e njeriut], neni 6.

2 Kushtetuta e Kosovës, neni 31 (2).

3 Kushtetuta e Kosovës, Neni. 30 (5).



Unë luftoj t'i përmbush këto ideale. Kushtetuta e SHBA-së thotë: “në të gjitha rastet penale, i akuzuari gëzon të drejtën e gjykimit të shpejtë dhe publik, nga një juri e pavarur...dhe...të ketë ndihmën e mbrojtësit në mbrojtjen e tij.”<sup>4</sup> Kodi i sjelljes i cili qeveris veprimet e mija si gjyqtar federativ amerikan thotë: “një gjyqësor i pavarur dhe i ndershëm është i pazëvendësueshëm për drejtësinë në shoqërinë tonë.”<sup>5</sup>

Ne duhet të kuptojmë qartë vlerën e gjyqtarëve dhe avokatëve në sistemin e drejtësisë. Dëshiroj të flas tani për raste konkrete, dhe të ilustruj se si avokatët mbrojtës dhe gjyqtarët kanë korrur sukses – dhe dështuar – në përmbushjen e detyrave të tyre profesionale dhe përligjjen e të drejtave të njeriut. Unë do të filloj diskutimin tim duke vënë në pah rolin kyç të avokatëve mbrojtës në sistemin ligjor e SHBA-së, dhe pastaj do të diskutoj në rolin e gjyqtarëve në sigurimin e sistemit të drejtë juridik.

## II. Sistemi kundërshtues

Sistemi i drejtësisë amerikane karakterizohet me natyrën e tij kundërshtuese, ku palët kontrollojnë prezantimin e rastit.<sup>6</sup> “Një sistem kundërshtues rëndom përkufizohet si sistem ku palët paraqesin fakte dhe argumente ligjor pranë një vendim-marrësi pasiv dhe të paanshëm, i cili pastaj vendos për rastin.”<sup>7</sup> Për dallim nga sistemi inkuizitiv, kur gjyqtarët udhëheqin hetimin dhe prezantimin e rastit, sistem kundërshtues në përgjithësi çmon autonominë e palëve më shumë se qëllimet tjera.<sup>8</sup>

Në përgjithësi, një gjyqtar në sistemin kundërshtues duket të jetë më pasiv se sa në sistemin inkuizitiv, duke shmangur krijimin apo përmirësimin e gabimeve evidente të palëve. Mirëpo, në sistemin kundërshtues gjyqtar është më shumë se sa një arbitër i cili referon goditjet dhe huqet në një lojë bejsbolli. Diskutimi im sot do të tregojë se si një gjyqtar respekton autonominë e pjesëmarrësve në një sistem kundërshtues duke e ruajtur akoma të drejtën në gjykim të drejtë.

Gjykata Supreme e SHBA-së në vitin 1895 shpjegoi se “parimi i prezumimit të pafajësisë së të akuzuarit është ligj përtej dyshimi, ligj aksiomatik dhe elementar, dhe zbatimi i tij shtrihet në themelin e administrimit të ligjit tonë penal.”<sup>9</sup> Kjo e drejtë është gjetur edhe në kodet ligjore të Greqisë antike dhe

4 Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara, Amand. 6.

5 Kodi i Sjelljes për Gjyqtarët e Shteteve të Bashkuara, Kriteri 1.

6 Amanda Frost, *The Limits of Advocacy*, 59 *Duke L.J.* 447, 449 (2009).

7 *Id.*

8 *Id.*

9 *Coffin v. United States*, 156 U.S. 432, 453 (1895).

në Romë.<sup>10</sup> E drejta e secilit të akuzuar të konsiderohet i pafajshëm është gur-themel i sistemit tonë dhe të juaj ligjor; është e cekur si në konventën evropiane për të drejtat e njeriut (“Secili i akuzuar penalisht konsiderohet i pafajshëm derisa të gjendet fajtor sipas ligjit.”<sup>11</sup>) ashtu dhe në kushtetutën e Kosovës (“Secili i akuzuar penalisht konsiderohet i pafajshëm deri sa fajësia e tij/saj të dëshmohet në pajtim me ligjin.”<sup>12</sup>). Kjo e drejtë bazike e secilit të pandehur, e kombinuar me standardin e lartë të dëshmisë – dëshmia në sistemin amerikan është përtej çdo dyshimi të bazuar – është e rëndësishme për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të njeriut të të pandehurit, pasi një vendim fajësues mund ta privojë atë nga liritë e tij/saj themelore njerëzore).

Është me rëndësi t’ia përkujtojmë vetvetes se pse operojmë sipas rregullave nën të cilat operojmë – për të krijuar sistem drejtësie të drejtë dhe të respektuar. Qëllimi ynë i ofrimit të drejtësisë së barabartë sipas ligjit duhet të jetë çdo herë në mendjet tona. Ky ideal duhet të zmbrops tundimin e marrjes së rrugës së shkurtër për të kaluar nëpër një kalendar të ngjeshur në kurriz të respektimit të të drejtave të të pandehurit.<sup>13</sup> Gjykata poashtu duhet të jetë e vetëdijshme për tendencën njerëzore të mbrojtjes së karrierës duke iu shmangur marrjes së vendimeve jo të popullarizuara. Ne, si gjyqtarë, jemi pararoje e sistemit të drejtë juridik. Ne çdo herë duhet të jemi vigjilent për këtë përgjegjësi.

Mirëpo, gjyqtarët vetë nuk mund të sigurojnë një sistem drejtësie të pavarur, të drejtë dhe të respektuar. Avokatët mbrojtës janë mbrojtës vital të të drejtave të njeriut, dhe sistemi ynë juridik nuk mund të funksionojë pa ta. Një temë e afërt dhe e dashur për mua është roli i avokatëve mbrojtës në sistemin e drejtësisë pasi edhe vet isha avokat mbrojtës për shumë vite.

### III. Detyra e avokatëve mbrojtës penal

#### A. Burimet

Sistemi ynë kundërshtues vë një ngarkesë të madhe në supet e avokatëve mbrojtës. Si rezultat, ata i nënshtrohen standardeve profesionale, etike dhe kushtetuese, me të cilat kërkohet mbrojtja e të akuzuarve penalisht.

Neni 31 (6) të kushtetutës së Kosovës, “mbrojtja falas ligjore do t’ju ofrohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare nëse mbrojtja e tillë

10 Id. Fq. 454-55.

11 Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, neni 6(2).

12 Kushtetuta e Kosovës, neni 31(5).

13 Keith Swisher, The Judicial Ethics of Criminal Law Adjudication, 41 Ariz. St. L.J. 755, 778 (2009).

është e domosdoshme për të siguruar qasje efektive në drejtësi.” E drejta në mbrojtje falas dhe efektive ligjore është bërë gur-themel i sistemit amerikan juridik. Përmes një varg rasteve të rëndësishëm, të cilat përfunduan me rastin Gideon kundër Wainwright në 1963, gjykata supreme e SHBA e interpretoj të drejtën e amendamentit të gjashtë “për të pasur ndihmë juridike për...mbrojtje,” të kushtetutës së SHBA-së për dhënien e ndihmës juridike atyre të cilat nuk kanë mjete të mjaftueshme për ta paguar. Krahas kësaj, gjykata supreme ka qartësuar se nuk mjafton vetëm emërimi i mbrojtësit për t’i përfaqësuar të akuzuarit, por avokati mbrojtës duhet të jetë kompetent. Siç edhe u shpjegua nga gjykata supreme, “e drejta në ndihmë juridike (në amendamentin e gjashtë) është e drejtë në ndihmë juridike efektive nga mbrojtësi.”<sup>14</sup>

Detyrat e avokatëve mbrojtës ndaj klientëve të tyre dhe gjykatësve kanë rrënjët e tyre edhe në obligimet e tyre profesionale dhe etike. Për qëllim të këtij prezantimi, unë do të përqendrohem në detyrat e përgjithshme të cekura në Rregullat e Sjelljes Profesionale të hartuara nga Asociacioni Amerikan i Jurisprudencës, të cilat janë, plotësisht apo pjesërisht, të adoptuara nga shumë shtete.

## **B. Një vështrim i detyrave themelore**

### **1. Avokimi i zellshëm**

Thënë në përgjithësi, obligimi i parë i avokatit mbrojtës është të ketë parasysh para se gjithash, interesat më të mirë të klientit. Përgjatë gjykimit të mbretëreshës Caroline në Angli në vitin 1820, Lordi Henry Brougham famshëm deklaroi se “detyra e parë dhe e vetme e avokatit është të mbrojë klientin (e tij/saj) me çdo çmim...duke mos marrë parasysh rreziqet dhe kostot për personat tjerë.”<sup>15</sup> Në kohët moderne, obligimi i avokimit të zellshëm ne emër të klientit ngel detyra primare e avokatit mbrojtës.

Duke krahasuar detyrat e prokurorëve dhe të avokatëve mbrojtës, gjyqtari Byron White qartësoi se gjersa prokurorët “janë të obliguar të dënojnë fajtorin dhe të sigurohen se nuk dënojnë të pafajshmin...avokati mbrojtës nuk ka obligime krahasuese për të gjetur apo prezantuar të vërtetën.”<sup>16</sup>

14 Missouri v. Frye, 132 S. Ct. 1399, 1404 (2012).

15 Monroe H. Freedman, Henry Lord Brougham and Zeal, 34 Hofstra L. Rev. 1319, 1322 (2006); shih poashtu Robert K. Flowers, The Role of the Defense Attorney: Not Just an Advocate, 7 Ohio St. J. Crim. L. 647, 648 (2010).

16 United States v. Wade, 388 U.S. 218, 256 (1967) (White, J., pjesërisht pajtohet, pjesërisht nuk pajtohet).

Ngase sistemi ynë (amerikan) i jep atij mision tjetër. Ai duhet të jetë dhe është i interesuar në parandalimin e dënimit të pafajshëm, mirëpo, përveç në rastet kur i akuzuari vetë deklarohej fajtor, ne duhet të insistojmë që avokati mbrojtës të mbrojë klientin e tij pavarësisht se a është ai fajtor apo i pafajshëm. Prokuroria është e obliguar të paraqes dëshmi. Avokati mbrojtës nuk ka nevojë të prezantojë asgjë, edhe nëse e di të vërtetën. Ai nuk ka nevojë të thërret asnjë dëshmitar, apo të zbulojë sekretet e klientit të tij, apo t'i jap prokurorisë ndonjë informatë për ta ndihmuar rastin e tyre. Puna e tij e rëndomtë është të hutojë dëshmitarin, edhe nëse ky i fundit e thotë të vërtetën, apo ta bëjë të duket i pasigurt, i metë apo i pavendosur. Interesi ynë në mos dënimin e të pafajshmit e lejon avokatin mbrojtës të bëjë prokurorinë të ofrojë dëshmi, të tregojë rastin e prokurorisë në dritën e tij më të keqe, pavarësisht se çfarë mendon apo e di të vërtetën.<sup>17</sup>

Edhe pse evokimi i zellshëm mund të jetë detyra më e rëndësishme e avokatit mbrojtës ndaj klientit të tij/saj, kjo detyrë ka kufizimet e saj. Dëshiroj tani të shtjelloj disa raste nga gjykata ime për të ilustruar evokimin e zellshëm në praktikë:

#### **a. Avokimi i zellshëm para gjykimit**

Vlera e një avokati të palodhur i cili nuk dorëzohet, edhe kur gjasat janë kundër tij, është e paçmueshme. Tash vonë kam pasur një rast i cili ilustron këtë parim.<sup>18</sup>

Policia ndaloi një Afro-Amerikan. Policia dëshmoi në gjykatë se vetura e këtij të fundit nuk kishte tabelat e dhura të regjistrimit dhe kur iu afruan veturës, ata menduan se vetura është e vjedhur. Ata bastisën të pandehurin dhe gjetën disa substanca kundërligjore në xhepin e tij dhe një armë zjarri dore nën ulësen e ngasësit – këtë e tha policia në shqyrtimin gjyqësor. Avokati mbrojtës kishte siguruar video-kaseten nga vetura e policisë dhe e paraqiti për të dëshmuar se policia gënjente dhe se ata tashmë e kishin verifikuar veturën se nuk ishte veturë e vjedhur. Sipas kushtetutës, policia nuk kishte dyshim të artikuleshëm për të bastisur veturën. Andaj, avokati mbrojtës mblodhi prova të mjaftueshme për të siguruar rrëzuar rastin kundër klientit të saj.

Puna hetimore e palodhur e avokatit mbrojtës rezultoi në pushimin e rastit kundër klientit të saj para gjykimit, dhe e drejta e të pandehurit që të jetë i lirë nga bastisjet e paarsyeshme u mbrojt.

17 Id. fq. 256-57.

18 United States v. Ollie, Criminal File No. 10-239 (MJD/JJG) (D. Minn. Mar. 8, 2011).

## b. Avokimi i zellshëm përgjatë gjyqimit

Siç thashë në fillim të fjalimit tim, e drejta për t'u konsideruar i pafajshëm është gur-themel i përbashkët i sistemeve tona penalo-ligjore. Të drejtat nuk dmth shumë, përveç nëse avokatët mbrojtës dhe gjyqtarët punojnë për t'i përligjur ato në çdo rast. Ata duhet të jenë roje e të sigurojnë se të pafajshmit nuk vendosen prapa grilave përveç nëse fajësia e tyre është pothuajse e sigurt.

Një shembull tjetër nga gjykata ime: tash vonë isha gjyqtar në një gjykim të një çuni të akuzuar për sulm seksual ndaj një vajze pesë vjeçare.<sup>19</sup> Qartë, ishte një rast plot emocione. I pandehuri ishte një i ri nga një prej rezervateve të amerikanëve autokton në shtetin tim. Pasi nuk ishte në gjendje të paguaj avokatin, ai u përfaqësua nga një prej avokatëve publik mbrojtës të qarkut tonë. Përgjatë gjyqimit, avokati i të pandehurit ushtroi detyrat e tij të parapara me kushtetutë – me zell mbrojtë klientin e tij, duke argumentuar pafajësinë e tij, dhe duke shikuar me kujdes dhe duke sfiduar çdo dëshmi të paraqitur nga prokuroria.

Avokimi i zellshëm i avokatit të të pandehurit në emër të klientit të tij vuri në pah disa probleme serioze me këtë rast. Sa për fillim, një prej dëshmitarëve kyç të prokurorisë, një motër medicinave ekzaminuese e sulmeve seksuale, dëshmoi se ajo kishte testuar viktimën për prova të ADN-së pas sulmit të pretenduar. Ajo ishte e sigurt se prova të ADN-së do të gjindeshin nga testet e saja po të kishte ndodhur sulmi në realitet. Avokati mbrojtës nxitoi dhe spikati se nuk kishte prova të ADN-së, të cilat do të lidhnin të pandehurin me këtë sulm të pretenduar.

Kjo nuk ishte e vetmja çarje në rastin e prokurorisë e cila u vu në pah nga ana e avokatit mbrojtës. Dëshmitë treguan se i akuzuari ishte skajshmërisht i dehur në kohën e sulmit të pretenduar. Dy prej dëshmitarëve kyç të prokurorisë – të afërmit e të akuzuarit – pohuan se nuk ishin në dijeni se kishte alkool aty dhe se ata nuk kishin pirë fare. Avokati mbrojtës hodhi dyshime mbi këto pohime, duke thënë se si dëshmitarët dështuan të vërejnë se i akuzuari ishte i dehur kur ata e kishin kaluar tërë ditën së bashku me të akuzuarin. Ishte e vështirë t'ju besohej përgjigjeve bishtnuese të dëshmitarëve për alkoolin. Përgjigjet e tyre bishtnuese hodhen dyshim mbi vërtetësinë e deklaratave të tyre përkitazi rasti.

Në fund, mbase edhe në pikën më të vështirë të gjyqimit, viktimja e pretenduar u thirr të dëshmonte. Deponimi i saj mbështeti versionin e prokurorisë mbi ngjarjet në ditën e sulmit të pretenduar. Mirëpo, kur u kërkua të identifikonte njeriun i cili pretendonte se e kishte sulmuar (njeriun të cilin ajo e njohte mjaft mirë) në radhën e dhjetë apo më shumë njerëzve në sallën e gjykatës, ajo nuk mund të bënte një gjë të tillë.

19 United States v. Wind, Crim. No. 11-175 (D. Minn. 2011).

Në fund të gjykit, në fjalën e tij përmbyllëse, avokati i të akuzuarit përkujtoi jurinë se prokuroria ishte e obliguar të paraqiste prova dhe vazhdoi duke vënë në pah pranë jurisë shpërputhjet dhe zbrazëtirat në provat e prokurorisë. Siç rëndom bëjë në fund të çdo gjykimi, unë i tregoj jurisë për detyrën e tyre kushtetuese që të konsiderojnë të akuzuarit të pafajshëm dhe t'ia vendosin prokurorisë obligimin e të dëshmuarit, përtej çdo dyshimi, se i akuzuari ka kryer krimin me të cilin ngarkohet. Juria shqyrtojë rasti për disa orë dhe u kthye prapa me vendimin se i akuzuari nuk ishte fajtor.

Shfajësimi është dukuri e rrallë në gjykatën time për shkak të faktit se në shumicën e rasteve të paraqitura i akuzuari deklarohet fajtor. Mirëpo, edhe për shkak se prokurorët e marrin detyrën tyre seriozisht për të hetuar fajësinë dhe pafajësinë e të akuzuarve potencial, dhe mundohen të akuzojnë të pandehurit vetëm atëherë kur fajësia e tyre mund të dëshmohet përtej çdo dyshimi. Kur prokurorët gabohet në këtë konstatim, avokatët mbrojtës duhet të ruajnë lirinë e të pandehurit duke e mbrojtur prezumimin e pafajësisë dhe të provës, e cila gjë vendos një ngarkesë të rëndë mbi prokurorinë.

### **c. Avokimi i zellshëm përgjatë shpalljes së dënimit**

Avokimi i zellshëm i të akuzuarit nuk angazhohet thjesht për të kërkuar vendim lirues. Shpesh herë, avokati mbrojtës mund të jetë aktiv në përligjjen e të drejtave të njeriut edhe pasi i akuzuari të vetë deklarohet fajtor. Në sistemin amerikan federativ, në vitin 2010 mbi 90% e përndjekjeve federale rezultuan në vetë deklarime të fajshme.<sup>20</sup> Roli i mbrojtësit si avokat rëndom nuk është në gjykim. Mbrojtësi i të akuzuarit luan një rol të rëndësishëm në avokim për një dënim të drejtë të të akuzuarit fajtor.

Ky rol vital më përkujton një rast të paharrueshëm ku i akuzuari u vetë deklarua fajtor për posedimin e pornografisë me fëmijë.<sup>21</sup> I akuzuari kishte në posedim më shumë se 1000 imazhe të pornografisë me fëmijë. Në shikim të parë, i akuzuari dukej i rrezikshëm i cili meritonte shumë vite burgim. Mirëpo, rastisi të kishte një avokate mbrojtëse të jashtëzakonshme.

Kjo e fundit insistonte se i akuzuari nuk kishte kërkuar pornografi fëmijësh, mirëpo kishte kërkuar pornografi ligjore me të rritur, dhe aksidentalisht, kishte shkarkuar pornografi me fëmijë. Edhe pse një argument i tillë dukej absurd duke pasur parasysh se i akuzuari kishte më shumë se 1000 imazhe ilegale të pornografisë me fëmijë, avokatja dëshmoi se i akuzuari kishte miliona imazhe të pornografisë me të rritur. Avokatja argumentoi se prokuroria nuk

20 Byroja e Statistikave Juridike, Departamenti Amerikan i Drejtësisë, Libri i Statistikave Juridiko-penale, Tabela online 5.22.2010, <http://www.albany.edu/sourcebook/pdf/t5222010.pdf> (së fundi e vizituar më 25 Qershor, 2012).

21 United States v. Matthew Charles Stuart, dosja penale Nr. 09-381 (MJD/JJK).

mund të dëshmonte se i akuzuari kishte kërkuar imazhe pornografike me fëmijë, dhe prokuroria dhe avokatja mbrojtëse bënë një seancë për gjykatën duke shpjeguar se si funksionon Limewire, programi on-line kompjuterik përmes së cilit i akuzuari kishte shkarkuar pornografi me fëmijë.

Avokatja argumentonte se testimet psikologjike do të tregojnë se klienti i saj nuk kishte kërkuar pornografi me fëmijë dhe se kishte të ngjarë se nuk do të përsëriste veprën. Ajo luftoi që klienti i saj të ketë testimet të thella psikologjike dhe këshillime, duke argumentuar se ai nuk ishte kryes tipik i posedimit të pornografisë me fëmijë. Çuditërisht, pas testeve të bëra (përfshirë edhe testin e poligrafit) dhe trajtimit, i akuzuari arriti t'i sjell ekspertët e çmuar, të fushës së trajtimit të kryesve të veprave penale seksuale, të dëshmojnë se ai vërtetë ka të ngjarë se nuk do të përsëris veprën.

Pasi e shtyri gjykatën të merr parasysh çështjet të cilat nuk u vëren në fillim të rastit, gjykata pati katër shqyrtime dhe kërkoj prezantime të thella përkitazi funksionimit të Limewire dhe të testeve psikologjike të të akuzuarit. Dënimi i paraparë me Udhëzimet mbi Dënimet të SHBA-së për të akuzuarit të cilët gjenden në posedim të llojit dhe sasisë së ngjashme të pornografisë me fëmijë ishte prej 78 deri në 97 muaj. Mbrojtja e mrekullueshme e të akuzuarit nga avokatja rezultoi në dënim prej kohës së shërbyer, 90 ditë në burgun e qarkut me leje për të punuar jashtë burgut dhe 15 vite në liri të mbikëqyrur. Avokatja ishte e përgatitur dhe e këmbëngulëse. Ajo çdo herë respektoi klientin e saj, gjykatën dhe kolegun nga prokuroria. Ajo parashtrij argumente kreative dhe të reja të cilat çdo herë u dëshmuar dhe u prezantuan. Ajo përfaqësoi një të akuzuar i cili ishte fajtor i një krimi të neveritshëm, dhe përmes vendosmërisë së saj, ajo arriti ta bind gjykatën se klienti i saj nuk ishte siç dukej fillimisht dhe në fakt, ishte ndryshe nga autorët tjerë seksual të cilët gjykata i kishte dënuar.

## 2. Konfidencialiteti

Krahas avokimit të zellshëm, një gur-themel tjetër i marrëdhënies në mes të avokatëve mbrojtës dhe klientëve të tyre është konfidencialiteti. Modelet e rregullave të sjelljes profesionale të asociacionit amerikan të jurisprudencës, thonë: “Një jurist nuk duhet të zbulojë informata që kanë të bëjnë me përfaqësimin e klientit përveç nëse klienti e jep pëlqimin, apo nëse autorizohet me nënkuptim për të kryer mbrojtjen, apo nëse lejohet (nga ana e disa përjashtimeve)”. Zbulimi lejohet në rrethana të caktuar, si atëherë për të parandaluar vdekjen apo lëndimin e rëndë trupor dhe për të parandaluar të akuzuarin nga shfrytëzimi i shërbimeve të avokatit për të kryer krim apo mashtrim i cili qenësisht do të dëmtonte tjetrin financiarisht.

Konfidencialiteti është esencjal për marrëdhënien në mes të klientit dhe avokatit mbrojtës ngase mundëson këtë të fundit të kuptoj plotësisht nevojat e klientit dhe ta ndihmojë në formulimin e mbrojtjes. Për shkak të rëndësisë së tillë të konfidencialitetit, zbulimi i informatave të klientit për arsye tjera nga ato cekura në këto përjashtime të pakta, rezulton në dënim strikt.

#### **d. Financimi i shërbimeve mbrojtëse për të akuzuarit e varfër**

Mund të pritët mbrojtje e pakët e të drejtave të njeriut të të akuzuarve pa ndihmën e avokatëve mbrojtës të trajnuar, kompetent dhe të përkushtuar. Siç e ka shpjeguar gjyqtari i gjykatës supreme të SHBA-së, Hugo Black, në rastin e madh të Gideon kundër Wainwright:

Në sistemin tonë kundërshtues të sistemit penalo-ligjor, çdo person i nxjerrë me forcë para gjykatës i cili nuk ka para për të angazhuar avokat - nuk mund të sigurohet gjykim i drejtë nëse atij nuk i ofrohet ndihma juridike. Kjo na duket si e vërtetë e evidente. Qeveritë federale dhe shtetërore harxhojnë shuma marramendëse për të krijuar një makineri për të gjykuar të akuzuarit për krime. Juristët e prokurorisë çdo kund konsiderohet esencjal në mbrojtjen e interesave publik të një rend shoqëror. Ngjashëm, ekzistojnë vetëm disa të akuzuar për krime, me të vërtetë vetëm disa syresh, të cilët dështojnë të angazhojnë avokatët më të mirë që mund të marrin për të përgatitur dhe paraqitur mbrojtjen e tyre. Qeveria angazhon juristë për të përndjekur dhe të akuzuarit që kanë të holla angazhojnë juristet për t'i mbrojtur, dhe këta janë treguesit më të fuqishëm të besimit të gjerë se juristët në gjykata penale janë domosdoshmëri, jo luks.<sup>22</sup>

Pa ndihmën e një mbrojtësi të aftë të gatshëm për të avokuar me zell në emër të tyre, të akuzuarit ngelin vetëm me të drejtat e tyre të cilat mund të duken bukur në letër, mirëpo ato nuk kanë ndonjë ndikim real në jetët dhe liritë e tyre.

Gjersa gjykata supreme e SHBA-së mbajti qëndrimin se kushtetuta e SHBA-së u garanton të akuzuarve penalisht të varfër të drejtën në avokat, në rastin Gideon kundër Wainwright, e drejta e garantuar me kushtetutë dhe e konstatuar nga gjykata më e lartë e vendit nuk është e përligjur përveç nëse kombi ofron fondin e nevojshëm për të garantuar atë të drejtë.

Jemi duke iu afruar 15 vjetorit të vendimit Gideon dhe shumë të akuzuar të varfër në vendin tonë akoma nuk kanë qasje në ndihmë juridike efektive.

Sistemi shtetëror i mbrojtjes publike në SHBA është në krizë. Kriza e fundit ekonomike ka përkeqësuar çështjen e mungesës së fondeve të



cilat ekzistonin më herë. Mungesa e fondeve adekuate për mbrojtje të akuzuarve të varfër shpie në mungesë të përfaqësimit të tyre cilësor. Nëse juristët paguhen pak për shërbimet e tyre, ata nuk kanë stimul për të ndarë kohën dhe bërë përpjekjet e duhura që në mënyrë kompetente të mbrojnë një rast, madje shumë juristë nuk dëshirojnë të pranojnë emërimin fare.<sup>23</sup>

Përfaqësimi joefektiv nga avokati shpie në dënimin e të pafajshmëve. Në SHBA, më shumë se 340 të burgosur janë shfajësuar që nga 1983, dhe 1/3 e tyre kishte pranuar mbrojtje joefektive.<sup>24</sup> Jo vetëm që të burgosurit e pafajshëm janë dënuar, mirëpo publiku është poashtu në rrezik, ngase kur dënohet i pafajshmi, kriminelin i vërtetë ngel i lirë për të kryer edhe më shumë krime.<sup>25</sup>

#### IV. Roli i gjyqtarëve

Tani dua të zhvendos diskutimin në rolin e gjyqtarit në rastet penale duke u fokusuar në detyrën etike të gjyqtarit për pavarësi.

##### A. Gjyqtarët duhet patjetër të jenë të pavarur

###### 1. Kriteri një dhe rëndësia e një gjyqësori të pavarur

Kriteri një i kodit të sjelljes për gjyqtarët amerikan thotë se “një gjyqtar duhet të ruaj integritetin dhe pavarësinë e gjyqësorit”. Konkretisht: “gjyqësori i pavarur dhe i ndershëm është i pazëvendësueshm për drejtësinë në shoqërinë tonë. Një gjyqtar duhet të mirëmbajë dhe zbatojë standardet më të larta të sjelljes dhe personalisht duhet t’ju përmbahet atyre standardeve, në mënyrë që të ruhet integriteti dhe pavarësia e gjyqësorit.”

“Thënë shkurt, gjykatat duhet të jenë dhe duhet të perceptohen si barrierë në mes të qeverisë dhe të qeverisurve, jo si instrument kontrolli i qeverisë për të qeverisurit.”<sup>26</sup>

23 Asociacioni i Jurisprudencës Amerikane, Gideon’s Broken Promise: America’s Continuing Quest for Equal Justice 7 (2004).

24 Representation of Indigent Defendants in Criminal Cases: A Constitutional Crisis in Michigan and Other States?: Seanca dëgjimore para Nënkomitetit për Krime, Terrorizëm dhe Siguri Kombëtare të Komitetit mbi Gjyqësorin, 111th Cong. 90 (2009) (deklarata e Robin L. Dahlberg, Avokat i lartë, Programi i Drejtësisë Racore, Unioni Amerikan i Lirive Civile).

25 Id. Fq. 91.

26 John M. Burman, Judges’ and Lawyers’ Ethical Duty of Independence, 33 Wyo. Law. 34, 34 (Dec. 2010).

Pavarësia e gjyqësorit është një kusht sine qua non e sundimit të ligjit. Gjyqtarët duhet të jenë të pavarur, të paanshëm dhe të izoluar nga ndikimi nga jashtë përveç atij të rastit. Në një sistem të pavarur gjyqësor, gjyqtarët japin llogari për veprimet e tyre mirëpo nuk i nënshtrohen faktorëve politik apo ekonomik në marrjen e vendimeve në rastet e paraqitura pranë tyre.

Duke qenë të pavarur, gjyqtarët ndjellin sundim të ligjit, me fjalë tjera, ata e bëjnë ligjin superior dhe të obligueshëm për secilin pa përjashtim. Mirëpo, që të ekzistoj pavarësia e gjyqësorit, ligji duhet të garantojë këtë parim dhe gjyqtarët duhet të jenë profesionist serioz dhe të respektuar, t'ju ofrohet stabilitet dhe të jenë të liruar nga ndikimet politike apo ekonomike në vendimet e tyre.<sup>27</sup>

Siç e kishte vërejtur edhe Thomas Jeffersoni, nëse gjyqtarët janë në mëshirë të ndonjë dege të qeverisë për mandatin apo rrogën e tyre, atëherë vendimet e tyre do të ndikohen. Pyetjet nuk do të jenë “çfarë thotë kushtetuta?”, “çfarë thotë ligji?” dhe “çfarë kërkojnë rastet precedente?” por do të jenë “A mos do të shkarkohem vallë?”, “A do të më hiqet apo zvogëlohet rroga?” apo “A mos vallë ky vendim nuk do jetë i popullarizuar?”<sup>28</sup>

13 Për një zbatim të ngjashëm të DUDNJ-së në rendin juridik vendor, shih nenin 2 të pjesës II të Aneksit të Kushtetutës së Federatës së Bosnjë dhe Hercegovinës.

dhe të drejtën për të qenë i siguruar në rast papunësie, sëmundjeje, invaliditeti, vejërie, pleqërie ose në raste të tjera të mungesës së mjeteve të jetesës për shkak të rrethanave që nuk varen nga vullneti i tij.

2. Nënata dhe fëmijët kanë të drejtën për kujdes dhe ndihmë të posaçme. Të gjithë fëmijët, të lindur në marrëdhënie martesore apo jashtëmartesore, gëzojnë mbrojtje të njëjtë sociale...<sup>1</sup>

Ndonëse mund të shtrohet pyetja se a janë sa a janë dispozitat për të drejtat ekonomike dhe sociale të DUDNJ-së sa duhet të sakta sa i përket zbatimit të tyre, në të njëjtën kohë legjislatori e ka obligim kushtetues që të krijojë mekanizmat e nevojshëm për jetësimin e të drejtave ekonomike dhe sociale të cekura në nenin 22 dhe 25 të DUDNJ-së.

Përveç DUDNJ-së, ka edhe dispozita të instrumenteve të tjera që burojnë nga neni 22 i Kushtetutës së Kosovës që paraqesin të drejta dhe liri të reja të cilat nuk janë në mënyrë shprehimore të përcaktuara në Kushtetutën e Kosovës. Edhe pse e drejta e vetëvendosjes së popujve nuk është artikuluar në Kushtetutën e Kosovës, ajo megjithatë është drejtpërdrejtë e zbatueshme në rendin juridik të Kosovës sipas nenit 1(1) të KNDCP,<sup>14</sup> të cekur në nenin 22(3) të Kushtetutës.

Në përgjithësi, përfshirja e konventave ndërkombëtare dhe instrumenteve të tjera në rendin juridik vendor mund të konsiderohet si indikacion i vullnetit pozitiv të institucioneve të Kosovës për të ofruar një nivel të lartë të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore. Në të njëjtën kohë, ajo krijon edhe disa pritje të caktuara, të cilat mund të vërehen kur palët në procedura gjyqësore fillojnë të thirren më shumë në tetë instrumentet e cekura në nenin 22 të Kushtetutës. Në atë fazë të zhvillimit, gjyqësori, e me siguri edhe institucionet e tjera shtetërore, mund të përballen me vështirësi në përkufizimin e fushëveprimit, e që është më me rëndësi, në materializimin e dispozitave ndërkombëtare që burojnë nga neni 22 në kontekstin e Kosovës. Kjo mund të jetë detyrë e vështirë veçanërisht kur është fjala për dispozitat e caktuara abstrakte të tetë instrumenteve ndërkombëtare. Sipas mendimit të autorit, kjo do të jetë pjesë e procesit të natyrshëm për arritjen e nivelit të dëshiruar të demokracisë bazuar në mbrojtjen e të drejtave themelore, siç udhëzohet, e deri në një masë edhe diktohet nga dispozitat ndërkombëtare që burojnë nga neni 22 i Kushtetutës.

<sup>14</sup> Neni 1(1) i KNDCP përcakton se 'të gjithë njerëzit kanë të drejtë në vetëvendosje. Sipas kësaj të drejte ata mund të vendosin lirisht për statusin e tyre politik dhe të ndjekin lirisht zhvillimin e tyre ekonomik, social dhe kulturor.'



### III. Fushëveprimi i Nenit 53 të Kushtetutës së Kosovës

Neni 53 i Kushtetutës së Kosovës përcakton se '[t]ë drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut'. Rrjedhimisht, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të mishëruara në Kushtetutën e Kosovës duhet të interpretohen në harmoni me jurisprudencën e krijuar për një kohë të gjatë nga Gjykata e Strasburgut. Më tej, kjo po ashtu nënkupton se të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me dokumentet ndërkombëtare të cekura në nenin 22 të Kushtetutës së Kosovës duhet të interpretohen në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së. Me fjalë tjera, në rast se ekzistojnë standarde të ndryshme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut sipas instrumenteve ndërkombëtare të zbatueshme në rendin juridik të Kosovës, neni 53 i Kushtetutës kërkon që të mbizotërojë interpretimi i GJEDNJ-së.

Mund të theksohet se Kushtetuta e Kosovës nuk përcakton një interpretim konsistent me gjykatat dhe tribunalet e tjera ndërkombëtare, përfshirë edhe Tribunalin Ndërkombëtar Penal për Ish-Jugosllavinë (TNPJ), e cila ka rëndësi të veçantë për Kosovën. Megjithatë, TNPJ nuk është krijuar si trupë e përhershme gjyqësore por është krijuar për një detyrë konkrete. Duke qenë kështu, mund të kuptohet edhe arsyeja pse praktika gjyqësore e TNPJ-së nuk është përfshirë në Kushtetutë.

### IV. Zbatimi Gjyqësor i Neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës së Kosovës

Prej tetë instrumenteve të cekura në nenin 22 të Kushtetutës, është kryesisht KEDNJ-ja ajo që zbatohet në gjykatat e Kosovës. Në raste të izoluar, në jurisprudencën e Kosovës mund të vërehet edhe zbatimi i KNDCP-ja.<sup>15</sup>

Sa i përket zbatimit të KEDNJ-së dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata Kushtetuese e Kosovës dhe panelet e përziera të gjyqtarëve të EULEX-it shpesh angazhohen në diskutime të hollësishtme të këtyre burimeve të së drejtës. Në të njëjtën kohë, zbatimi i neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës nga gjyqtarët vendorë të gjykatave të rregullta të Kosovës është tejet i rrallë.

---

15 Rasti PKL-KZZ-137/2011, Aktgjykimi i panelit të përzier të gjyqtarëve të EULEX-it, Gjykata Supreme e Kosovës, 13 prill 2012, fq 3.

## A. Gjykata Kushtetuese

Gjatë pothuaj katër viteve të funksionimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, duhet vlerësuar guximin dhe profesionalizmin e saj në zbatimin e të drejtave ndërkombëtare të njeriut. Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese tregon se referenca në të drejtat dhe liritë e përcaktuara nga KEDNJ dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Strasburgut nuk kufizohet vetëm në çështjet që paraqiten para Gjykatës por shërbejnë edhe si burim frymëzimi i cili i bën aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese bindëse për komunitetin.

Në të njëjtën kohë, një vështrim më nga afër i jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese i vë në pah disa çështje të caktuara metodologjike të cilat mund të përpunohen në punën e mëtejshme të Gjykatës. Së pari, KEDNJ-ja dhe jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut duhet të merren parasysh jo vetëm për të arritur te konstatimet e Gjykatës Kushtetuese që do të jenë në kuadër të fushëveprimit të të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutën e Kosovës, por edhe për të studiuar parimet dhe doktrinat e zhvilluara nga GJEDNJ-ja. Së dyti, për arsye të konsistencës Gjykata Kushtetuese duhet të zhvillojë një sistem uniform të citimit dhe referencës në praktikën gjyqësore dhe në të drejtat e përcaktuara në sistemet e traktateve të tjera ndërkombëtare.

Për çështjen e parë, një shembull i asaj se si parimet dhe doktrinat e jurisprudencës së GJEDNJ-së mund të jenë të dobishme për Gjykatën Kushtetuese mund të gjendet në rastin e njohur si *Fatmir Sejdiu*. Tridhjetë e dy deputetë të Kuvendit të Kosovës me anë të një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese pretenduan se Z. Fatmir Sejdiu, Presidenti i Republikës së Kosovës kishte shkelur nenin 88 të Kushtetutës së Kosovës në mbajtjen në të njëjtën kohë të pozitës së Presidentit të Republikës së Kosovës dhe atë të Presidentit të partisë së tij politike, Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK).<sup>16</sup>

Ishte konsideruar se Z. Sejdiu kishte mbajtur postin e kryetarit të LDK-së për më shumë se tri vjet para parashtrimit të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese. Prandaj, Gjykata Kushtetuese, mes tjerash, duhej të vlerësonte se a ishte paraqitur rasti brenda afatit kohor të përcaktuar me ligjin Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Ligji për Gjykatën Kushtetuese). Neni 45 i ligjit për Gjykatën Kushtetuese thekson se “[k]ërkesa duhet të parashtrohet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur shkelja e pretenduar kushtetuese nga ana e Presidentit është bërë publike’.

Në adresimin e afatit kohor për parashtrimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese, shumica e gjyqtarëve konstatuan se:

<sup>16</sup> Neni 88 i Kushtetutës së Kosovës përcakton: ‘1. Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër publik.

2. Pas zgjedhjes, Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion në parti politike.’

'32. Në rastin e Presidentit Sejdiu, është e nevojshme që të shohim situatën faktike për të parë nëse mbajtja e funksionit të Kryetarit të LDK-se, por "ngrirja e atij pozicioni", ishte një rast i vetëm, i cili ndodhi një herë të vetme ose nëse përbën një situatë që vazhdon çdo ditë. Nëse është kjo e fundit atëherë nuk ekziston afat kohor me të cilin deputetët duhet të parashtrorjnë një kërkesë pranë Gjykatës në lidhje me shkeljen e supozuar. Për më tepër, fakti i "mbajtjes dhe ngrirjes" së pozicionit, duket se implikon se ngrirja e këtij pozicioni mbetet në fuqi gjatë gjithë kohës. Presidenti pranon se ai ka vazhduar të jetë Kryetari i LDK-se dhe Presidenti i Republikës çdo ditë që nga zgjedhja e tij në 2006.

33. Nëse rasti është ky, pasojat e ngrirjes së pozicionit vazhdojnë dhe kështu ekziston një situatë e vazhdueshme, e cila vazhdon çdo ditë. Nëse arrijmë në një përfundim tjetër, mund të rezultojë në një situatë ku Presidenti i Kosovës mund të ndalohej nga kryerja e mbajtjes së funksionit të Zyrës së Presidentit për shkak të një shkeljeje kushtetuese por të lejohet të qëndrojë në postin e tij vetëm pse kërkesa e parashtruar në Gjykatën Kushtetuese nuk është dorëzuar në kohën e duhur. Nuk ekziston asnjë autoritet në Kushtetutë për një rezultat kaq irracional. Edhe Neni 45 i Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese nuk parasheh një rezultat të tillë kaq irracional.

34. Gjykata konsideron se afati kohor prej tridhjetë ditëve i përcaktuar nga Neni 45 i Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese lidhur me kërkesat për shkelje serioze pranë Gjykatës Kushtetuese, të cilat kanë ndodhur vetëm një herë ose që kanë qenë shkelje të vazhdueshme që kanë përfunduar dhe nuk ndodhin më. Afati kohor nuk mund të aplikohet në një shkelje serioze që vazhdon. Megjithatë, nëse shkelja vazhdon, afati kohor prej 30 ditësh nuk mund të fillojë pasi shkelja ende nuk ka përfunduar. Nëse Presidenti kishte dhënë dorëheqjen gjate presidencës së tij nga posti si Kryetar/President i LDK-se, atëherë afati kohor për të parashtruar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese, çfarë do të ishte në atë kohë, shkelje e kaluar, do të skadonte pas kalimit të afatit prej 30 ditësh duke filluar nga data e asaj dorëheqjeje. Në të kundërtën, akti i thjeshtë i deklarimit publik se ai e kishte ngrirë pozicionin e tij si Kryetar i LDK-së në një moment të caktuar, dhe si rrjedhojë, në të ardhmen nuk mund të kuronte natyrën e vazhdueshme të kësaj shkeljeje."<sup>17</sup>

17 Rasti Nr. KI 47/10, Naim Rrustemi dhe 31 Deputetët e Tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kundër Shkëlqesisë së Tij, Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, 28 shtator 2010, paragrafët 32-34 [theksi i autorit].

Për qëllime të këtij punimi, Gjykata Kushtetuese konstatoi se shkelja në fjalë ishte e vazhdueshme. Duke pasur parasysh natyrën e tillë të shkeljes, Gjykata Kushtetuese konstatoi se kërkesa nuk mund të refuzohej sipas nenit 45 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Lidhur me arsyetimin e lartpërmendur të Gjykatës Kushtetuese për shkeljen e vazhdueshme dhe ndikimin e saj në pranueshmërinë e kërkesës, mund të vërehet se ajo është në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe me mendimet e akademikëve të së drejtës.<sup>18</sup> Megjithatë, referenca në parimin e *shkeljes së vazhdueshme* të zhvilluar nga GJEDNJ<sup>19</sup> do ta bënte arsyetimin në rastin *Fatmir Sejdiu* jo vetëm logjik por edhe ligjërisht bindës kur merren parasysh kushtet e nenit 53 të Kushtetutës për interpretim në përputhje me GJEDNJ-në.

Rrjedhimisht, kjo analizë thekson se ndonëse vlen të vlerësohet fakti se Gjykata Kushtetuese rregullisht i referohet GJEDNJ-së, ajo referencë duhet të përfshijë edhe parimet e zhvilluara nga Gjykata e Strasburgut.

Çështja e dytë lidhur me Gjykatën Kushtetuese të Kosovës ka të bëjë me teknikat se si ajo i referohet dhe citon praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe burimet e tjera në vendimet e saj, që bëhet në mënyrë jo konsistente dhe nganjëherë edhe të mangët.<sup>20</sup> Ky vështrim vë në pah nevojën që Gjykata Kushtetuese të zhvillojë një sistem uniform të citimit. Për të siguruar që palët, praktikuesit, akademikët dhe opinionit i gjerë të mund të kuptojnë konsideratat që qëndrojnë pas argumentimit të Gjykatës, është e arsyeshme të pritët që Gjykata Kushtetuese të paraqes emrin e plotë të rastit në të cilin bazohet, të tregojë paragrafët e atij rasti në të cilët thirret, dhe kur është e

---

18 Shih p.sh., Zwaak 'The Procedure before the European Court of Human Rights', në P. Van Dijk, F. Van Hoof, A. Van Rijn et al. (eds), *Theory and Practice of the European Convention on Human Rights*, (2006), në 170. Zwaak konsideron se "data e veçantë e fillimit të afatit kohor aplikohet për rastet që përfshijnë të ashtuquajturën 'gjendje të vazhdueshme', ku shkelja nuk shkaktohet (vetëm) nga një veprim i bërë apo vendim i marrë në një moment të caktuar, por (po ashtu) edhe nga pasojat e tij, të cilat vazhdojnë duke e përsëritur kështu shkeljen çdo ditë".

19 Shih, p.sh., Rastin Papamichalopoulos dhe të tjerët kundër Greqisë, GJEDNJ, Aktgjykimi i Gjykatës (Dhomës) i datës 24 qershor 1993, paragrafët 40 dhe 46; Rasti Agrotexim dhe të tjerët kundër Greqisë, GJEDNJ, Aktgjykimi i Gjykatës (Dhomës) i datës 26 shtator 1995, paragrafët 56-58; Rasti Loizidou kundër Turqisë, GJEDNJ, Aktgjykimi i Gjykatës (Dhomës) i datës 18 dhjetor 1996, paragrafët 26-64.

20 Krahasoni citimet dhe referencat në rastet në vijim të përfunduara nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në të njëjtën ditë: Rasti nr. KI-08/11, Malush Sopa dhe të tjerët kundër Autoritetit të Panjohur Publik, Rezolutë për papranueshmëri e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, 24 prill 2012, paragrafi 56; Rasti nr. KI 56/11, NP Media Print: Shqyrtimi Kushtetuese i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ae.Nr.104/2009, të datës 21 shtator 2010, Rezoluta për papranueshmëri e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, 24 prill 2012, paragrafët 32-33.

nevojshme, të jap një arsyetim për rëndësinë e autoritetit. Kjo veçanërisht mund të konsiderohet si e pashmangshme duke pasur parasysh nenin 53 të Kushtetutës së Kosovës dhe procesin e zhvillimit të jurisprudencës cilësore të Gjykatës Kushtetuese.

Në përgjithësi, duhet theksuar së Gjykata Kushtetuese e Kosovës me gjyqtarët e saj vendorë dhe ndërkombëtarë ka qenë në gjendje që me kohë të zhvillojë një jurisprudencë të besueshme dhe bindëse e cila duhet shikuar si një praktikë e mirë që duhet pasuar nga gjykatat e rregullta. Sidoqoftë, duke pasur parasysh fushëveprimin e gjerë të neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk duhet të kufizohet veten në aplikimin e KEDNJ-së, por duhet të përfshihet në diskutimin edhe të instrumenteve të tjera të cekura në nenin 22 të Kushtetutës.

### **B. Panelet e përziera të gjyqtarëve të EULEX-it**

Në vendimet e marra nga panelet e përziera të gjyqtarëve të EULEX-it shpesh janë marrë parasysh nenet 22 dhe 53 të Kushtetutës së Kosovës në interpretimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me kornizën ligjore të Kosovës.

Në një rast penal kundër *Arben Krasniqit dhe të tjerëve*,<sup>21</sup> paneli i përzier i gjyqtarëve të EULEX-it i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës e trajtoj të drejtën e mbrojtjes për të kontestuar dëshmitë e të ashtuquajturit 'dëshmitari X' duke marrë parasysh kushtet e nenit 156(2) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK).<sup>22</sup> Paneli i përzier i gjyqtarëve të EULEX-it konstatoi se interpretimi i nenit 156(2) të KPPK-së duhet të jetë në përputhje me dispozitat e KEDNJ-së dhe me standardet e jurisprudencës së GJEDNJ-së, duke konstatuar se:

“Neni 22 i Kushtetutës e bën KEDNJ-në drejtpërdrejtë të zbatueshme në sistemin e brendshëm ligjor të Kosovës. Madje, neni 53 i Kushtetutës së Kosovës kërkon që 'të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut' ... Prandaj, Trupi Gjykses duhet të interpretojë nenin 156(2) të KPPK-së

21 Rasti P Nr. 425/11, rasti kundër Arben Krasniqit dhe të tjerëve, Vendimi mbi pranueshmërinë e deklaratave të Agim Zogajt (i njohur edhe si dëshmitari X), Gjykata e Qarkut e Prishtinës, 21 mars 2012.

22 Neni 156 (2) i KPPK përcakton që 'Deklarata e dëshmitarit e dhënë në polici ose para prokurorit publik mund të jetë provë e pranueshme në gjykatë vetëm kur të pandehurit ose mbrojtësit i është dhënë mundësia ta kundërshtojë atë nëpërmjet marrjes në pyetje të dëshmitarit gjatë ndonjë faze të procedurës penale'.

“mundësitë për kontestim’ në përputhje me konstatimet e GJEDNJ-së.”<sup>23</sup>

Paneli i përzier i gjyqtarëve të EULEX-it, duke ju referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së konstaton se mundësia për të kontestuar një dëshmitar duhet të jetë ‘adekuate dhe e duhur’.<sup>24</sup> Në këtë mënyrë, trupi gjykues i kushtoi vëmendje të duhur natyrës së neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës së Kosovës dhe përdori jurisprudencën e GJEDNJ-së për të sqaruar më tej dispozitat e KPPK-së në frymën e të drejtës kushtetuese për gjykim të drejtë.<sup>25</sup> Një referencë në dispozitat e KEDNJ-së dhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së mund të gjendet në vendimet e tjera të paneleve të përziera të gjyqtarëve të EULEX-it.<sup>26</sup>

Diskutime për KEDNJ-në dhe praktikën gjyqësore lidhur me të mund të gjenden edhe në Doracakun e gjyqtarëve të EULEX-it për çështjet e procedurës penale.<sup>27</sup> Edhe pse Doracaku ka mund të rriste vlerën dhe kontributin e vet po t’i referohej vendimeve konkrete, Doracaku shërben si udhëzim i çmueshëm për gjyqësorin vendor dhe praktikuesit e së drejtës.

### **C. Gjyqtarët Vendorë të Gjykatave të Rregullta dhe Sfidat në Zbatimin e të Drejtave Ndërkombëtare të Njeriut**

Janë bërë përpjekje të konsiderueshme për identifikimin e vendimeve të marra nga gjyqësori vendor të cilat përmbajnë referenca në nenet 22 dhe 53 të Kushtetutës. Në përgjithësi, nuk ka qenë e mundur të identifikohet një jurisprudencë e tillë,<sup>28</sup> dhe vetëm në tri vendime të një gjyqtari vendorë janë

23 Rasti Arben Krasniqi dhe të tjerët, shënimi më lartë 21, paragrafi 27.

24 Ibid., paragrafi 28.

25 Neni 31(4) i Kushtetutës së Kosovës për të drejtën e gjykimit të drejtë dhe të paanshëm thekson: ‘Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t’u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet’.

26 Shih, p.sh., shënimin më lartë 15, në 3; Rastin KA Nr. 417/11, Blerim Devolli dhe të tjerët, Vendimi për ankesën kundër vendimit për konfirmimin e akuzës dhe pranueshmërinë e dëshmimeve, paneli i përzier i gjyqtarëve të EULEX-it të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, 22 mars 2012, në paragrafët 9-10.

27 Gjyqtarët e EULEX-it Peeck dhe të tjerët në C. Rojek (ed), Doracaku: Tema të Zgjedhura për Procedurën Penale, (2012).

28 Kjo deklaratë është konfirmuar nga korrespondenca e autorit me Institutin Gjyqësor të Kosovës, Gjykatën Supreme të Kosovës dhe pas shqyrtimit të hollësishëm të jurisprudencës në dispozicion të Gjykatës Supreme të Kosovës.

identifikuar raster gjyqësore ku është zbatuar praktika gjyqësore e GJEDNJ.<sup>29</sup> Edhe pse vendimet e gjyqtarëve të UNMIK-ut<sup>30</sup> që nga viti 2002 kanë konstatuar se KEDNJ-ja “është pjesë integrale e sistemit ligjor të Kosovës”,<sup>31</sup> gjyqtarët vendorë të gjykatave të rregullta të Kosovës para dhe pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës në raste të caktuara kanë dështuar që të përmbushin kriteret e KEDNJ-së ose të konventave të tjera ndërkombëtare. Kjo veçanërisht është vërejtur në disa raporte të organizatave ndërkombëtare që kanë monitoruar gjyqësorin në Kosovë.<sup>32</sup>

Megjithatë, një hezitim i tillë për zbatimin e konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nuk derivon si rezultat i konsideratave të caktuara doktrinare apo ligjore. Arsyet e saj qëndrojnë në nivelin e pjekurisë së gjyqësorit, përfshirë edhe rëndësinë që gjyqtarët ua japin të drejtave të njeriut gjatë procesit gjyqësor, në ekspertizën në punën me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe praktikën gjyqësore, si dhe në qasjen në burimet në gjuhët e huaja. Këto sfida nuk janë unike vetëm për Kosovën por në shkallë të ndryshme kanë ekzistuar edhe në rendet e tjera juridike kur ato kanë filluar të zbatojnë të drejtën ndërkombëtare në sistemet e tyre të brendshme juridike.

29 Gjyqtari Bashkim Hyseni, Kryetari i Gjykatës Themelore të Ferizajit (ish gjykata Komunale e Ferizajit) në vendimet e veta i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ. Në rastet KP nr. 33/11 dhe KP nr. 100/12, Gjyqtari Hyseni jep shpjegim mbi interpretimin e konceptit „ dyshim i bazuar” duke ju referuar rastit Fox, Campbell dhe Heartly kunder Mbretërisë së Bashkuar, KEDNJ, Aktgjykimi i Gjykatës së 30 Gushtit 1990, parag.32. Në rastin e tretë P nr. 355/12 lidhur me masat për të siguruar praninë e të pandehurit, Gjyqtari Hyseni i referohet rastit I.A. kunder Francës, GJEDNJ, Aktgjykimi i Gjykatës të 23 Shtatorit 1998.

30 Shkurtesa UNMIK qëndron për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

31 Rasti AP – KZ Nr. 76/2002 kundër Ruzhdi Saramati, Vendimi i panelit të përzier të Gjyqtarëve të UNMIK-ut të Gjykatës Supreme të Kosovës, 9 tetor 2002, paragrafi 39. Për zbatimin e KEDNJ-së dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, po ashtu shih rastin AP Nr. 209/2002 kundër Xhavit Hasanit, Vendimi i panelit të përzier të gjyqtarëve të UNMIK-ut të Gjykatës Supreme të Kosovës, 13 gusht 2002, në 7; Rasti AP – KZ Nr. 263/2002 kundër Milorad Blagojeviçit, Vendimi i panelit të përzier të gjyqtarëve të UNMIK-ut të Gjykatës Supreme të Kosovës, 2 prill 2003, fq 6.

32 Sa i përket mos-respektimit të KEDNJ-së nga gjykatat e rregullta të Kosovës, shih p.sh., Misionin në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë – Departamenti për të Drejtat të Njeriut dhe Komunitete: Seksioni i Monitorimit të Sistemit Ligjor (OSBE), Raporti për ekzekutimin e vendimeve, Janar 2012, fq 11-18 (mund të gjendet në: <http://www.osce.org/kosovo/87004>, vizituar për herë të fundit: 19 shtator 2012); OSBE Raporti për procedurën e dëshmimeve në lëndët civile në Kosovë, Botimi 2, tetor 2011, fq 10-16 (mund të gjendet në: <http://www.osce.org/kosovo/83301>, vizituar për herë të fundit: 19 shtator 2012); OSBE Raporti mbi shqetësimet për konfirmimin e aktakuzës, Botimi 8, tetor 2010, fq 1-4 (mund të gjendet në: <http://www.osce.org/kosovo/73711>, vizituar për herë të fundit: 19 shtator 2012).

Prof. Stefan Oeter gjatë hulumtimit të moszbatimit të konventave për të drejtat e njeriut në gjykatat gjermane vërejtë se 'nëse autoritetet shtetërore, legjislatori ose organet gjyqësore shkelin të drejtat ndërkombëtare të njeriut, ato zakonisht nuk e bëjnë këtë me vetëdije për të shpërfillur të drejtat ndërkombëtare të njeriut. Ato thjeshtë nuk janë mësuar që të kenë gjithmonë parasysh të drejtat ndërkombëtare të njeriut.'<sup>33</sup>

Në analizën e hollësishme të arsyeve pse të drejtat ndërkombëtare të njeriut zbatohen rrallë në gjykatat gjermane, gjyqtari Bruno Simma në vitin 1997 theksoi se arsyet praktike në vijim e sqarojnë hezitimin e gjyqtarëve gjerman:

- “1. Normat e të drejtave ndërkombëtare të njeriut nuk janë pjesë e kurrikulës thelbësore në arsimin e së drejtës dhe në trajnimin praktik të juristëve dhe gjyqtarëve.
2. Disa gjykata mund të kenë vështirësi që të sigurojnë ... përkthimet ....
3. Qasja në tekstet e normave ndërkombëtare nganjëherë është dëshmuar të jetë e vështirë ...”<sup>34</sup>

Vështrimet më lartë tregojnë se çështja e moszbatimit të neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës së Kosovës nga gjyqtarët vendorë të gjykatave të rregullta i ka rrënjët e veta në arsimimin dhe trajnimin e gjyqtarëve, përfshirë edhe njohjen e gjuhëve të huaja, në njohjen e instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe në të kuptuarit e jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe rendeve të tjera juridike.

Duke ju përgjigjur sfidave të ngjashme në zbatimin e normave dhe standardeve ndërkombëtare disa shtete kanë krijuar mekanizma për të përmirësuar përmbushjen e kushteve ndërkombëtare dhe evropiane. Menjëherë pas anëtarësimit të Republikës Çeke në Bashkimin Evropian (BE), Gjykata Supreme Administrative e Republikës Çeke krijoi një njësi kërkimore të përbërë nga hulumtues të rinj të sferës së drejtësisë për të ndihmuar gjyqtarët rreth çështjeve që kishin të bënin me të drejtën e BE-së, të drejtën ndërkombëtare dhe të drejtën krahasuese.<sup>35</sup> Duke marrë parasysh kapacitetet e kufizuara të gjyqtarëve çek për të gjykuar në harmoni me të

33 Oeter, 'International Human Rights and National Sovereignty in Federal Systems: The German Experience', 47 WLR 871 (2001), fq 880.

34 Simma et al., 'The Role of German Courts in the Enforcement of International Human Rights', në B. Conforti dhe F. Francioni (eds), *Enforcing International Human Rights in Domestic Courts*, (1997), fq 107 [theksi i autorit].

35 Shih <http://www.nssoud.cz/Research-and-Documentation-Service/art/46?menu=287>, (vizituar për herë të fundit: 17 shtator 2012).



drejtën e BE-së dhe normat e tjera ndërkombëtare, ndihma që u është ofruar gjyqtarëve përmes ekspertizës se hulumtuesve të rinj duket si një masë adekuate dhe e duhur.<sup>36</sup>

Duke marrë parasysh mungesën e instrumenteve ndërkombëtare që zbatohen drejtpërdrejtë në jurisprudencën e gjyqësorit vendor të Kosovës, do të mund të mendohej se a do të ndihmonte një departament i ngjashëm kërkimor (hulumtues), të paktën për Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme, në përmirësimin e zbatimit të neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës së Kosovës.<sup>37</sup> Përveç kësaj, arsimimi dhe trajnimi i gjyqtarëve duhet të përfshijë në planprogramet e tyre instrumentet mbi të drejtat e njeriut dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës së Strasburgut që janë të zbatueshme përmes neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës së Kosovës.

## V. Përfundimet

Me përfshirjen e instrumenteve të caktuara ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të jurisprudencës së GJEDNJ-së përmes neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës së Kosovës, rendi juridik i Kosovës përmban një korpus tejet të çmueshëm të burimeve të së drejtës në sferën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Profesori Marc Weller nga Universiteti i Kembrijit thekson se Kushtetuta e Kosovës “posedon tërësinë e dispozitave më të avancuara në Evropë ose kudo tjetër sa i përket të drejtës së minoriteteve”.<sup>38</sup>

Përmes zbatimit të drejtpërdrejtë dhe epërsisë së tetë instrumenteve ndërkombëtare të cekura në nenin 22 të Kushtetutës, palët në procedurë gjyqësore në Kosovës mund të bazohen në masë të madhe në garancitë kushtetuese civile dhe politike (përfshirë të drejtat e minoriteteve) si dhe në të drejtat socio-ekonomike të DUDNJ-së. Megjithatë, referimi në KEDNJ, në KNDCP dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Strasburgut deri më tani mund të gjendet pothuajse vetëm në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe në panelet e përziera të gjyqtarëve të EULEX-it. Duke marrë parasysh natyrën e përkohshme të pranisë së gjyqtarëve ndërkombëtarë të EULEX-it dhe atyre të Gjykatës Kushtetuese, fati i zbatimit gjyqësor të neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës dhe të drejtës ndërkombëtare, në

36 Prezantimi i Zdeněk Kühn, Gjyqtar i Gjykatës Supreme Administrative të Republikës Çeke mbi “Zbatimin e ligjeve të BE-së në Republikën Çeke dhe Sllovaki: dy rrëfime të ndryshme”. Seminari Jean Monnet – Çështje të avancuara të së Drejtës Evropiane – Viti i parë i Traktatit të Lisbonës – Konsolidimi dhe Zgjerimi, mbajtur në Dubrovnik me 14 prill 2011.

37 Me Ligjin e ri për Gjykatat (Nr. 03/L-199), themelohet Gjykata e Apelit në Prishtinë si gjykata e shkallës së dytë (nenet 2, 17 dhe 18), ndërsa Gjykata Supreme kryesisht do të merret me mjetet e jashtëzakonshme juridike (neni 22).

38 Weller, supra note 11, në 257.

përgjithësi, qëndron në aftësinë dhe profesionalizimin e gjyqtarëve vendorë për të shfrytëzuar fushëveprimin e jashtëzakonshëm të këtyre dy dispozitave kushtetuese.

Për më tepër, gjuha e përdorur në nenet 22 dhe 53 të Kushtetutës së Kosovës e bën të obligueshme zbatimin dhe respektimin e instrumenteve të caktuara dhe praktikës gjyqësore ndërkombëtare. Si i tillë, zbatimi i tyre nuk është thjeshtë një alternativë, por obligim kushtetues i institucioneve të Kosovës, përfshirë këtu edhe gjyqësorin. Për të përmbushur këto obligime kushtetuese, autoritetet e Kosovës duhet të mendojnë që të ndërmarrin veprime të menjëhershme afatshkurtra dhe të angazhohen në planifikimin e një gjyqësori të qëndrueshëm që do të jetë në gjendje të përmbush kërkesat që derivojnë nga nenet 22 dhe 53 të Kushtetutës. Një plan i tillë afatshkurtër mund të përfshijë edhe themelimin e departamenteve për hulumtime juridike në gjykatat e larta të Kosovës, organizimin e trajnimeve të rregullta dhe ofrimin e materialeve për gjyqtarët lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Departamentet për hulumtime juridike duhet të tërheqin juristët e rinj me ekspertizë në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cilët kanë interesim për praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Përveç kësaj, Instituti Gjyqësor i Kosovës duhet tu ofrojë gjyqtarëve ekzistues kurse të obligueshme rreth zbatimit të instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të sigurohet që gjykatat e Kosovës kanë në dispozicion përkthimet në gjuhët zyrtare të tetë instrumenteve ndërkombëtare të cekura në nenin 22 të Kushtetutës dhe rastet më të rëndësishme gjyqësore të GJEDNJ-së. Ndonëse këto veprime mund të bëjnë të mundur që gjyqtarët të familjarizohen me të drejtat ndërkombëtare të njeriut, një plan i qëndrueshëm dhe afatgjatë duhet të pasqyrohet në arsimin e gjeneratave të ardhshme të juristëve. Instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe praktikat gjyqësore duhet të jenë pjesë e pandashme e programeve të dizajnuara për avokatët e ardhshëm, gjyqtarët, prokurorët dhe përgjithësisht për të gjithë ata që planifikojnë ta praktikojnë të drejtën.

Përvoja e vendeve të tjera në Evropën Qendrore dhe Lindore mund të shërbejë si pikë referimi për identifikimin e mjeteve që do të mund të përdoren për kalimin prej fazës së izolimit dhe shkëputjes nga e drejta ndërkombëtare në fazën e subordinimit (nënshtrim) ndaj të drejtës ndërkombëtare. Përveç kësaj, praktika e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe e gjyqtarëve të EULEX-it mund të ndihmojë që të kuptohet ndërveprimi dinamik në mes të drejtës vendore dhe të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Duke marrë parasysh aspiratat e Kosovës për tu bërë pjesë e sistemeve juridike të OKB-së, BE-së, Këshillit të Evropës dhe traktateve të tjera, gjyqësori i Kosovës duhet të jetë në gjendje të aderoj në marrëveshjet ndërkombëtare jo vetëm sa për të respektuar atë që përcakton kushtetuta e vendit në

nenet 22 dhe 53, por edhe për të respektuar obligimet ndërkombëtare që ka marrë Kosova, disa prej të cilave në nivel të traktateve ndërkombëtare duhet të zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në rendin e brendshëm juridik. Pavarësisht neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës së Kosovës apo anëtarësimi të Kosovës në organizatat ndërkombëtare, gjyqtarët e Kosovës duhet të përgatiten për të punuar në çështjet komplekse të traktateve dhe të praktikës gjyqësore ndërkombëtare në kontekstin e rendit të brendshëm juridik.

Të kuptuarit e sistemeve konvencionale dhe jurisprudencës ndërkombëtare (p.sh., të GJEDNJ-së) është vetëm pikënisja për një gjyqësor vendor kompetent. Veçoritë e marrëdhënieve në mes të së drejtës kombëtare dhe ndërkombëtare kërkojnë që gjyqtarët në *funksinin e tyre të dyfishtë (dédoublement fonctionnel)* të angazhohen jo vetëm në zbatimin mekanik të marrëveshjeve ndërkombëtare, por edhe të kërkojnë teknika të interpretimit dhe arsyetimit ligjor, që do të çonin drejt respektimit të ndërsjellë gjyqësor në adresimin e obligimeve të ndryshme ligjore, të cilat nganjëherë janë edhe kontradiktore.

Kushtrim Istrefi \*

## Ustavno odomaćivanje međunarodnih ljudskih prava u pravnom poretku Kosova

### Izvod

U proučavanju primene članova 22 i 53 Ustava Republike Kosovo ('Ustav Kosova' ili „Ustav”) ovaj dokument se usredsređuje na osoben proces odomaćivanja određenih konvencija, instrumenata i jurisprudencija u vezi sa ljudskim pravima u pravnom poretku Kosova. Članovi 22 i 53 Ustava daju visok stepen zaštite individualnih, građanskih i političkih prava i prava manjina. Pored toga, izvesna ekonomska i socijalna prava proizilaze iz obavezne primene Univerzalne deklaracije o ljudskim pravima (UDLJP) u pravnom sistemu Kosova. Pored osam međunarodnih konvencija i instrumenata za ljudska prava navedenih u članu 22 Ustava Kosova, Ustavni sud Republike Kosovo (Ustavni sud) i mešovita veća EULEX-ovih<sup>39</sup> sudija u velikoj meri primenjuju Evropsku konvenciju o ljudskim pravima ('EKLJP') i jurisprudenciju Evropskog suda za ljudska prava (ESLJP ili „Sud u Strazburu”). Nedovoljna primena članova 22 i 53 Ustava Kosova u jurisprudenciji domaćih sudija iz redovnih sudova na Kosovu daje signal da još uvek nisu u stanju da se izbore sa primenom međunarodnih ljudskih prava u pravosuđu.

### I. Uvod

Što se tiče načina na koji je međunarodno pravo uvršćeno u pravni poredak Kosova mogu se ustanoviti dva različita modela u Ustavu Kosova.

Prvi model se nalazi u članovima 17, 18 i 19 Ustava Kosova koji uređuju

---

39 \* PhD kand., LLM, gostujući predavač na Max Planck institutu za komparativno pravo i međunarodno pravo i asistent profesor na katedri za međunarodno pravo, Pravni fakultet Univerziteta u Prištini. Dokument je predstavljen na konferenciji u organizaciji Ustavnog suda 'Direktna primenljivost univerzalno prihvaćenih ljudskih prava na Kosovu: Novi imperativ u zakonskoj praksi', održanoj 29. juna 2012. godine. Želim da se direktno zahvalim Zani Ratnece i Majklu Kanifu na konstruktivnim komentarima. Takođe, zahvalan sam sudiji Bashkimu Hyseniju, koji je podelio sa mnom kopije njegovih sudskih odluka, koje su bile veoma korisne u izradi ovog priloga. Ovaj članak je napisan na engleskom jeziku i nije preveden na albanski i srpski jezik od strane autora. Dokument je napisan à titre personnel i mišljenja ne odražavaju mišljenja bilo koje institucije sa kojom je autor povezan.

Skraćenica EULEX predstavlja Misiju Evropske unije za vladavinu prava na Kosovu.

ratifikaciju međunarodnih ugovora od strane Republike Kosovo i dodeljuju direktnu primenljivost i nadmoć ratifikovanih međunarodnih ugovora.<sup>40</sup> U procesu ratifikacije relevantna postaje Bečka konvencija o zakonima o ugovorima iz 1969. godine (BKZU). Shodno BKZU, Republika Kosovo se može ograditi od određenih međunarodnih obaveza i, u ograničenim okolnostima, može se povući iz obaveza preuzetih ratifikacijom međunarodnih ugovora.<sup>41</sup>

Drugi model, preko kojeg je međunarodno pravo važeće u pravnom poretku Kosova se nalazi u članovima 22 i 53 Ustava. Ove dve odredbe zahtevaju da kosovske institucije primene i da se pridržavaju određenih konvencija, instrumenata i jurisprudencija u vezi sa ljudskim pravima. Samim tim, može se s pravom reći da prava predviđena navedenim izvorima ne potiču iz međunarodnog prava na koje se Kosovo obavezalo procesom ratifikacije, već više predstavljaju usađena domaća ustavna prava.<sup>42</sup>

Oba modela predviđaju ustavni model koji integriše domaće i međunarodno pravo. Ipak, drugi model je osoben zbog odomaćivanja i reprodukcije osam međunarodnih instrumenata iz sudske prakse Suda u Strazburu u pravni poredak Kosova. Deluje da je ovaj model rezultat 'međunarodnog uticaja' tokom procesa izrade Ustava Kosova. Sudija ESLJP-a Leh Garlicki govoreći o svom iskustvu izrade ustava u post-komunističkoj Evropi zaključuje:

'u odsustvu vojne intervencije i/ili ekonomskog pritiska, najcivilizovaniji način za nametanje određenih standarda u nacionalni proces izrade ustava jeste da se ti standardi učine 'univerzalnim' tako što su izraženi u normama međunarodnog prava. Te norme, kada se opunomoće dovoljnim obavezujućim ovlašćenjima, mogu unapred definisati sadržaj nacionalnih ustava, ne ostavljajući kreatorima drugu alternativu već da ih reprodukuju u tekstu ustava.'<sup>43</sup>

---

40 Videti posebno član 19 Ustava Kosova koji glasi kao što sledi: '1. Svaki međunarodni sporazum ratifikovan od strane Republike Kosovo, nakon što se objavi u Službenom listu Republike Kosovo, postaje deo unutrašnjeg pravnog sistema. Sporazum se sprovodi na direktan način, osim u onim slučajevima kada je to nemoguće i

kada sprovođenje istog zahteva donošenje novog zakona. 2. Ratifikovani međunarodni ugovori i pravno obavezujuće norme međunarodnog prava imaju premoć nad zakonima Republike Kosovo'.

41 Za ograđivanje u ugovorima, videti posebno član 19 BKZU. Za povlačenje iz ugovora pogledajte naročito članove 54 i 62 BKZU.

42 Takođe, norme međunarodnog običajnog prava primenljivog u kosovskom pravnom poretku kroz član 19.2. Ustava.

43 Garlicki, 'Demokratija i međunarodni uticaji', u G. Nolte (ed), *Ustavnost Evrope i SAD*, (2005), str 263.

Ovakvi 'međunarodni uticaji', ispitani kasnije, ipak su ograničeni na primenu međunarodnih instrumenata za ljudska prava i, preciznije, na zaštitu manjina i individualnih elementarnih prava.

Ovaj dokument razmatra osobenosti drugog modela koji se odnosi na odomaćivanje i pravosudnu primenu međunarodnih instrumenata i sudske prakse u vezi sa ljudskim pravima u pravnom poretku Kosova.

*Kao prvo*, ispitivanje se bavi delokrugom i primenom člana 22 Ustava. Ovaj deo ispituje međunarodne konvencije i instrumente za ljudska prava koji su direktno primenljivi u pravnom poretku Kosova kao više norme, sa posebnim akcentom na osobenosti UDLJP.

Dok član 22 Ustava imenuje konkretne međunarodne konvencije i instrumente za ljudska prava, član 53 Ustava zahteva da se ustavna prava i slobode tumače u skladu sa jurisprudencijom ESLJP-a. Samim tim se, *kao drugo*, raspravlja o delokrugu člana 53 Ustava.

*Kao treće*, doprinos se razvija ispitivanjem pravosudne primene dve ustavne odredbe od strane Ustavnog suda Kosova i mešovitih veća EULEX-ovih sudija, i utvrđuje izazove sa kojima se susreću domaće sudije u redovnim sudovima u vezi sa poštovanjem zahteva članova 22 i 53 Ustava.

*Kao poslednje*, diskusija se zaokružuje kratkim pregledom primerenosti članova 22 i 53 Ustava. Zaključci ističu zabrinutosti i navode da su kompetentnost i profesionalizam pravosuđa presudni da članovi 22 i 53 Ustava i međunarodno pravo generalno zažive u praksi.

## II. Delokrug člana 22 Ustava Kosova

Uobičajena je praksa u međunarodnom pravu da država postaje strana u sporazumu nakon što postane članica odgovarajuće međunarodne organizacije koja je sponzorovala dotični ugovor. Ova praksa je razvijena ne zato što država koja nije članica međunarodne organizacije nije kvalifikovana da unilateralno usvoji i primeni međunarodne ugovore međunarodne organizacije, već zato što članstvo u dotičnoj međunarodnoj organizaciji predviđa pravosudne i diplomatske mehanizme kojima se nadgleda realizacija tih međunarodnih ugovora. Na taj način, kada je država članica jedne međunarodne organizacije, primena međunarodnih ugovora postaje nužna delovanjem stranog zakona koji obično nadgleda međunarodna organizacija.

Na primer, državi koja nije članica Saveta Evrope sigurno nije zabranjeno da jednostrano usvoji i primeni EKLJP. Međutim, takva jednostrana primena EKLJP-a znači da država koja nije članica nije podložna pravnim lekovima

predviđenim u EKLJP-u. Ukoliko se bilo koja obaveza iz EKLJP-a prekrši od strane države koja nije članica, nije moguće podneti žalbu ESLJP-u za kršenje te obaveze.

Uprkos tome što Kosovo nije članica Ujedinjenih nacija (UN) i Saveta Evrope, u članu 22 svog Ustava je dobrovoljno i sredstvima domaćeg izbora odlučilo:

‘sledeći međunarodni ugovori i instrumenti koji se garantuju ovim Ustavom, direktno se primenjuju na teritoriji Republike Kosovo i imaju premoć, u slučaju konflikta, nad svim zakonskim odredbama i ostalim aktima javnih institucija:

- (1) Univerzalna deklaracija o ljudskim pravima;
- (2) Evropska konvencija o zaštiti ljudskih prava i osnovnih sloboda i protokoli iste;
- (3) Međunarodna konvencija o građanskim i političkim pravima i protokoli iste;
- (4) Okvirna konvencija Saveta Evrope o zaštiti nacionalnih manjina;
- (5) Konvencija o eliminisanju svih oblika rasne diskriminacije;
- (6) Konvencija o eliminisanju svih oblika diskriminacije žena;
- (7) Konvencija o pravima deteta;
- (8) Konvencija protiv mučenja i drugih okrutnih, nečovečnih i ponižavajućih postupaka

ili kazni. ...<sup>44</sup>

Vredno je uočiti da član 22 Ustava ugrađuje međunarodne instrumente sa težištem na građanska i politička prava, a izostavlja neke kao što su Međunarodni pakt o ekonomskim, socijalnim i kulturnim pravima (ICESCR). Kao takav, član 22 ne sadrži međunarodni instrument konkretno posvećen ekonomskim, socijalnim i kulturnim pravima. Neko bi mogao da tvrdi da je takva odluka tvoraca Ustava Kosova povezana sa razmatranjem finansijske perspektive imajući u vidu da je kosovska privreda u fazi nastajanja.<sup>45</sup> Drugo

44 Član 22 Ustava Kosova bukvalno je citat iz člana 2, Aneksa sveobuhvatnog predloga za rešenje statusa Kosova od 26. marta 2007. Sveobuhvatni predlog za rešenje statusa Kosova je izveštaj specijalnog izaslanika generalnog sekretara Ujedinjenih nacija, o budućem statusu Kosova.

45 Dok građanska i politička prava zahtevaju od država da se suzdrže od radnji koje bi mogle da ograniče ili prekrše individualna elementarna prava, član 2(1) ICESCR-a predviđa ‘svaka država strana u ovom ugovoru se obavezuje da će preduzeti korake, individualno i kroz

objašnjenje bi moglo da se poveže sa uticajem zapadnih zemalja u kreiranju Ustava Kosova. Pripremni rad u procesu izrade ICCPR-a i ICESCR-a predviđa da 'iako su zapadne zemlje jasno pokazale da daju prednost građanskim i političkim pravima, socijalističke zemlje su, suprotno od toga, postale sponzori ekonomskih, socijalnih i kulturnih prava'.<sup>46</sup> Na kraju, razlozi bi mogli da se traže u posebnim okolnostima stvaranja države Kosova. Po mišljenju autora, izvodljivije je da je kontekst uvođenja u život države Kosovo stvorio neophodnost da se institucije Kosova obavežu da će štititi manjinska i osnovna prava. Kako bi se to postiglo, međunarodni instrumenti sa naglaskom na građanskim i političkim pravima, su ugrađeni u Ustav, dok su instrumenti posvećeni konkretno ekonomskim, socijalnim i kulturnim pravima manje podesni za rešavanje ovih zabrinutosti.<sup>47</sup>

Pored osam instrumenata navedenih u Ustavu Kosova, UDLJP zahteva dodatno ispitivanje, u svetlu svoje različite pravne prirode.<sup>48</sup> Posebno zato što UDLJP sadrži deklaraciju, za razliku od drugih instrumenata koji se odnose na međunarodne ugovore. Takođe, socio-ekonomska prava koja su uključena u UDLJP-u zahtevaju naročitu pažnju.<sup>49</sup>

Iako je UDLJP neprocenjivo povezan sa univerzalizacijom ljudskih prava, sam UDLJP nije obavezujući pravni izvor.<sup>50</sup> Iako nema sumnje da je UDLJP služio kao izvor nadahnuća za izradu i usvajanje ICCPR, ICESCR, EKLJP i drugih instrumenata o ljudskim pravima, UDLJP ne stvara obavezujuće pravne obaveze za države u vezi sa njenom primenom. Ipak, dejstvom člana 22(1) Ustava Kosova, UDLJP predstavlja obavezujući dokument koji je neposredno primenjiv u pravnom poretku Kosova, i, pored toga, superioran u odnosu na druge kosovske zakone i akte javnih institucija.<sup>51</sup>

Kada se pogleda korpus prava zagantovanih u UDLJP-u, većina njegovih odredaba su identične ICCPR-u ili EKLJP-u. Samim tim, deluje da su odredbe

---

međunarodnu pomoć i saradnju, naročito ekonomsku i tehničku, u skladu sa svim dostupnim resursima, sa ciljem progresivnog postizanja pune realizacije prava prepoznatih Paktom svim odgovarajućim merama, uključujući naročito usvajanje zakonodavnih mera.

46 Kraven, 'Međunarodni pakt o ekonomskim, socijalnim i kulturnim pravima', u R. Hanski i M. Suksi (eds), *Uvod u međunarodnu zaštitu ljudskih prava*, (1999), str. 101. Videti takođe Z. Gruda, *Međunarodna zaštita ljudskih prava*, (2007), str. 37.

47 Za dodatne argumente videti npr., Garlicki, *supra* note 5, str 264-265.

48 Za realizaciju UDLJP u okviru Konvencije za zaštitu nacionalnih manjina u Ustavu Kosova, videti M.Weller, *Sporno Državljanstvo: Kosovska borba za nezavisnost* (2009), u 245 i 257.

49 Videti naročito članove 22 i 25 UDLJP-a.

50 UDLJP je usvojen Rezolucijom Generalne skupštine 217 A (III) 10. decembra 1948.

51 Za sličnu primenu UDLJP-a u domaćem pravnom poretku, videti član 2 deo II Aneksa Ustava Federacije Bosne i Hercegovine.



UDLJP-a, njihovom sadržinom, primenljive u pravnom poretku Kosova putem drugih ugrađenih međunarodnih instrumenata. Međutim, neka prava uneta u UDLJP-u su čisto ekonomska, socijalna i kulturna prava koja ne mogu da se nađu drugde u Ustavu Kosova. Pomenuću neka, član 22 UDLJP-a predviđa da 'svako, kao član društva, ima pravo na socijalno osiguranje'. Pored toga, član 25 UDLJP -a definiše značajnu listu socijalnih i ekonomskih prava:

„1. Svako ima pravo na standard života koji obezbeđuje zdravlje i blagostanje, njegovo i njegove porodice, uključujući hranu, odeću, stan i lekarsku negu i potrebne socijalne službe, kao i pravo na osiguranje u slučaju nezaposlenosti, bolesti, onesposobljenja, udovištva, starosti ili drugih slučajeva gubljenja sredstava za održavanje usled okolnosti nezavisnih od njegove volje.

2. Majke i deca imaju pravo na naročito staranje i pomoć. Sva deca, rođena u braku ili van njega, uživaju jednaku socijalnu zaštitu

Iako neko može upitati da li su odredbe UDLJP-a, naročito one koje se odnose na ekonomska i socijalna prava, dovoljno precizne da nalože svoju primenu, istovremeno, zakonodavac ima ustavnu obavezu da obezbedi neophodne mehanizme kojima će zaživeti ekonomska i socijalna prava nabrojana u članovima 22 i 25 UDLJP-a.

Pored UDLJP-a, i druge odredbe instrumenata koji proizilaze iz člana 22 Ustava Kosova uvode nova prava i slobode koje nisu eksplicitno date u Ustavu Kosova. Iako pravo na samoopredeljenje građana nije artikulirano u Ustavu Kosova, svakako je direktno primenjivo u pravnom poretku Kosova putem člana 1(1) ICCPR-a,<sup>52</sup> navedenom u članu 22(3) Ustava.

Sveukupno, uvrščivanje međunarodnih konvencija i drugih instrumenata u pravni poredak Kosova može biti smatrano kao pozitivna spremnost kosovskih institucija da ponude visok nivo zaštite elementarnih prava. Istovremeno, ona donosi i određena očekivanja, koja mogu postati vidljivija kada strane u sudskim postupcima počnu naširoko da se pozivaju na osam instrumenata člana 22 Ustava. U toj fazi razvoja, sudstvo i, moguće, druge državne institucije mogu se suočiti sa izazovima u definisanju delokruga i, najvažnije, popunjavanja sadržine u kosovskom kontekstu međunarodnih odredaba koje proizilaze iz člana 22 Ustava. Ovo može biti naročito težak zadatak u pogledu apstraktnijih odredaba iz osam međunarodnih instrumenata. Po mišljenju

52 Član 1(1) ICCPR-a predviđa da 'svi ljudi imaju pravo na samoopredeljenje. Dejstvom tog prava oni utvrđuju svoj politički status i teže svom ekonomskom, socijalnom i kulturnom razvoju.'

“32. [i]n the case of President Sejdiu it is necessary to look at the factual situation to see whether the holding of the office of President/Chairman of the LDK, ‘but freezing that position’, was a single event that occurred at one time or whether it amounts to a continuing day by day situation .... The President admits that he has continued to be the Chairman of LDK and President of Kosovo at all times since his election to the office of President in 2006.

33. If this is the case, the consequences of the freezing of the position continue and therefore there is a day by day ongoing situation. To conclude otherwise could result in a situation whereby the President of Kosovo could be barred from holding the Office of the President because of a constitutional violation, but be allowed to continue in office simply because a referral was not made to the Constitutional Court in a timely manner. Nowhere in the Constitution is there any authority for such an irrational result. Nor does Article 45 of the Law on the Constitutional Court envision such an irrational result.

---

92 Article 88 of the Kosovo Constitution provides: ‘1. The President shall not exercise any other public function.

2. After election, the President cannot exercise any political party functions.’

34. This Court considers that the time limit of 30 days set by Article 45 of the Law on the Constitutional Court, for referral of serious violations to the Constitutional Court, applies to serious violations that were one off events in time or were continuing violations that ceased. The time cannot apply to serious violations that continue. However where a violation is continuing the thirty days cannot commence to run because the violation has not ceased. If the President had at some stage in his Presidency resigned from the position of Chairman/President of the LDK then the time limit for making the Referral to the Constitutional Court, into what was then a past violation, would expire after the passing of 30 days from the date of that resignation. In contrast, the simple act of publicly stating that he was 'freezing' his position as President of LDK at a definite point of time and then into the future cannot cure the continuing nature of the violation."<sup>93</sup>

For the purposes of this contribution, the Constitutional Court found that the violation in question was continuous. In light of such a nature of the violation, the Constitutional Court regarded that the referral could not be precluded by operation of Article 45 of the Law on the Constitutional Court.

With regard to the aforementioned reasoning of the Constitutional Court as to continuous violation and its effects on admissibility of the referral it can be observed that it is compatible with the case law of the ECtHR and opinions of legal scholars.<sup>94</sup> However, the reference to the principle of *continuing violation* developed by the ECtHR<sup>95</sup> would have made the reasoning in *Fatmir Sejdiu* case not only logical but also legally persuasive in light of the requirements of Article 53 of the Constitution for consistent interpretation with the ECtHR.

Consequently, this analysis provides that while it is to be appreciated that the Constitutional Court makes regular reference to the ECtHR, that reference

93 Case No. KI 47/10, Naim Rrustemi and 31 other Deputies of the Assembly of the Republic of Kosovo v. His Excellency, Fatmir Sejdiu, President of the Republic of Kosovo, Judgment of the Constitutional Court of the Republic of Kosovo, 28 September 2010, at paras. 32-34 [emphasis added].

94 See e.g., Zwaak 'The Procedure before the European Court of Human Rights', in P. Van Dijk, F. Van Hoof, A. Van Rijn et al. (eds), *Theory and Practice of the European Convention on Human Rights*, (2006), at 170. Zwaak considers that "[a] special starting date for the time-limit applies to cases involving a so-called 'continuing situation', where the violation is not (only) caused by an act performed or a decision taken at a given moment, but (also) by its consequences, which continue and thus repeat the violation day by day".

95 See e.g., *Papamichalopoulos and Others v. Greece*, ECHR, Judgment of the Court (Chamber) of 24 June 1993, at paras. 40 and 46; *Agrotexim and Others v. Greece*, ECHR, Judgment of the Court (Chamber) of 26 September 1995, at paras. 56-58; *Loizidou v. Turkey*, ECHR, Judgment of the Court (Chamber) of 18 December 1996, at paras. 26-64.

should include also the principles developed by the Strasbourg Court.

The second issue regarding the Kosovo Constitutional Court is related to reference and citation techniques for the ECtHR case law and other sources in the Court's decisions, which is done in different and at times insufficient manner.<sup>96</sup> This observation echoes the necessity for the Constitutional Court to develop a uniform system of citation. To achieve that, parties, practitioners, academics, and a wider public are able to grasp the considerations underlying the Court's argument, it is a reasonable expectation that the Constitutional Court provides a full name of the case relied upon, indication of the paragraphs invoked in that case, and, where appropriate, a justification as to relevance of the authority. This particularly may be regarded as indispensable in light of Article 53 of the Kosovo Constitution, and in the process of developing a quality jurisprudence of the Constitutional Court.

Overall, it must be emphasized that the Constitutional Court of Kosovo with its domestic and international judges has been able to promptly develop a credible and persuasive jurisprudence that must be seen as a good pattern to follow for the regular courts. Nevertheless, in view of the magnificent breadth of Articles 22 and 53 of the Constitution, the Constitutional Court should not confine itself to application of the ECHR, and, where applicable, should engage in discussion on other instruments listed in Article 22 of the Constitution.

## **B. Mixed Panels of EULEX Judges**

In the decisions rendered by mixed panels of EULEX judges it is frequently that Articles 22 and 53 of the Kosovo Constitution are followed in interpretation of the fundamental freedoms and human rights guaranteed under the Kosovo legal framework.

In a criminal case against *Arben Krasniqi et al.*,<sup>97</sup> the mixed panel of EULEX judges of Pristina District Court examined the right of the defence to challenge evidence of the so called witness X in light of requirements of Article 156(2)

---

96 Compare the citations and references in the following cases rendered by the Constitutional Court of the Republic of Kosovo on the same day: Case No. KI-08/11, *Malush Sopa et al. v. Unknown Public Authority*, Resolution on Inadmissibility of the Constitutional Court of the Republic of Kosovo, 24 April 2012, at para. 56; Case No. KI 56/11, NP Media Print: Constitutional Review of the Judgment of the Supreme Court of Kosovo Ae.Nr.104/2009, dated 21 September 2010, Resolution on Inadmissibility of the Constitutional Court of the Republic of Kosovo, 24 April 2012, at paras. 32-33.

97 Case P No. 425/11, case against *Arben Krasniqi et al.*, Ruling on admissibility of Agim Zogaj's statements and diaries (also known as witness X), District Court of Pristina, 21 March 2012.

of the Kosovo Code of Criminal Procedure (KCCP).<sup>98</sup> The mixed panel of EULEX judges observed that the interpretation of Article 156(2) of the KCCP should be in compliance with the provisions of the ECHR and the standards of the ECtHR jurisprudence, by holding:

“Art.22 of the Constitution makes the ECHR directly applicable to the Kosovo domestic legal system. Furthermore, Art.53 of the Kosovo Constitution requires that ‘human rights and fundamental freedoms guaranteed by the Constitution are interpreted consistent with the court decisions of the European Court of Human Rights’... Therefore, the Trial Panel must interpret the KCCP Art.156 (2) ‘opportunity to challenge’ in line with the ECtHR’s findings.”<sup>99</sup>

The mixed panel of EULEX judges by referring to the case law of the ECtHR found that the opportunity to challenge a witness should be ‘adequate and proper’.<sup>100</sup> In this manner, the trial panel paid due regard to the nature of Articles 22 and 53 of the Kosovo Constitution and utilized the ECtHR’s jurisprudence to further clarify the provisions of the KCCP in light of the constitutional right to fair trial.<sup>101</sup> A similar reference to provisions of the ECHR and jurisprudence of the ECtHR may be found in other decisions of mixed panels of EULEX judges.<sup>102</sup>

Discussion on the ECHR and its case law can also be found in the Manual of EULEX judges on the issues of criminal procedure.<sup>103</sup> While the Manual could have increased its value and contribution by having reference to concrete decisions, the Manual serves as a valuable guideline also for domestic judiciary and legal practitioners.

98 Article 156 (2) of the KCCP provides that ‘[a] statement of a witness given to the police or the public prosecutor may be admissible evidence in court only when the defendant or defence counsel has been given the opportunity to challenge it by questioning that witness during some stage of the criminal proceedings.

99 Case Arben Krasniqi et al., supra note 21, at para. 27.

100 Ibid., at para. 28.

101 Article 31(4) of the Kosovo Constitution on the right to fair and impartial trial reads: ‘[e]veryone charged with a criminal offense has the right to examine witnesses and to obtain the obligatory attendance of witnesses, experts and other persons who may clarify the evidence’.

102 See e.g., supra note 15, at 3; Case KA No. 417/11, Blerim Devolli et al., Ruling upon appeals against ruling on confirmation of indictment and admissibility of evidence, mixed panel of EULEX judges of the District Court Pristina, 22 March 2012, at paras. 9-10.

103 EULEX Judges Peeck, et al., in C. Rojek (ed), Manual: Selected Topics on Criminal Procedure, (2012).

## Domestic Judges of the Regular Courts and Challenges in Application of International Human Rights

Significant efforts were put in place to identify decisions rendered by local judiciary which would contain reference to Articles 22 and 53 of the Constitution. Such reference generally was absent,<sup>104</sup> and only in three decisions of a local judge application of the ECtHR case law could be identified.<sup>105</sup> Even though decisions of UNMIK<sup>106</sup> judges as of 2002 have asserted that the ECHR 'constitute[s] an integral part of Kosovo legal system',<sup>107</sup> the domestic judges of Kosovo regular courts before and after entry into force of the Kosovo Constitution have occasionally failed to comply with requirements of the ECHR or other international conventions. Particularly this has been observed in several reports of international organizations engaged in monitoring of judiciary in Kosovo.<sup>108</sup>

However, it is not likely that such a reluctance to apply international conventions on the protection of human rights results from any doctrinal or legal considerations. The reasons rather lie behind maturity of the judiciary,

---

104 This statement is confirmed by correspondence of the author with the Kosovo Judicial Institute, Kosovo Supreme Court and after having thoroughly reviewed the available and accessible jurisprudence of the Kosovo Supreme Court.

105 Judge Bashkim Hyseni, President of Ferizaj Basic Court (former Ferizaj Municipal Court) has made references to the ECtHR case law in his court decisions. In cases KP no.33/11 and KP no. 100/12, Judge Hyseni explains the ECtHR's interpretation of the concept of a 'reasonable suspicion' by making a reference to the case *Fox, Campbell and Hartley v. The United Kingdom*, ECHR, Judgment of the Court of 30 August 1990, at para 32. In the third case P no.355/12 related to measures to ensure a defendant's presence, Judge Hyseni has made a reference to the case *I.A v. France*, ECHR, Judgment of the Court of 23 September 1998.

106 UNMIK abbreviation stands for the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo.

107 Case AP – KZ No. 76/2002 against Ruzhdi Saramati, Decision of mixed panel of UNMIK judges of the Supreme Court of Kosovo, 9 October 2002, at para. 39. On the application of the ECHR and the ECtHR case law see also Case AP No. 209/2002 against Xhavit Hasani, Verdict of mixed panel of UNMIK judges of the Supreme Court of Kosovo, 13 August 2002, at 7; Case AP – KZ No. 263/2002 against Milorad Blagojevic, Decision of mixed panel of UNMIK judges of the Supreme Court of Kosovo, 2 April 2003, at 6.

108 With regard to non-compliance of Kosovo regular courts with the ECHR, see e.g., the Organization for Security and Co-operation in Europe Mission in Kosovo – Department of Human Rights and Communities: Legal System Monitoring Section (OSCE), Report on Execution of Judgments, January 2012, at 11-18 (available at: <http://www.osce.org/kosovo/87004>, last visited: 19 September 2012); OSCE Report on Evidentiary Procedure in Civil Cases in Kosovo, Issue 2, October 2011, at 10-16 (available at: <http://www.osce.org/kosovo/83301>, last visited: 19 September 2012); OSCE Report on Confirmation of Indictment Concerns, Issue 8, October 2010, at 1-4 (available at: <http://www.osce.org/kosovo/73711>, last visited: 19 September 2012).



including, the place which human rights play in minds of judges in the process of adjudication, expertise in work with international human rights instruments and case law, as well as accessibility of the sources in the official languages. Such challenges are not anything unique particularly for Kosovo but to varying degrees have been present in other legal orders in the beginnings of application of international law in national legal orders.

Professor Stefan Oeter in surveying the period of non-application of international human rights conventions in German courts observed that '[i]f state authorities, the legislator or judicial organs violate international human rights, they usually do not do so with the conscience of disregarding international human rights. They are simply not accustomed to keeping international human rights foremost in mind.'<sup>109</sup>

In scrutinizing the reasons for the rare application of international human rights in German courts, Judge Bruno Simma in 1997 wrote that the following practical reasons explained the reluctance of German judges:

- “1. International human rights norms are not part of the core curricula in the legal education and practical training of lawyers and judges.
2. Some courts may have difficulties in obtaining ... translations ....
3. Access to the texts of international norms sometimes proves to be difficult ...”<sup>110</sup>

From the foregoing observations, one can draw that the non-application of Articles 22 and 53 of the Kosovo Constitution by domestic judges of the regular courts likely have its roots in the education and training of judges, including knowledge of foreign languages, international human rights instruments and understanding of jurisprudence of the ECtHR and other legal orders.

In response to similar challenges in application of international norms and standards some States established mechanisms to enhance compliance with international and European requirements. Immediately after accession of Czech Republic to the European Union (EU), the Supreme Administrative Court in Czech Republic established a research unit composed of young legal researchers to assist judges on the issues related to the EU law, international law and comparative law.<sup>111</sup> Considering the limited capacities of Czech judges

109 Oeter, 'International Human Rights and National Sovereignty in Federal Systems: The German Experience', 47 WLR 871 (2001), at 880.

110 Simma et al., 'The Role of German Courts in the Enforcement of International Human Rights', in B. Conforti and F. Francioni (eds), *Enforcing International Human Rights in Domestic Courts*, (1997), at 107 [emphasis added].

111 See <http://www.nssoud.cz/Research-and-Documentation-Service/art/46?menu=287>,

to adjudicate in harmony with the EU law and other international norms, it seemed that an adequate and prompt measure was to assist judges with the expertise provided by young scholars.<sup>112</sup>

In view of absence of the directly applicable international instruments in jurisprudence of Kosovo local judiciary, it could be considered if a similar research department, at least at the Court of Appeals and the Supreme Court would enhance the implementation of Articles 22 and 53 of the Kosovo Constitution.<sup>113</sup> In addition, education and training of judges should include curriculum on the human rights instruments and the Strasbourg Court case law applicable through Articles 22 and 53 of the Kosovo Constitution.

## V. Conclusions

With the domestication of certain international human rights instruments and the ECtHR jurisprudence through Articles 22 and 53 of the Kosovo Constitution, Kosovo legal order contains a corpus of invaluable legal sources on protection of human rights and fundamental freedoms. With regard to protection for minorities, Professor Weller from Cambridge University asserts that the Kosovo Constitution 'represents the most advanced set of minority rights provisions in Europe or anywhere else'.<sup>114</sup>

By virtue of direct applicability and supremacy of the eight international instruments laid down in Article 22 of the Constitution, parties to proceedings in Kosovo courts can extensively rely on civil and political (including minority) constitutional guarantees as well as socio-economic rights of the UDHR. However, reference to the ECHR, ICCPR and the Strasbourg Court case law until now can be found primarily in jurisprudence of the Kosovo Constitutional Court and mixed panels of EULEX judges. Considering the temporary nature of presence of international EULEX and Constitutional Court judges in Kosovo, the fate of judicial application of Articles 22 and 53 of the Constitution, and international law, more generally, rests on capability and professionalism of local judges to utilize the magnificent scope of these two constitutional provisions. Furthermore, the language of Articles 22 and 53 of the Kosovo Constitution makes it mandatory to implement and comply with

---

(last visited: 17 September 2012).

112 Presentation of Zdeněk Kühn, Judge of the Supreme Administrative Court of the Czech Republic on 'The application of EU law in the Czech Republic and Slovakia: two different narratives'. Jean Monnet Seminar – Advanced Issues of European Law – The First Year of the Treaty of Lisbon – Consolidation and Enlargement, 14 April 2011 held in Dubrovnik.

113 The new Law on Courts (No.03/L-199), establishes the Court of Appeals in Pristina as the second instance court (Articles 2, 17 and 18), while the Supreme Court will be primarily dealing with extraordinary legal remedies (Article 22).

114 See Weller at supra note 11, at 257.

the specified international instruments and case law. As such, their application is not merely an alternative, but a constitutional obligation on part of Kosovo institutions, including judiciary. In order to comply with those constitutional demands, Kosovo authorities should consider immediate short-term actions and engage in planning a sustainable judiciary that is competent to cope with the requirements of Articles 22 and 53 of the Constitution. A short-term plan could include the establishment of legal research departments at higher courts of Kosovo, and organizing regular trainings and providing materials to judges on the pertinent human rights issues. The legal research departments should attract young lawyers with expertise in international human rights law and an interest in the ECtHR case law. In addition, the Kosovo Judicial Institute should offer mandatory courses for current judges on the application of international human rights instruments. The Kosovo Judicial Council should ensure that translations into official languages of the eight international instruments in Article 22 of the Constitution, and the most important practice of the ECtHR are provided to Kosovo courts. While these actions could facilitate that judges become accustomed to international human rights, a sustainable plan must reflect on the education of future generations of lawyers. International human rights instruments and case law should be an indispensable component of the programmes designed for future attorneys, judges, prosecutors, and law appliers generally.

The experience of other countries in Central and Eastern Europe could serve as a reference in identifying the tools, which could be utilized in the transition from isolation and detachment from international law to subordination to international law. In addition, practice of the Kosovo Constitutional Court and EULEX judges could assist in understanding the vivid interaction between domestic and international human rights.

In view of Kosovo's aspirations to join the UN, EU, Council of Europe and other treaty regimes, Kosovo judiciary must be able to adhere to international agreements not only for the purpose of compliance with domestic constitutional choices under Articles 22 and 53 of the Constitution, but also to honour international obligations undertaken by Kosovo, some of which at the international treaty level would require direct application and supremacy in the domestic legal order. Hence, Kosovo judges should be equipped to engage in complexities of international treaties and case law in the context of national legal order. Understanding of the conventional systems and international jurisprudence (e.g. ECtHR) is only a starting point of a competent local judiciary. Peculiarities of the relationship between national and international law require that judges in their *dédoublement fonctionnel* engage not only in mechanical application of international agreements, but also quest for techniques of legal interpretation and legal reasoning that lead to judicial comity when addressing different and sometimes conflicting legal obligations.

Visar Morina 1\*

## **Aktgjykimet dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës – roli i precedentit dhe fushëveprimi i nenit 116.1 të Kushtetutës së Kosovës**

### **I. Hyrje**

Ky punim do të shqyrtoj natyrën juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe do të vlerësoj përmasat e detyrimeve juridike të vendimeve kushtetuese në të ardhmen, në veçanti për sa i takon organeve gjyqësore dhe autoriteteve publike. Me fjalë të tjera, punimi do të hedh shikim lidhur me çështjen nëse, dhe në ç'masë vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës prodhojnë efekte detyrimore juridike në të ardhmen dhe a kanë vendimet e tilla efekte të së drejtës së precedentit për gjyqësorin dhe autoritetet publike në përgjithësi. Fillimisht do të analizoj mandatin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, dhe më pas do të shqyrtoj natyrën e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Duke u mbështetur në kategorizimin e Steinbergerit lidhur me efektet juridike të vendimeve të gjykatave kushtetuese, do të analizoj natyrën e efekteve juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe do të shqyrtoj nëse këto vendime prodhojnë efekte të precedentit në sistemin juridik të Republikës së Kosovës, i cili esencialisht nuk mbështetet në të drejtën e precedentit si burim i së drejtës.

### **II. Kompetencat e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës**

Kushtetuta e Kosovës e vitit 2008 solli risi në kontekst të organizimit institucional dhe kushtetues.<sup>2</sup> Ndërtimi i një sistemi të centralizuar të kontrollit

1 \* Prof. Dr. Visar Morina është ligjërues në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës në lëndën e drejta kushtetuese dhe gjyqësia kushtetuese dhe këshilltar ligjor në Programin për Sundimin Efektiv të Ligjit në Kosovë (USAID/EROL). Ky punim është prezantuar në Konferencën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës lidhur me aplikueshmërinë direkte të të drejtave universalisht të pranuar ndërkombëtare: Imperativ i ri në praktikën e së drejtës mbajtur në Prishtinë më 29 qershor 2012. Mendimet e shprehura janë qëndrime personale të autorit dhe nuk reflektojnë mendime institucionale.

2 Kushtetuta e Kosovës ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008 pak muaj pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008. Kushtetuta është e arritshme në faqen zyrtare të Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës në <http://gazetazyrtare.rks-gov.net/>.

kushtetues në Kosovë u shëndërrua në mekanizëm të pazëvendësueshëm për mbrojtjen e kushtetutës dhe interpretimin e saj, pas dy dekada shkëputjeje nga një traditë e kontrollit kushtetues që sa kishte filluar të zë vend në Kosovë. Themelimi i Gjykatës Kushtetuese plotësoi një vakum institucional, duke krijuar mundësinë për qytetarët që të kërkojnë drejtësi kushtetuese në rastet kur liritë dhe të drejtat e tyre kushtetuese çënohen nga autoritetet publike. Neni 112 i Kushtetutës së Kosovës nënvizon se “gjykata kushtetuese është autoriteti përfundimtar për të vendosur lidhur me përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën si dhe për interpretimin e Kushtetutës”. Një lexim i kujdesshëm i kësaj dispozite kushtetuese lë të kuptoj se të drejtën për interpretim kushtetues e gëzon çdo individ apo institucion në mënyrë që të mund të akordoj veprimet dhe praktikën e tyre në përputhje me normën kushtetuese. Megjithatë, e drejta për të dhënë vendime përfundimtare lidhur me interpretimin e Kushtetutës në Kosovë është i është atribuar vetëm Gjykatës Kushtetuese, e cila vepron si autoritet i centralizuar për të dhënë interpretime kushtetushmërisht të detyrueshme si dhe për të përcaktuar caqet e lejuara kushtetuese të veprimeve ose lëshimeve të autoriteteve publike. Vëllimi i kompetencave të Gjykatës Kushtetuese është i gjerë dhe përfshin procedura të kontrollit abstrakt dhe konkret të kushtetushmërisë. Sipas nenit 113 të Kushtetutës së Kosovës, Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të vejnë në lëvizje procedurën e kontrollit kushtetues lidhur me:

- (1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekretëve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;
- (2) përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën.

Për më tepër, Kuvendi, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të vejnë në lëvizje edhe procedurat e kontrollit kushtetues para Gjykatës Kushtetuese në lidhje me

- (1) konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;
- (2) përputhshmëria e referendimit të propozuar me Kushtetutën;
- (3) përputhshmëria e shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme me Kushtetutën;

- (4) përputhshmëria e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute dhe rishikimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur;
- (5) nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit.

Komunat autorizohen të kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë nëse përmes tyre çënohen përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës si dhe në rast se komuna përkatëse janë afektuar nga ai ligj ose akt.<sup>3</sup> Individët janë poashtu të autorizuar të referojnë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shterrur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.<sup>4</sup> Për më tepër, gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë. Gjykata referuese duhet të shpjegoj në detaje pse konsideron dispozitat përkatëse ligjore të jenë në kundërshtim me Kushtetutën dhe pse të vendosurit e rastit konkret varet nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me vlefshmërinë kushtetuese të ligjit.

### III. Një hap para drejt një sistemi “miks” të së drejtës?

Përcaktimi i asaj se çfarë përbën burim të së drejtës (ang. “source of law”) varet mjaft nga ajo se çfarë është natyra e sistemit juridik. Në disa raste, përcaktimi i burimit juridik përcaktohet me ligj, si për shembull neni 1.1 i Kodit Civil të Spanjës i cili përcakton se burime të së drejtës në Spanjë janë ligjet, zakonet dhe parimet e përgjithshme të së drejtës.<sup>5</sup> Një përmbledhje të ngjashme e gjejmë edhe në Kodin Civil të Italisë ku neni 1 përcakton një lloj hierarkie të akteve juridike.<sup>6</sup> Disa nene kushtetuese nuk saktësojnë në mënyrë të qartë llojet e burimeve të së drejtës apo tipin e tyre por vetëm nënvizojnë disa burime të cila konsiderohen si mjaft relevante.<sup>7</sup> Për shembull neni 55 i Kushtetutës së Francës përcakton në mes tjerash se në parim traktatet

3 Kushtetuta e Kosovës, neni 113.4.

4 Kushtetuta e Kosovës, neni 113.7.

5 Stefan Vogenhauer, “Sources of Law and Legal Method in Comparative Law” në Oxford Handbook of Comparative Law (Oxford, Oxford University Press, 2006) f. 880.

6 Ibid. f. 880.

7 Ibid, f. 880.

ndërkombëtare mbizotërojnë ndaj ligjeve të miratuara nga parlamenti. Disa shtete, megjithatë nuk përcaktojnë tipet e burimeve të së drejtës, por përjashtojnë në kuptim negativ disa forma të cilat nuk konsiderohen burime të së drejtës. Për shembull, neni 5 i Kodit Civil të Francës të vitit 1804 ndalon gjyqtarët që të japin vendime në bazë të vendimeve gjyqësore të dhëna më herët duke konsideruar zbatimin e precedenteve si të jashtëligjshme.<sup>8</sup> Një qasje të ngjashme e ndjek edhe Kodi Civil Austriak i vitit 1811 ku në nenin 12 ndalon që zakonet të jenë burime të së drejtës për aq kohë sa nuk janë të përcaktuara me legjislacion.<sup>9</sup>

Në kontekst të ndarjes klasike të familjeve juridike në botë “jo nga pikëpamja ideologjike por nga pikëpamja teknike”, sistemi juridik i Republikës së Kosovës graviton në mënyrë të konsideruar kah sistemi kontinental-evropian, sistem ky i cili konceptualisht nisët nga abstraksionet, parimet e përgjithshme, dhe dallon rregullat përmbajtësore (materiale) nga rregullat procedurale, si dhe nga përparësia e teksteve të shkruara legjislative.<sup>10</sup> Ky sistem mbështetet në konceptin se ligji (e drejta e shkruar) paraqet referencë primare për zgjidhjen e kontesteve juridike duke zhvendosur së këndejmi rëndësinë e precedentit si burim i së drejtës në procesin e zgjedhjes së kontesteve juridike. Epërsia e ligjit në raport me precedentin reflektohet edhe në Kushtetutën e Kosovës ku në nenin 102 para. 3 përcaktohet në mënyrë decisive se “gjyqtarët gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit”. Por kjo nuk nënkupton domosdomërisht se përdorimi i precedentit si burim plotësues i së drejtës në sistemin tonë juridik është i përjashtuar. Siç do të analizojmë në vijim, një vendim i Gjykatës Kushtetues në një çështje konkrete fiton epitetin e precedentit përmes gjeneralizimit të normës individuale mbështetur në një vendim gjyqësor. Ky koncept i krijimit të normave të përgjithshme përmes vendimit gjyqësor (e drejta e precedentit) është analizuar nga Hans Kelsen, i cili duke komentuar aspektin e hierarkisë së normave juridike argumenton se në bazë të kësaj norme të përgjithshme (të krijuar nga vendimi gjyqësor) është e mundshme që të vendoset se rastet e tjera janë të ngjashme në rradhë të parë me vendimin e parë, vendimi i së cilës konsiderohet precedent dhe rastet e tjera do të vendosen në mënyrë të ngjashme.<sup>11</sup> Refuzimi i krijimit gjyqësor të së drejtës (judge made law) erdhi si pasojë e abuzimeve gjyqësore gjatë mesjetës, si dhe me materializimin e parimit të ndarjes së pushteteve ku ligjet zbatoheshin si kanune matematikore në raste konkrete duke evituar mundësin e zbatimit të diskrecionit dhe të precedentit në

8 Shih Kodin Civil të Francës në version anglisht në [http://www.legifrance.gouv.fr/content/download/1950/13681/version/3/file/Code\\_22.pdf](http://www.legifrance.gouv.fr/content/download/1950/13681/version/3/file/Code_22.pdf) (12 Korrik 2012).

9 Vogenhauer, vep. cit. 4, f. 880.

10 Ibid. f. 880

11 Hans Kelsen, “General Theory of Law and State” (New Jersey, Law Book Exchange, 2009) f.149.

funksion të zgjedhjes së kontesteve gjyqësore. Megjithatë, kohëve të fundit në forume shkencore ka filluar të dominoj mendimi se familjet juridike nuk duhet parë të izoluar nga njëra tjetra për faktin se ato ndajnë veçori të përbashkëta në mes tyre. Duke patur parasysh këtë diversitet të burimeve juridike sot më tepër mund të flasim për një sistem të përzier të së drejtës duke marrë parasysh shumëllojshmërinë e burimeve juridike dhe tipet (llojet) e këtyre burimeve juridike sesa për një sistem të pastër i cili mbështetet në vetëm një burim të së drejtës duke përjashtuar forma të tjera të së drejtës. Për shembull, ndonëse Anglia njihet si djep i sistemit “common law”, ligjet e miratuara nga parlamenti Britanik së bashku me të drejtën në krijim të Bashkimit Evropian tanimë konsiderohen burime relevante juridike atje.<sup>12</sup> Një sistem të përzier të burimeve të së drejtës e gjejmë edhe në Kosovë. Pavarësisht faktit se në Kosovë ligji konsiderohen burim relevant juridik për zgjedhjen e kontesteve juridike, që në masë të konsideruar është refleksion i së kaluarës juridike të Kosovës, Kushtetuta e Kosovës ka bërë hapin e parë drejt njohjes së praktikës gjyqësore si instrument për zgjedhjen e çështjeve juridike të cilat objekt shqyrtimi kanë kufizimet në liritë dhe të drejtat e njeriut. Neni 53 i Kushtetutës së Kosovës është indikator më i qartë në këtë drejtim, i cili vë detyrim kushtetues për autoritetet publike, përfshirë gjykatat, që interpretimin e lirive dhe të drejtave të njeriut të përcaktuara me Kushtetutë ta bëjnë në përqsje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (këndeje e tutje “GJEDNJ”). Detyrimi kushtetues për të respektuar përvojën e Strasburgut në interpretimin e lirive dhe të drejtave të njeriut përbën një situatë të pastërt të legjitimitit të precedentit në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut në sistemin juridik, praktikë kjo tërësisht e re në fushën e jurisprudencës kosovare. Përdorimi i precedentit jo vetëm që plotëson sfondin e vendimmarrjes gjyqësore në Kosovë por është imperativ për gjyqësorin dhe autoritetet publike saherë që konfrontohen me çështje që objekt shqyrtimi kanë liritë dhe të drejtat e njeriut duke kërkuar marrjen në konsideratë të përvojës së Strasburgut në zgjidhjen e çështjes.

## A. Hierarkia juridike

Pasi burimet juridike janë kryesisht të fragmentuara, në disa shtete radhitja e akteve normative sipas epërsisë së tyre juridike përcaktohet me akte kushtetuese. Sipas Kushtetutës së Shqipërisë aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë përfshijnë a) Kushtetutën b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara; c) ligjet; ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave” duke ofruar në këtë mënyrë një panoramë të qartë

12 Martin Dixon, “International Law” (Oxford, Oxford University Press, 2007) p. 25. Shih poashtu Gary Slapper, David Kelly, “The English Legal System” (Taylor & Francis, 2011).



të rangimit të akteve normative sipas epërsisë së tyre në sistemin juridik.<sup>13</sup> Kushtetuta e Kosovës nuk adreson rangimin e akteve juridike në një nen të veçantë. Megjithatë, Kushtetuta ofron një orientim lidhur me hierarkinë e akteve juridike në Kosovë në disa nene të veçanta të cilat do ti trajtojmë në vijim. Neni 16 trajton epërsinë e Kushtetutës duke përcaktuar se “Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës.”<sup>14</sup> Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë.” Për më tepër, neni 19 para. 2 i Kushtetutës së Kosovës trajton zbatimin e së drejtës ndërkombëtare në Kosovë duke përcaktuar në mes tjerash se “marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës”. Për më tepër, neni 53 i Kushtetutës përcakton se “të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”. Rrjedhimisht, piramida e akteve juridike në Kosovë sipas fuqisë juridike do të përfshinte Kushtetutën, marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare dhe aktet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të përcaktuara me nenin 22 të Kushtetutës, ligjet e miratuara nga Kuvendi, dekretet e Presidentit dhe Rregulloret e Qeverisë. Megjithatë, nëse i referohemi anës përmbajtësore të nenit 53 të Kushtetutës së Kosovës dhe implikimeve që prodhon në kuptimin juridiko-kushtetues, atëherë lista e burimeve juridike në Kosovë plotësohet edhe me institucionin e precedentit, të cilin do ta shtjellojmë në vijim.

## B. Definimi i precedentit

Përkufizimi më i zakonshëm i precedentit nënkupton vendimin e gjykatës që është përmendur si një shembull apo analogji për të zgjidhur çështje të ngjashme në rastet e mëvonshme.<sup>15</sup> Si një instrument për të siguruar

13 Kushtetuta e Shqipërisë, neni 116.

14 Në shtator 2012 Kuvendi i Kosovës ka miratuar 22 amendamente kushtetuese miratimi i të cilave shënon fundin e mbikqyrjes ndërkombëtare në Kosovë. Në mesin e këtyre amendamenteve të shfuqizuara që ka patur ndikim të drejtpërdrejtë në hierarkinë juridike ka qenë neni 143 i Kushtetutës së Kosovës i cili kishte përcaktuar: “Të gjitha autoritetet në Republikën e Kosovës veprojnë në pajtim me të gjitha detyrimet e Republikës së Kosovës sipas Propozimit Gjithpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007. Ato do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e tyre. Dispozitat e Propozimit Gjithpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007 kanë epërsi ndaj të gjitha dispozitave të tjera ligjore në Kosovë. Kushtetuta, ligjet dhe aktet tjera ligjore të Republikës së Kosovës interpretohen në pajtueshmëri me Propozimin Gjithpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007. Në rast se ka papajtueshmëri midis dispozitave të kësaj Kushtetute, ligjeve dhe akteve të tjera ligjore të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të marrëveshjes, kjo e fundit do të mbizotërojë.” Për më tepër shih Gazetën Zyrtare të Kosovës Nr. 25/07, të shtatorit 2012.

15 Lidhur me natyrën e precedentit dhe efektet juridike të tij shih Evan H. Caminker,

uniformitet në procesin e vendimarrjes gjyqësore, e drejta e precedentit gjen formën e saj më të pastërt në modelin “*common law*” të së drejtës kur përmes parimit “*stare decisis*” (që nënkupton të qëndrosh pranë gjërave të gjykuara më herët), gjykatat mbështeten në vendimet e dhëna më herët në zgjedhjen e kontesteve juridike. Në komentet e tij mbi të drejtën angleze, juristi i njohur anglez William Blackstone ka qenë një nga autorët e hershëm që ka trajtuar rëndësinë e precedentit për zhvillimin e së drejtës. Blackstone kishte definuar precedentin si një detyrim të përgjithshëm për gjyqësorin duke theksuar se precedenti ruan integritetin e gjykatës dhe në të njëjtën kohë shërben për të mbajtur sistemin e drejtësisë në një shkallë të qëndrueshme si dhe për të siguruar një lloj stabiliteti juridik.<sup>16</sup> Detyrimi për të respektuar precedentin nga gjykatat federale ishte evident edhe në argumentet juridike të Aleksandër Hamiltonin në kuadër të Letrave të Federalistit Nr.78. Hamiltoni kishte avokuar konceptin për natyrën detyruese të precedentit duke sugjeruar respektimin e precedentit në të gjitha rrethanat. Hamilton kishte potencuar se zbatimi i precedentit është i nevojshëm për të shmangur një liri arbitrare në gjykata duke përfaqëuar idealin për një zbatim uniform të drejtave të Kushtetutës.<sup>17</sup> Por institucioni i precedentit dhe implikimeve juridike që prodhon kishte tërhequr edhe vëmendjen e juristit të njohur amerikan James Kent, i cili në komentarin e tij për të drejtën amerikane kishte theksuar se “gjyqtarët janë të detyruar të ndjekin atë vendim për aq kohë sa ai qëndron i pandryshuar, përveç nëse mund të tregohet se ligji është keqkuptuar ose keqzbatuar në këtë rast të veçantë. Nëse një vendim gjyqësor është bërë me një gjuhë mirë të argumentuar dhe shqyrtime të pjekura kushtetuese, supozimi është në favor të korrektësisë së zbatimit të precedentit; dhe komuniteti juridik jo vetëm që mund, por duhet ta konsiderojë atë si një burim juridik të drejtës apo forcë të ligjit për të rregulluar veprimet e tyre dhe kontrastet që burojnë në bazë të atij vendimi”.<sup>18</sup>

---

Why Must Inferior Courts Obey Superior Court Precedents? *Standard Law Review* Vol. 46, No. 4 (Apr., 1994), 817-87; Thomas Lee, “Stare decisis in historical perspective: from the founding era to the Rehnquist court”. *52 Vanderbilt Law Review* 647 (1999); Polly J. Price, “A Constitutional Significance for Precedent: Originalism, Stare Decisis, And Property Rights”. *Ava Maria Law Review* (2007). Charles Cooper, “Stare decisis: precedent and principle in constitutional adjudication”, *73 Cornell Law Review* 401, 1987-1988; Michael J. Gerhardt, “The Role of Precedent in Constitutional Decisionmaking and Theory”. *60 Geo. Wash. L. Rev.* 68, 1991-1992.

16 Shih për më tepër William Blackstone, “*Commentaries of the Laws of England*”. (Chicago. Chicago University Press) 1979.

17 Letrat e Federalistit Nr. 78. Teskti është i arritshëm në <http://www.constitution.org/fed/federa78.htm>.

18 James Kent, “*Commentaries on American Law*” 475 (O.W. Holmes, Jr. ed., 14th ed., Boston, Little, Brown, & Co. 1896) cituar në Thomas Lee, “Stare decisis in historical perspective: from the founding era to the Rehnquist court”. *52 Vanderbilt Law Review* 647 (1999).

#### IV. Natyra e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës

Dilema kryesore e cila natyrshëm shtrohet në këtë kontekst është se a konsiderohen vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës precedent nga gjykatat e rregullta dhe autoritetet publike në Kosovë, dhe nëse po, në cilat situata dhe nën çfarë rrethanash juridike këto vendime kushtetuese mund të fitonin epitelin e precedentit? Fillimisht duhet theksuar se sipas nenit 116 të Kushtetutës së Kosovës, “vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.” Sipas Rregullit 56 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Gjykata nxjerr aktgjykime (kur vendos në bazë meritore për një kërkese); aktvendime (kur vendos për pranueshmërinë e një kërkese), vendimet (kur vendos në lidhje me kërkesat për masa të përkohshme). Gjykata mund të nxjerr edhe vendimet administrative sa herë që Gjykata vendos në seanca administrative për çështje administrative dhe urdhra të tjerë të atillë që kohë pas kohe konsideron si të duhur.<sup>19</sup> Duhet theksuar se efektet juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese varen në mënyrë të konsideruar nga disa faktorë siç janë tipi ose llojet e procedurave kushtetuese, natyra e kontestit kushtetues, i cili është objekt shqyrtimi para Gjykatës Kushtetuese, llojet e subjekteve që marrin pjesë në procesin e kontrollit kushtetues, natyra e normave juridike të cilat kundërshtohen në pikëpamje kushtetuese si dhe vetë përmbajtja e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.<sup>20</sup> Duke iu referuar raportit të Komisionit të Venecias (Këshilli i Evropës) lidhur me efektet juridike të vendimeve të gjykatës kushtetuese hartuar nga konstitucionalisti gjerman Helmut Steinberger do të mund të dallonim tre lloje të vendimeve kushtetuese: vendimet kushtetuese që prodhojnë efektin e gjëse se gjykuar (*res iudicata*), vendimet me efekt juridik *erga omnes*, si dhe vendimet kushtetuese të cilat kane fuqin e burimit të ligjit.

##### A. Vendimet me efekt të gjësë së gjykuar (*res iudicata*)

Në kuptimin përmbajtësor “*res iudicata*” do të thotë fuqia e detyrueshme juridike e një vendimi. Natyrisht se kjo forcë përfundimtare juridike e vendimit është e detyrueshme për palët së cilave ju referohet vendimi në çështjen që

<sup>19</sup> Rregullorja e Punës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës është miratuar në dhjetor 2012 dhe është e arritshme në faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese <http://www.gjk-ks.org/?cid=1,37>.

<sup>20</sup> Shih Helmut Steinberger, “Decisions of the constitutional court and their effects” në “Role of the constitutional court in the consolidation of the rule of law”, publikim i Komisionit të Venecias (1994). Science and technique of democracy No.10. Punimi është i arritshëm në [http://www.venice.coe.int/docs/1994/CDL-STD\(1994\)010-e.asp](http://www.venice.coe.int/docs/1994/CDL-STD(1994)010-e.asp).

ka qenë objekt shqyrtimi kushtetues. Me fjalë të tjera, efekti *res judicata* i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese prodhon efekte juridike *inter-partes* dhe vendimet janë *res judicata* vetëm për individin i cili është palë në procedurën kushtetuese. Rrjedhimisht, siç thekson Steinberger, efekti i gjësë së gjykuar i vendimeve të gjykatës kushtetuese përmban edhe elementin ndalues në kuptimin e ndalimit të gjykatave kushtetuese që të trajtojnë për të dytën herë çështje të cilat janë shqyrtuar dhe vendosur me vendim të gjykatës kushtetuese.<sup>21</sup> Ndonëse Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës nuk përcakton fushëveprimin e parimit *res judicata*, respektimi i këtij parimi është një institucion i nënkuptuar për parimin e shtetit të së drejtës për të siguruar një shkallë adekuate të sigurisë dhe stabilitetit juridik në zgjedhjen e kontesteve juridike.

## B. Vendimet me efekt juridik erga omnes

